

1 E mërkurë, 8 dhjetor, 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca hapet në orën 09.35

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita
6 të gjithëve mirë se erdhët.

7 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës, kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, nga ana e
12 Prokurorisë sot të pranishëm janë Julie Mann, është menaxhere
13 e lëndës, zonja Line Pedersen nuk është e pranishme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees?

15 Z. REES: [Përkthim] Nuk ka ndryshim nga ana jonë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
17 Worboys?

18 Z. WORBOYS: [Përkthim] Siç e shihni, zoti Cadman nuk
19 është këtu sot. Gjithnjë e më shumë po bëhet më keq. Sot këtu
20 kemi shumicën e ekipit në sallë. Në kuadër të udhëzimeve të
21 mëparshme, kam zonjën Boxberg, zotin Soliman, zotin Berisha
22 dhe zonjën Rodio këtu me ne sot.

23 Edhe një çështje administrative, pata mundësi që të
24 flisja me zotin Haradinaj, sapo pesë minuta. Nuk kam pasur
25 mundësi që ta përditësoj plotësisht për gjithçka që u diskutua

1 dje, por kam marrë udhëzime dhe ai pranon që të vijojmë sot në
2 mungesë të zotit Cadman. Besoj kjo e ndihmon procesin.

3 Kam kërkuar gjithashtu që nëse zoti Cadman do të kthehet
4 nesër, nëse do të kthehet ai, shpresoj që Trupi Gjykues do të
5 dëgjojë ndonjë çështje që do të dëshirojë zoti Cadman të
6 ngrejë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit, zoti Worboys.

9 Z. Buckley, faleminderit për praninë. Ju lutem përcillini
10 zotit Cadman urimin tonë për t'u shëruar sa më shpejt, për të
11 t'u bërë sa më shpejt sa më mirë. Gjithashtu jam i sigurt që
12 është në duar të sigurta. Vë re që zoti Gucati, zoti Haradinaj
13 janë të pranishëm, që janë këtu.

14 Zoti Haradinaj, gëzohem që jeni më mirë, ju falënderoj që
15 jeni i pranishëm këtu sot.

16 Thjesht do të vijojmë, zoti Gucati, kemi disa çështje të
17 tjera përpara kështu që mund të qetësoheni paksa.

18 Dje u detyruam që ta mbyllim më herët seancën për shkak
19 të një problemi me rrjetin. Për të informuar zoti Haradinaj, i
20 cili nuk merrte dot pjesë në 11 minutat e fundit të procesit
21 dje, megjithëse unë ma merr mendja që avokatët e tij e kanë
22 informuar, kanë dhënë një përmbledhje. Unë gjithashtu do jap
23 një përmbledhje se çfarë është diskutuar në mungesë të tij.
24 Gjithashtu informoj palët se vendimi që nuk është marrë ende
25 për çështje të rregullës 102(3) duhej që të protokollohej

1 dje. Ndërkohë vendimi është njoftuar.

2 Zoti Rees propozon që në lidhje me dëshmitarët në vijim,
3 pra ata që kanë mbetur, me përjashtim të numrit 1248, të
4 shkurtohet kohëzgjatja e pyetjeve të drejtpërdrejta duke u
5 marrë vetëm me deklaratën e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë.
6 Ai do të lexojë deklaratën, me përjashtim të paragrafëve për
7 të cilat ZPS-ja ka kundërshtim.

8 Zoti Rees gjithashtu ka deklaruar se për disa dëshmitarë
9 mund të ketë disa pyetje të shkurtra, në kuadër të kësaj qasje
10 të propozuar.

11 ZPS-ja vërejti se në përputhje me urdhrin për Zhvillimin
12 e Procedurës, duhet lexuar përmbledhje të deklaratave dhe jo
13 vetë deklaratat në funksion të procesverbalit. ZPS-ja
14 gjithashtu ka vërejtur se deklaratat përmbajnë edhe paragrafë
15 mbi historikun e jetës së dëshmitarit.

16 Megjithëse nuk është kundër qasjes së propozuar, ZPS-ja
17 vëren se ajo do të kundërshtojë pranimin e disa paragrafëve të
18 caktuar, të cilët gjithashtu do të duhet të verifikohen dhe
19 gjithashtu ZPS-ja dëshiron të verifikojë disa prej deklaratave
20 të dëshmitarit 1242. Në lidhje me faktet për të cilat palët
21 pajtohen, zoti Rees është shprehur se mund të parashtrojë të
22 tilla dhe zonja Bolici ka deklaruar se do të bëjë propozim në
23 kuadër të rregullës 153.

24 Në këtë pikë, zoti Cadman ka pasur kundërshtim për
25 diskutimin, duke pasur parasysh që zoti Haradinaj nuk ishte i

1 pranishëm.

2 Nëse ju, zoti Haradinaj, keni ndonjë pyetje lidhur me
3 këtë, ju këshilloj t'i diskutoni këto me avokatët tuaj.

4 Zoti Buckley, nuk e di nëse keni pasur mundësi që të
5 diskutonin me zotin Haradinaj në lidhje, siç informohem nga
6 Zyra Administrative, zhvendosur në orën 18.00.

7 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në këtë
8 pikë, mund të konfirmoj se nuk pata mundësi të flisja me zotin
9 Haradinaj dje. Nuk mund të konfirmoj nëse zoti Cadman ka pasur
10 mundësi apo jo, duke qenë se ai nuk më ka thënë, nuk më është
11 shprehur, supozoj që nuk ka pasur mundësi. Megjithatë, zoti
12 Worboys mund të sqarojë më tej.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
14 Worboys?

15 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Shoqëruesja e
16 Gjykatës këshillohen]

17 Z. WORBOYS: [Përkthim] Ne patëm mundësi vetëm dy minuta
18 përpara seancës sot që të flisnim me zotin Haradinaj. Unë
19 kryesisht doja të merrja udhëzime prej tij se si do të
20 zhvillohej procesi sot. Nuk pata mundësi që të ta diskutoja
21 këtë me të.

22 Megjithatë, me sa kam dijeni, pjesa më e madhe e
23 çështjeve ka marrë miratim tashmë lidhur me pikat ku
24 deklaratat janë polemike. Unë mund të marr udhëzime për dy
25 minuta dhe --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
2 Haradinaj ka ngritur dorën, mbase duhej të diskutoni me atë
3 fillimisht.

4 Zoti Haradinaj, konsultohuni me avokatin tuaj, ju lutem.
5 [Avokati mbrojtës dhe i akuzuari këshillohen
6 midis tyre]

7 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në interes të
8 të gjithëve do të doja që t'i shpjegoja nja dy minuta me
9 saktësi zotit Haradinaj jashtë, domethënë mbrapa murit, siç
10 vepruam pesë minuta para seancës.

11 Siç ju thashë, vetëm pak minuta patëm mundësi dhe për
12 këtë ju falënderoj, por do të doja të kërkoja edhe nja dy
13 minuta të tjera, disa minuta të tjera. Unë e kuptoj rëndësinë
14 që të vazhdojmë sa më shpejtë por është po ashtu e rëndësishme
15 që zoti Haradinaj të kuptojë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] S'ka asnjë
17 problem. Personeli i sigurisë ka kundërshtim? Jo. Në rregull.
18 Mund të vazhdoni.

19 Me të mbaruar, do të rikthehemi në sallë.

20 --- Pauza fillon në orën 09.43

21 --- Seanca rifillon në orën 09.54

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

23 Uluni ju lutem.

24 Në rregull, zoti Worboys, jemi në rregull tani?

25 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po. Zoti Haradinaj më informoi --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Afrohuni
2 në mikrofon.

3 Z. WORBOYS: [Përkthim] Zoti Haradinaj më tha që t'ju
4 informoj që dje mbas orës 18.00 nuk patëm mundësi që të
5 diskutonim sepse situata me sa ka ai dijani nuk është se u
6 zgjidh, domethënë, sa i takon lidhjes.

7 Nuk e di a më dëgjoni tani apo jo?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta
9 kuptoni se pleqëria nuk është gjë e mirë, më mbrapa.

10 Z. WORBOYS: [Përkthim] Zoti Haradinaj më informoi që t'ju
11 informoj ju si Trup Gjykses që mbas orës 18.00 dje nuk patëm
12 mundësi që të diskutonim për shkak të faktit se teknologjia
13 vazhdonte të mos funksiononte. Megjithatë unë i shpjegova se
14 çfarë ndodhi dje dhe jemi në rregull që të vazhdojmë. Ju
15 falënderojmë për mundësinë që na dhatë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirë në
17 rregull, faleminderit, zoti Haradinaj. Në rregull atëherë.

18 Vërej se Trupi Gjykses ndërkohë ka marrë një udhëzim nga
19 mbrojtja, sa i takon deklaratave që dëshirojnë të lexojnë për
20 procesverbalin. Trupi Gjykses do të japë udhëzime ose para
21 fundit të ditës sot ose nesër, në lidhje me këto komentet dhe
22 kundërshtimet.

23 Z. REES: [Përkthim] Kam nja dy vërejtje që dua që t'i
24 bëj.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund t'i

1 bëni edhe tani.

2 Z. REES: [Përkthim] Thjeshtë dua të them se në lidhje me
3 emailin që kemi marrë nga ZPS-ja në orën 17.52 dje, nuk ka
4 ndonjë problem midis nesh dhe ZPS-së. Jemi dakord që mos t'i
5 lexojmë këto paragrafë, krahas atyre që kemi identifikuar vetë
6 ne, që i ka përmendur edhe ZPS-ja. Sa i takon synimeve,
7 pastaj, në lidhje me dëshmitarin DW1245 dhe paragrafin 20 dhe
8 22, aty kemi kundërshtim, domethënë mospajtim.

9 Qëndrimi i ZPS-së është ky. Nga që këto paragrafë janë,
10 siç thonë ata, tejet të kontestuar, nuk duhen lexuar.

11 Pra parashtrimi ynë është ky: fakti që janë polemikë, nuk
12 përbën bazë për të mos u paraqitur në bazë të rregullës 154 në
13 vend të dëshmisë së dëshmitarit në sallë. Rregulla 154 nuk
14 kërkon që palët të bien dakord sa i takon përmbajtjes së
15 deklaratës. Është një procedurë e cila mund të përdoret për
16 qëllimet e efikasitetit dhe shpejtësisë për të paraqitur prova
17 në vend të dëshmisë së drejtpërdrejtë të dëshmitarit. Pastaj,
18 pala kundërshtuese mund të merret me këto çështje, me këto
19 pika të kontestuar gjatë kundër-pyetjeve.

20 Me përjashtim të paragrafit 20-22, deklarata e
21 dëshmitarit DW1245, e cila ne themi se mund të paraqitet
22 rregullisht si pjesë e deklaratës së tij përmes rregullës 154,
23 nuk do të lexojmë paragrafët e tjerë të përmendura nga ZPS-ja
24 krahas këtyre paragrafëve.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Keni

1 ndonjë koment për këtë, zonja Bolici?

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të komentoj shumë shkurt se
3 sigurisht mund të marrim përsëri këtë çështje në shqyrtim më
4 pas. Ne sigurisht kemi identifikuar një sërë paragrafësh për
5 të cilët ne kundërshtojmë në bazë të provueshmërisë.
6 Gjithashtu kemi nënvizuar edhe paragrafët të cilët ne i
7 kundërshtojmë sipas rregullës 154.

8 Në bazë të faktit se parimi i parashtrimit gojarisht të
9 provave sugjeron një mënyrë më të përshtatshme për të pranuar
10 prova mbi një çështje tejet të kontestueshme dhe mënyra më e
11 mirë është që të bëhet drejtpërdrejtë përmes dëshmitarit këtu
12 në sallë. Është në bazë të kësaj që për këto paragrafë shtesë
13 kemi nënvizuar veçmas dhe kërkojmë që ato të mos pranohen në
14 prova pa praninë e dëshmitarit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Të paktën
16 fillimisht ju po sugjeroni që të ketë dëshmi gojarisht këtu
17 nga dëshmitarët.

18 Dhe ju e kuptoni qëndrimin e saj, apo jo?

19 Z. REES: [Përkthim] Po, e kuptoj. Nga ana ime do të desha
20 të them që rregulla 154 që parashikon këtë procedurë,
21 parashikon që të bëhet kundërshtimi për pjesët e
22 kundërshtueshme të deklaratës së dëshmitarit përmes kundër-
23 pyetjeve.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nëse mundem, rregulla 154
25 mbështetet në parimin e efikasitetit dhe shtimi i pyetjeve nga

1 avokati për nja dy paragrafë të kontestueshëm do të përmbushte
2 parimin e parashtrimit gojarisht të provave dhe jo parimin e
3 efikasitetit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do t'ju
5 japim udhëzime për këtë më pas. E vlerësojmë -- pra i kuptuam
6 parashtrimet tuaja. Po zoti Worboys?

7 Z. WORBOYS: [Përkthim] Edhe ne kemi të njëjtin qëndrim si
8 zoti Rees, pra që për këto çështje Prokuroria mund t'i
9 trajtojë gjatë kundër-pyetjeve.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Zori Rees, deshët që të diskutonin gjithashtu dhe
13 kalendarin kohor për çështjen për të cilën ende nuk është
14 marrë vendim, sipas rregullës 102(3). Tani e keni marrë
15 urdhrin tonë dhe është vendimi i fundit sa i takon rregullës
16 102(3). Keni fjalën.

17 Z. REES: [Përkthim] Në kuadër të çështjeve
18 administrative, mendoj se ja vlen që të përmend tani se
19 pavarësisht që nuk e kuptojmë mirë nëse dëshmitarja Zdenka
20 Pumper dhe dëshmitari Miro Jukiç janë apo jo [në gjendje] të
21 na asistojnë më tej, ne gjithashtu kërkojmë që ata të ri
22 thirren në mënyrë që t'u bëjmë pyetje mbi nxjerrjen që është
23 bërë pasi ka përfunduar dhënia e dëshmisë së tyre.

24 Ne i kërkojmë ZPS-së që të na e vendosi në dispozicion
25 gjatë kohës së parashikuar për ne javën e ardhshme. Nuk

1 parashikoj se do të ketë nevojë për kundër-pyetje të tyre për
2 një kohë të gjatë jo më shumë se 20 minuta.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I vetmi koment është që asnjë
4 prej dëshmitarëve nuk ka qenë i përfshirë në çështjet të tjera
5 shtesë lidhur me hetime në këtë çështje apo hetime të tjera të
6 lidhura pas dhënies së dëshmisë së tyre.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po e
8 kuptojmë qëndrimin tuaj, por ne e kemi dhënë leje që të t'i ri
9 thërrasim dëshmitarët nëse ka nevojë kështu që mund të ri
10 thirren ditën e enjte. Mund t'i marrim edhe jashtë radhe kur
11 të jenë në dispozicion.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, unë thjesht po nënvizoj se
13 baza që -- për të cilën kërkohet rithirrja janë, siç e tha
14 zoti Rees, janë prova të reja që i janë marrë pas dhënies së
15 dëshmisë së tyre. Thjesht dua të theksoj që kjo s'ka lidhje,
16 ato nuk janë të përfshirë në këto prova, kështu që nuk shikoj
17 bazën e ri thirrjes së tyre.

18 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj dhe unë i kam ngritur
19 shqetësimet tona lidhur me këto më përpara por ZPS-ja nuk po
20 vendos në dispozicion dëshmitarë të tjerë, me të cilët ne mund
21 t'i trajtojmë këto materiale.

22 Atëherë, nëse do të rithirren ata, kundër-pyetjet do të
23 jenë shumë të shkurtra.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Druaj se jo të dy dëshmitarët do
25 të jenë në dispozicion këtë të enjte.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo këtë të
2 enjte.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të enjten tjetër.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne i kemi
5 në dispozicion të enjten dhe të premtën, kështu që ju lutem
6 kujdesuni që të jenë në dispozicion në njërin prej këtyre dy
7 ditëve. Pastaj do t'i rithërrasim kur të jenë në dispozicion.

8 Tani do të kalojmë në një urdhër gojarisht.

9 Dje Mbrojta e zotit Gucati parashtroi kërkesë për të
10 kërkuar pesë materiale në listën e provave. Është parashtrimi
11 i protokolluar F478.

12 ZPS-ja tregon se nuk e kundërshton kërkesën por rezervon
13 të drejtën për të bërë kundërshtime lidhur me paraqitjen e
14 tyre për prova për t'u pranuar si prova materiale.

15 Trupi Gjykses e miraton kërkesën e Mbrojtjes së Gucatit
16 dhe urdhëron që të dorëzohet lista e përditësuar e provave
17 materiale brenda ditës së nesërme, 9 dhjetor 2021.

18 Këtu mbyllet urdhri i dhënë gojarisht.

19 Gjithashtu kam një pyetje për zotin Rees lidhur me
20 parashtrimin e protokolluar 475. Gjatë konferencës përgatitore
21 të mbrojtjes më 2 dhjetor Trupi Gjykses i urdhëroi Mbrojtjes
22 që të dorëzojë listën e përditësuar të provave.

23 Zoti Rees, Trupi Gjykses vëren se parashtrimi i
24 protokolluar përmban një provë. Thjesht për sqarim, do të
25 thotë kjo se ju nuk parashikoni që të dorëzoni në provat

1 materiale, materialet që keni listuar në listën fillestare
2 përmes një dëshmitari, apo dëshironi që t'i paraqisni ato
3 përmes një mocioni të paraqitjes së provave jo përmes
4 dëshmitarëve, apo synoni që t'i paraqisni në Gjykatë dhe të
5 mos kërkonin pranimin e tyre.

6 Z. REES: [Përkthim] Është një provë materiale të cilën ne
7 synojmë ta paraqesim përmes dëshmitarit me numër DW1242.
8 Lidhur me provat e tjera që do të kërkojmë të pranohen, do t'i
9 përfshijmë në një mocion për pranimin e provave jo përmes
10 dëshmitarëve që do të dorëzohet në përputhje me udhëzimin e
11 trupit gjykues, brenda kësaj të premtëje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Z. REES: [Përkthim] Për të qenë më i plotë, i rikujtoj
15 Trupit Gjykues se dje ngritëm çështjen se ne po kërkojmë edhe
16 që të kemi një listë të fakteve për të cilën palët pajtohen.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

18 Z. REES: [Përkthim] Kjo do të thotë se çdo mocion i
19 dorëzuar për pranimin e provave jo përmes dëshmitarëve ka një
20 listë të provave që është më e shkurtër, pra se lista më e
21 gjerë e provave që kemi paraqitur më përpara.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
23 Worboys ose zoti Buckley, kush do që të dëshirojë që të
24 përgjigjet, urdhri i Trupit Gjykues në 2 dhjetor gjithashtu
25 vlen edhe për Mbrojtjen e Haradinajt. Nuk kemi një listë të

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 13

1 përditësuar të provave materiale. S'kemi as kërkesë. Mund të
2 na jepni një arsye për këtë?

3 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju kërkoj
4 ndjesë, të nderuar Gjykatës, nuk kam mundësi ta shikoj zotin
5 Worboys dhe nuk e di a është ngritur në këmbë apo jo. Kështu
6 shpresoj të mos kem ndërhyrë pa leje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pa problem
8 mund të vazhdoni.

9 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Me sa kam
10 dijeni, është disi e vështirë që të bëhet kjo përmes
11 videolidhjes dhe komunikimeve nga larg. Me sa kam dijeni,
12 listat përkatëse të provave janë ngarkuar në sistem.
13 Megjithatë, nëse i nderuari Gjykatës më lejon që ta shikoj
14 këtë çështje gjatë pushimit të parë sot paradite, pastaj mbas
15 pushimit mund t'ju jap një përgjigje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne e
17 ripërtërimë urdhrin tonë për këtë çështje dhe ju kërkojmë që
18 ta zbatoni brenda të premtës 10 dhjetor. Zonja Bolici, keni
19 ndonjë koment?

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull
22 atëherë. Atëherë mund të vazhdojmë kundërpyetjet që
23 Prokuroria do ja bëjë zotit Gucati. Zonja Bolici, keni fjalën.

24 DËSHMITARI: HYSNI GUCATI [Vijon]

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Bolici: [Vazhdon]

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

2 Py. Mirëmëngjesi, zoti Gucati.

3 Zonja Sekretare, ta vendosim në ekranin provën me numër
4 SPOE00248303-00248304, konfidenciale.

5 Py. Zoti Gucati, Ua tregova këtë dokument nga fundi i seancës
6 dhe ju pyeta në qoftë se kishit dijeni se ka pasur një gjykim
7 kundër këtyre anëtarëve të UÇK-së. A keni dijeni që ka pasur
8 një gjykim të tillë?

9 Pë. Përshëndetje, ma së pari. Po, është reale, me jetu në
10 Kosovë e mos me ditë në gjykimet që janë mbajtur ndaj
11 pjesëtarëve të UÇK-së është e pamundshme.

12 Py. Domethënë e dini këtë?

13 Pë. Çdo gjykim që ka ndodhur në Kosovë ndaj pjesëtarëve të
14 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës jo që e di unë në një moshë 50-
15 vjeçare por edhe fëmija 4-vjeçar e din që ka pasur gjykime
16 ndaj pjesëtarëve Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

17 Py. Faleminderit. A e dini nëse vendimet fajësuese në atë
18 çështje janë konfirmuar edhe në apel prej Gjykatës Supreme?

19 Pë. Këto -- këtë dokument që ma ke qit përpara ti mu është,
20 po më vjen shumë keq, unë dje të tregova, po mi përkujtojnë
21 vitet e mia mbas luftës, vitet më të vështira të jetës sime që
22 kam pas. Ky vit 2006. Korrik 2005 - nëntor 2008 vitet më të
23 vështira kanë qenë në jetën time. Në një -- problemi që kam
24 pasur me vajzën që më ka vdekur, periudha e 2006-ës [e pa
25 kuptueshme] që ka qenë pyetja, jeta ime. Kështu që me këto

1 vendime e di që e kanë pas gjykimeve ndaj pjesëtarëve të UÇK-
2 së por çfarë vendime kanë marr nuk e di, se kam qenë me
3 problemet të miat që thashë. Kështu që më vjen shumë keq që
4 m'i përkujton këtu vitet ti mua, por s'është problem. Le të
5 jetë në ndërgjegjen e juve.

6 Py. E kam të qartë zoti Gucati. Në vitet që vijuan, a mësuat
7 në qoftë se vendimet e fajësisë kundër këtyre anëtarëve të
8 UÇK-së u konfirmuan, nën instancat më të larta gjyqësore. Në
9 qoftë se këta persona pra vuajtën dënime në bazë të atyre
10 vendime të fajësisë?

11 Pë. Nuk jam marrë, ju thashë edhe më herët, nuk jam marrë me
12 këto se s'më ka interesu. Më ka ardhur keq pse i kanë marrë, i
13 kanë qit para bankës së akuzuarve pjesëtarët e UÇK-së, por nuk
14 jam marrë me proceset e tyre se s'i ka vëzhgu. Të jem i
15 singërtë s'i kam vëzhgu për arsye se s'kisha kohë.

16 Py. Në rregull, në qoftë se e shikoni të akuzuarin e parë në
17 faqen që ju tregohet në ekran, ju lutem mos ja përmendni
18 emrin, a mund të na thoni në qoftë se ky person mban apo ka
19 mbajtur ndonjë pozitë me përgjegjësi brenda Organizatës së
20 Veteranëve të Luftës të UÇK-së?

21 Pë. Unë këtë person e njoh, familjen e tina se jam ba
22 singërisht se kam lexu për familjen e tina më së pari. Nën
23 një. Nën dy: ky person nuk ka qenë kurrë në udhëheqjen e
24 Organizatës së Veteranëve të Luftës, nuk e di, unë nuk e mbaj
25 mend për vedi, kështu që ky njeri s'ka qenë kurrë as anëtar

1 kryesie në nivel qendror, që ne jemi diku 80 km vijë ajrore,
2 se vijë tokësore është ma larg, por vijë ajrore, flasim 80
3 kilometra që jetoj me këtë njeri. Unë jetoj në krahinën e
4 Drenicës, ky jeton në një krahinë tjetër të komunës së
5 Prizrenit. Kështu që jo, nuk e besoj.

6 Py. A ka qenë ai ndonjëherë kryetar i ndonjë dege të OVL UÇK-
7 së?

8 Pë. Më fal këtu, tash emrin s'po guxoj t'ja përmendi, por me
9 këtë emër e këtë mbiemër në Kosovë ka shumë persona. Veç në
10 lagjen time janë dy janë 2 dhe në fshatin tim janë katër.
11 Kështu që me këtë emër e mbiemër -- unë tash -- atë që e njoh
12 unë është sot kryetar. Atë që njoh sot unë. Tash, a asht ky, a
13 asht ai, më falni, mu më vjen keq. Me këtë emër dhe mbiemër që
14 njoh unë që kanë qenë edhe pjesëtarë të UÇK-së ka shumë. Tash
15 po më vjen keq që kemi ngatërru pak, se këtu janë -- tash
16 mosha e tina, njëri është ma i vjetër, ky tjetri është më i
17 ri, që po mendoj unë. Tash nuk e di për kë e ke fjalën. Është
18 mirë me - t'i [e pa kuptueshme] emrin e babës e këtina këtu,
19 se [e pakuptueshme] emrin e babës, atëherë muj e di për cilin
20 e ke fjalën ti.

21 Py. Zoti Gucati, në bazë të statutit dhe praktikës të OVL
22 UÇK-së për të mbajtur një pozitë përgjegjëse brenda OVL UÇK-
23 së, a është pengesë, domethënë të kesh pasur një dënim për
24 krime lufte paraprakisht?

25 Pë. Unë nuk guxoj të flas për njeri që s'po muj e kuptoj cili

1 asht. Me qit emrin, unë që i njoh -- i njoh tre a katër që
2 janë pjesë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nën një. Nën dy:
3 t'u kisha lut, ma bon emrin e babës këtina ta shoh këtu,
4 atëherë të tregoj për cilin e ke fjalën e mu të kthej
5 përgjigje. Nuk e di për cilin është fjala këtu, të jeni të
6 bindur ai që po mendoj unë, njëri është tash Kryetari i
7 Veteranëve të Luftës, tjetri nuk është. Tash nuk po e di për
8 cilin e ke fjalën. Shumë më vjen keq. S'muj të kthej përgjigje
9 kur nuk e di për cilin person saktë është fjala.
10 Py. Faleminderit për përgjigjen. Pyetja ime ishte ndryshe. Të
11 pyeta në qoftë se në përgjithësi, në bazë të statutit të OVL
12 UÇK-së dhe praktikës që ndiqet nga kjo organizatë, a është
13 problem në qoftë se dikush që është dënuar për krime lufte
14 mund të mbajë pozitë brenda OVL UÇK-së.

15 Z. REES: [Përkthim] Kam një kundërshtim. Dua që
16 Prokuroria të paraqesë relevancën e këtyre pyetjeve.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nga pyetjet e Mbrojtjes del se i
18 akuzuari ka thënë që ishte i detyruar që të nxirrte emrat dhe
19 deklaratat e dëshmitarëve meqë këta persona ishin të dyshuar
20 për krime lufte në Serbi. Dua që të verifikoj në qoftë se ato
21 vendime fajësie për krime lufte kanë qenë pengesë për marrjen
22 e pozitive brenda OVL UÇK-së.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta hedh
24 poshtë kundërshtimin tuaj sepse nuk është aq i rëndësishëm
25 mirëpo ta marrim përgjigjen dhe të vazhdojmë me diçka tjetër.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

2 Py. Zoti Gucati, a bën kontroll dikush në qoftë se një person

3 është dënuar për krime lufte përpara se ta pranojë atë person

4 në një pozitë përgjegjëse brenda Organizatës së Veteranëve të

5 Luftës të UÇK-së? A bën kontrollin në qoftë se ai person ka

6 qenë i dënuar për krime lufte?

7 Pë. Tash ne jemi me e elaboru krejt. Çdo kryetar që zgjidhet

8 në kryesi e kam fjalën në nivelin qendror apo në nivelin

9 lokal, do të kalojë filtrin, i cili do të merr votën e

10 delegatëve të atij vendi dhe do të propozohet për kryetar

11 dege. Do të lexohet biografia e tij, nëse Hysni Gucati ka qenë

12 në thonjëza e them, gjithmonë, "i dënum për hajni, për

13 keqpërdorime" atëherë moralisht dhe me etikë dhe me kod të

14 Organizatës së Veteranëve të Luftës nuk do të ketë të drejtë

15 të jetë pjesëtar i - kryetar i veteranëve të luftës, nëse ka

16 shkel edhe procedurat dhe rregullat e Organizatës së

17 Veteranëve të Luftës, ka thyer -- prapë ato nuk do të jetë

18 kryetar i veteranëve të luftës. Për këto që më pyet, a ka qenë

19 i dënum nga Gjykata në Kosovë, apo Gjykata, apo <gjykata të

20 UNMIK-ut apo të EULEX-it, po të them sinqerisht për cilin

21 pëson e keni fjalën. Tash nuk muj të them unë se personi në

22 fjalë që është këtu mund të jetë kryetar tash. Se unë të

23 thash, i njoh dy tre vetë që janë me këtë emër e mbiemër. Nëse

24 ka mundësi me ja përmend emrin e babait, unë ja përmendi

25 njërit prej tyre, dhe atëherë -- nëse më lejohet. Nëse nuk më

1 lejohet, atëherë e lëmë kështu me -- të hapur seancën.

2 Py. Në rregull, domethënë, me sa dini ju, nuk ka ndonjë
3 person që paraprakisht është dënuar për krime lufte dhe që
4 mban ndonjë post me përgjegjësi brenda OVL UÇK-së? A është kjo
5 e saktë?

6 Pë. Unë jam kryetar prej 15 tetorit 2017, unë kur jam
7 kryetar, nuk e di. Me sinqeritetin më të madh flas, që ndonjë
8 degë në Kosovë, ndonjë komunë në Kosovë që të jetë ndonjë
9 kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës, të ketë një
10 vendim të tillë, i dënuar për krime lufte. Po e them me
11 sinqeritetin më të madh. Deri më sot s'kam dëgjua. Mund të
12 jetë që s'kam muj me i ditë, por nuk e besoj. Nëse e dini
13 është mirë të më tregoni.

14 Py. Në qoftë se është e mundur, ta shikojmë rreshtin e fundit
15 në faqen 16 dhe faqen 17 të këtij aktgjykimi që kemi ku
16 thuhet: "Gjykata mori parasysh stresin dhe frikën e madhe me
17 të cilën janë përballë dëshmitarët. Duhet të përkujtohet se
18 shumë nga dëshmitarët kërkuar masa mbrojtje dhe dëshmuan në
19 anonimitet. Në rastin e Prokurorit të Tribunalit kundër Fatmir
20 Limaj, Trupi Gjykses më tej vërejtë se një numër i
21 konsiderueshëm i dëshmitarëve kishin kërkuar masa mbrojtëse
22 gjatë gjykimit dhe kishin shprehur shqetësimet e tyre për
23 jetën e tyre dhe të familjes së tyre. Në këtë kontekst të
24 frikës, sidomos në lidhje me dëshmitarët që ende jetojnë në
25 Kosovë, ishte një frikë mjaft e perceptueshme gjatë gjithë

1 gjykimit".

2 Zoti Gucati, a keni dëgjuar ndonjëherë sikur në këtë rast
3 dhe në rastin e Limaj, që i përmenda unë, që dëshmitarët në
4 gjykimet kundër pjesëtarëve të UÇK-së kanë kërkuar masa
5 mbrojtëse dhe atyre u është dasht që t'ju miratohen masa
6 mbrojtëse me qëllim që të adresohen këto rreziqe të sigurisë?
7 A jeni në dijeni për këto?

8 Pë. Po më pyet për vitet të kalume shumë, diku 15 - 16 vite
9 që kanë ndodh këto raste. Jo nuk kam dëgjuar kurrë, të kam
10 thanë edhe dje, faleminderit që ma dhatë edhe mundësinë. Edhe
11 sot përgjigjen e bëj në këtë pyetje, nuk ka qenë diku që kam
12 digju unë, po as opinionin Kosovar s'e di, s'e ka digju dikush
13 për këto raste. Kështu që jo, s'kam dëgjuar dhe s'kam -- nuk
14 kam njohuri. S'ka ndigju fare. Unë personalisht, dhe çka njoh,
15 por edhe opinionin Kosovar s'e di dikush që ka ndigju. Nëse
16 keni fakte, thirrni ata persona ma s'miri, pse po më pyet mu
17 për 2002, 2003, 2004 a 2006, që s'më kanë hi në punë dhe po
18 them sinqerisht që s'kam ndigju. Si shkurt, jo.

19 Py. Pra dëshmia juaj është se nuk keni dëgjuar asnjëherë që
20 dëshmitarëve ju janë miratuar masa mbrojtëse në gjykimet
21 kundër pjesëtarëve të UÇK-së? Kështu thoni?

22 Pë. S'kam ndigju se s'kam qenë hetues. Të kisha qenë hetues i
23 një sigurimi në Kosovë apo i sigurimit juj, do të isha i
24 interesuar, domethënë. S'kam ndigju, ja ç'po them shqip -
25 kështu nuk kam ndigju. Me keqardhje, s'kam ndigju, dhe nuk ka

1 ekzistu ky në opinionin tonë, unë nuk e besoj.

2 Py. Dhe nuk jeni në dijeni që disa dëshmitarë në këtë çështje
3 u desh që të zhvendosen jashtë Kosovës për shkak të arsyeve të
4 sigurisë. Pra ju nuk dini për këtë?

5 Z. REES: [Përkthim] A mund të na thotë zonja Bolici se
6 për cilën çështje para kësaj Gjykate e ka fjalën?

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për cilindo qoftë rast, ku janë
8 gjykuar pjesëtarë të UÇK-së për krime lufte, pra për të gjitha
9 rastet. Në këto raste, dëshmitarët janë dashur që të
10 zhvendosen prej Kosovës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
12 Gucati, mund të përgjigjen në pyetjen e Prokurores.

13 I AKUZUAR GUCATI: [Përkthim] Po nuk di ç'a të përgjigjem,
14 po më vjen shumë keq, se jo, jo. Sinqerisht, jo. Jo.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

16 Py. Ju prej meje e dëgjoni për herë të parë këtë, kështu
17 thoni?

18 Pë. Unë po them po e dëgjoj bash prej teje për herë të parë,
19 edhe kështu që mund t'ja bëni me gisht kujt të doni ju, keni
20 atë fuqi, kështu që unë nuk e di. S'kam dëgjuar. Kështu ju
21 mund t'ja bani me gisht kujt të doni, se e keni atë fuqi.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në rregull. Dua që dëshmitarit
23 t'ja tregoj provën P0044, versionin në anglisht bashkë me
24 versionin në shqip, të vendosen në ekran. Janë dokumente
25 publike.

1 Py. Dhe zoti Gucati, ky është transkriptimi i një interviste
2 që ja kanë dhënë televizionit Dukagjini me datën 15 janar,
3 2019. Në paragrafin e dytë intervistuesi ju pyet: "Ka edhe
4 shumë shqiptarë që kanë dhënë informacion. A keni dyshim që
5 disa shqiptarë po vazhdojnë që të ofrojnë fakte, informacione
6 prove, dëshmitarë në lidhje me të akuzuar potencial që mund të
7 thirren nga Gjykata".

8 Dhe përgjigja juaj është kjo:

9 "Po, është e vërtetë, ne e kemi thënë këtë edhe para
10 shumë kohe dhe vazhdojmë që themi që ka shqipfolës të cilët
11 nuk ja dëshirojnë të mirën Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

12 Në rreshtin e fundit të paragrafit, ju shtoni:

13 "Ata edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe
14 zhvendosen jashtë Kosovës me pretendime se kanë frikë prej
15 nesh, që kjo gjë nuk është fare e vërtetë dhe bashkëpunojnë me
16 Tribunalin e tanishëm në Hagë".

17 Nga kjo del, zoti Gucati, në janar të vitit 2012 keni
18 qenë në dijeni që dëshmitarët që kanë dëshmuar në raste kundër
19 UÇK-së po zhvendoseshin jashtë Kosovës për shkak të frikës,
20 apo jo?

21 Pë. Ma sa pari, kisha pas dëshirë të jem ndoshta pak më i
22 qartë unë për cila raste e kij fjalën. Unë gjithmonë kam cekë
23 se rasti [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], kështu që
24 nëse ti po më shtin me përmend emrin e tina, gjithmonë fjala
25 ka qenë për zotërinë që e kërkon Interpoli. [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]. Kështu më vjen keq, se mos e devijojmë me
3 pyetje -

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
5 Gucati, të lutem mos e përmend më emrin e atij personi.

6 I AKUZUAR GUCATI: [Përkthim] Kërkoj falje, i nderum.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

8 Py. Zoti Gucati, pyetja ime ishte në lidhje me shqiptarët që
9 jepnin informacion dhe përgjigja jua ishte që ju i ishit në
10 dijeni që ata vazhdonin të bashkëpunonin edhe sot e kësaj dite
11 dhe për këtë arsye zhvendoseshin nga Kosova për shkak -- siç
12 pretendohej, e frikës që kishin prej nesh". Dhe unë ju pyeta
13 në qoftë se në këtë intervistë nga 15 janari i vitit 2012,
14 siç shihet, keni qenë në dijeni se dëshmitarë të tillë janë
15 zhvendosur nga Kosova për shkak të frikës. Atëherë pyetja ime
16 a keni qenë në dijeni për këtë, apo jo. Është shumë pyetje
17 konkrete.

18 Pë. Shumë pyetje -- edhe unë përgjigje konkrete. Nuk kam qenë
19 në dijeni. I vetmi rast është ky si e përmenda emrin më herët,
20 dhe është shumë thjesht -- po ta jap s'kam qenë në dijeni vite
21 ma parë. Rastit është i vetmi ky që përmenda. S'kam qenë në
22 dijeni ma herët. Kurrë s'kam qenë në dijeni se s'kam qenë
23 hetues. Se të isha hetues, me siguri që do t'i kisha përcjell,
24 po. S'isha hetues. Unë jam një njeri, invalid lufte, punoj në
25 shkollën Ahmet Aliaj kështu që jam kryetari i veteranëve dhe

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 24

1 nuk punoj në zbulimin e këtyne njerëzve, s'më intereson fare
2 dhe kështu s'isha në dijeni fare.

3 Py. Dhe nuk keni shpjegim se pse shprehimisht i referoheni
4 diçkaje që ju thoni që ju nuk keni pasur dijeni në vitin 2019?

5 Pë. Ti më pyete me rastin në fjalë më herët si ke ma herët
6 prej vitit të kalum, mbi 15-16 tash. Jo. Edhe në vitin 2018,
7 edhe në vitin 2017 edhe të gjithë, nuk kam qenë në dijeni edhe
8 në vitin 2020 -- nuk qenë në dijeni edhe s'jam në dijen. I
9 vetmi rast është ai, që e kërkon Interpoli, e kam përmend atë
10 njeri. Kjo është e vërtetë edhe tjetër nuk e di çka. Nuk jam
11 në dijeni, sinqerisht.

12 Py. Zoti Gucati --

13 Z. WORBOYS: [Përkthim] Më falni që po ju ndërpres po zoti
14 Buckley nuk dëgjon me videolidhje. A ka ndonjë mënyrë që të
15 rregullohet ky problem teknik?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A keni
17 ndonjë këshillë në lidhje me këtë, zonja Sekretare?

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
19 departamenti i informacionit të teknologjisë do ta shikojë se
20 çfarë është problemi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Duhet të
22 bëjmë një pushim shumë të shkurtër, deri sa të zgjidhet
23 problemi me lidhjen me video.

24 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
25 këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A mund të
2 më dëgjoni tani, zoti Buckley?

3 Me sa duket, jo. Zoti Worboys, mund t'i dërgoni një
4 mesazh me postë elektronike për të kontrolluar sepse duket se
5 është i lidhur në rregull.

6 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ai thotë se
7 vazhdon të mos dëgjojë. Mbase do të ishte më mirë që zoti
8 Buckley të dilte nga sistemi dhe të hynte sërish në sistem.
9 Nuk e di nëse do të funksiononte, por duket sikur është e
10 vetmja mundësi që për të.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund t'i
12 dërgoni një mesazh atëherë që të veprojnë në këtë mënyrë?

13 Zoti Gucati, mund të ngriheni edhe në këmbë nëse
14 dëshironi, pa problem.

15 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, duket se ka
16 probleme por thotë se mund të vazhdojmë.

17 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju kërkoj
18 ndjesë. Sapo u kthye sinjali audio, mbase mund të vazhdojmë.
19 Janë disa probleme teknologjike.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më dëgjoni
21 tani?

22 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, ju
23 dëgjoj, ju falënderoj. Këto janë sistemet.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] I bëtë
25 rinisje sistemit?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 26

1 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, dola nga
2 sistemi, hyra prapë. Nuk e di, faktikisht. Deri tani
3 funksiononte në rregull. Megjithatë, mund të vazhdoni, unë do
4 të vazhdoj korrespondencën me Z. Worboys me postë elektronike.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
6 Worboys merr çmimin e parë për njohuri teknologjike sot.

7 Zonja Bolici, mund të vazhdoni.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
9 Py. Zoti Gucati, a jeni në dijeni se -- po më falni. Më
10 dëgjoni tani?

11 Pë. Po.

12 Py. Në rregull. A jeni në dijeni se dëshmitarët të cilët kanë
13 dhënë deklaratat kundër anëtarëve të OVL UÇK-së ende quhen nga
14 disa sot si gënjeshtarë, tradhtarë të Kosovës, apo si spiunë
15 të Serbisë. Jeni në dijeni për këtë?

16 Pë. Po se quhen tradhtarë, spiunë, unë këtu nuk jam në dijeni
17 pse ka dhënë deklaratat. Ka mundësi që kanë dhanë, nuk e di për
18 atë punë. S'kam ardh unë me ta në Gjykatë që të di kush - çka
19 ka deklaruar, kështu që nuk e di.

20 Py. Dëshiroj që t'ju tregoj, zoti Gucati, një intervistë të
21 cilën ju ja keni dhënë "Kohës", më datë 12 dhjetor 2018. Prova
22 me numër P0014. Dua që edhe versionin në anglisht dhe versionin
23 në shqip të paraqiten në ekran. Janë të dy dokumente publike.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 14 apo 40?

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] 40.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

2 Py. Në paragrafin e katërt, zoti Gucati, midis vulave kohore
3 4:39 deri në 6:03 --

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Më falni, duhet faqja 2.

5 Faleminderit.

6 Py. Thoni se nuk besoni se Dhomat e Specializuara do t'ia
7 dalin mbanë dhe e shpjegoni pse. Dhe thoni:

8 "Për këtë arsye ne besojmë fuqimisht se kjo Gjykatë do të
9 dështojë. Kjo Gjykatë do të dështojë gjithmonë. Arsyeja për
10 dështimin e saj është se kanë thirrur disa dëshmitarë të cilët
11 do t'i quaja "bashkëpunëtorë" të armikut, disa dëshmitarë që
12 s'kanë qenë në Kosovë fare. Për këtë arsye besoj që kjo
13 Gjykatë do të dështojë".

14 Kur thoni këtu, zoti Gucati, që dëshmitarët të cilët i
15 kanë dhënë, dëshmi pra, ZPS-së dhe kësaj Gjykate janë armiq
16 dhe bashkëpunëtorë?

17 Pë. Nëse ka mundësi edhe një herë se unë jam këtu duke lexuar
18 po, pyetjen tënde nëse ka mundësi edhe një herë?

19 Py. Në këtë intervistë që ju e keni dhënë më datë 12 dhjetor
20 2018, thoni se Gjykata do të dështojë se pse ka thirrur si
21 dëshmitarë ata që janë armiq dhe bashkëpunëtorë. Pyetja që kam
22 është kjo: në vitin 2018 po thoni se dëshmitarët e ZPS-së dhe
23 kësaj Gjykate dhe bashkëpunëtorë?

24 Pë. Të gjithë e dimë se armiq - ne Serbinë e kemi armiq dhe
25 keni bashkëpunu me kriminelë serbë. Gjithmonë fjala, kur thom

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 28

1 armiq, janë serbët, dhe disa të tjerë që ka muj të jenë me ta.
2 Kjo është reale që kam thënë këtu. Gjithmonë kam fjalën për
3 armiq të tonë që i kemi armiq të shekullorë, që 120 që na kanë
4 sundu, dhe kjo është fjala për armiq të apo serbët të cilët
5 kanë sundu Kosovën dhe kanë bërë masakra në Kosovë.

6 Py. Pra a është e vërtetë, zoti Gucati, se ju i quani
7 njerëzit të cilët i japin dëshmi kësaj Gjykate si armiq?

8 Pë. Njerëzit të cilët janë të vërtetë nuk mund t'i quaj unë
9 si armiq. Unë muj t'i quaj armiq ata të cilët kanë dalë edhe
10 kundra NATO-s, kanë protestu pse NATO bombardon Serbinë. Ata
11 janë armiq të. Këtë e them me përgjegjësi shumë të lartë
12 morale. Ata të cilët protestojshin në Kosovë në vitin 1999 kur
13 NATO bombardojke caqet serbe për me pshtu shqiptarët, ata janë
14 armiq të vendit tim dhe të kombit tim.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregoj dëshmitarit
16 provën me numrin P0083. Është publike. Dua që edhe versionin në
17 shqip dhe në anglisht të paraqiten në ekran. Në veçanti
18 dëshiroj që të kalojmë në faqen numër SPOE00222260-63. Nëse --
19 po mund ta zmadhojmë. Në rregull.

20 Py. A është ky një postim në Facebook-un tuaj, zoti Gucati?

21 Pë. Unë nuk e di se është një ngjarje -- mu Facebook-i mu ka
22 pas thy, unë i kam tregu edhe avokatit tim. Dhe disa shkrime
23 të Facebook-it s'janë të miat, kështu që për këtë shkrim
24 kërkoj verifikim pa problem, hiç. Unë e di që Facebook-i m'u
25 ka pas thy në një kohë -- kjo e kam pas lajmru edhe në

1 policinë e Kosovës në atë kohë, kështu që nuk e besoj se mund
2 të jetë Facebook. Kjo shkrimi -- po si dokudo, nëse unë e kam
3 shkru - nëse, gjithmonë, supozoj, prapë nuk mendona. Por nuk
4 besoj se do të jetë ky shkrimi që unë Facebook-un e kam pas
5 lajmëruar që m'u ka thy. Kam lajmru edhe advokatin tim [e
6 pakuptueshme] është lajmëruar edhe në policinë e Kosovës.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dhe nëse kalojmë në faqen
8 SPOE000222263. Nëse mund të zmadhojmë pjesën e fundit. Ky
9 artikull, ky postim është nënshkruar me inicialet HG, që janë
10 inicialet tuaja. Kur postoni artikuj në profilin tuaj në
11 profilin tuaj, në Facebook, pra, postimet tuaja në Facebook,
12 kur janë inicialet tuaja do të thotë që këto janë postime
13 tuaja?

14 Pë. Ka mund -- se duhet të jetë edhe data këtu e shkrimit,
15 nëse ka mundës nëse është në Facebook, të shohim edhe datën?
16 Nëse ka mundësi?

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është në faqen 22260 [sipas
18 përkthimit].

19 Py. E shihni nga fotografia në ekran që është data 4 korrik.
20 Dhe në bazë të metadatave, duket se ky postim është bërë nga
21 data 4 korrik 2020 dhe ka të bëjë me aktakuzat e Dhomave të
22 Specializuara të cilat ishin shpallur a ju kujtohet që ta keni
23 postuar ju këtë postim në profilin tuaj në Facebook?

24 Pë. Në faqen që ma tregove pak ma herët, se ti m'i tregove dy
25 faqe. Kjo është e para që ma tregove, tash është para, nëse

1 s'gabo. Para kësaj ke edhe një faqe tjetër, e nderume. Kjo me
2 4 korrik, ky është mendimi im në shekullin 21, që kam të
3 drejtë të mendoj dhe kam luftu për mendimin e lirë dhe ndryshe
4 dhe për fjalën e lirë. Këtu gjithmonë tash e pranoj që e kam
5 bërë këtë, se kur e pash datën edhe kjo, ky është -- mund ta
6 lexojnë edhe Gjyqtarët, ky është një mendim i jemi i lirë dhe
7 kam shkruar që mbi 80 për qind kemi kaluar nëpër duart e
8 UNMIK-ut dhe Gjykata e EULEX-it kjo është shumë e vërtetë dhe
9 unë e kam mendu, që e kam shkru, diçka çka mendoj lirshëm dhe
10 ato çka du të shpreh lirshëm. Nuk kam mendu që ta fyj dikën
11 apo ta shaj dikën. Këtë që e kam shkru, që ne mbi shtatë
12 shekuj burg i kemi majt që disa vite, mbi shtatë shekuj, mbi
13 7000 vjet shqiptarët kanë qenë për burgje. Kjo më ka shty ta
14 baj këtë shkrim. Kjo është reale. Kështu që unë e kam mendu që
15 kam të drejtë të jem kundër çdo kujna, me fakte dhe me
16 argumente, jo ta fyj dikën, jo ta shaj dikën dhe këtu unë me
17 sa di unë, shkrimi, mund të analizohet, që s'e kam fy askënd
18 dhe s'e kam sha askënd.

19 Py. Faleminderit, zoti Gucati. Në fjalinë e dytë të postimit
20 thoni se:

21 "Gjatë njëzetë viteve të fundit ka pasur disa aktakuza
22 kundër struktura udhëheqëse të UÇK-së, të gjitha këto kundër
23 individëve të cilët kanë qenë luftëtarë të guximshëm të UÇK-
24 së".

25 Dy fjali më poshtë thoni:

1 "Për më tepër, ata të cilët kanë dëshmuar në këto gjyqe
2 kanë qenë bashkëpunëtorë të shërbimit sekret serb apo
3 paraushtarakëve të tyre. Ata janë trajnuar, stërvitur pra, nga
4 serbët që të dëshmojnë në këto gjyqe".

5 Pra, po thoni se të gjithë dëshmitarët të cilët kanë
6 dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së janë bashkëpunëtorë të
7 serbëve?

8 Pë. Në jetën time s'e kam përmend se gjithë dëshmitarët janë
9 kundër. Në jetën time. Ma gjeni fakt, apo një argument që
10 paskam thonë "të gjithë". Ku 2 milionë shqiptarë jetojmë ne në
11 Kosovë apo serbë, arabë, turq, e të gjithë. S'është e vërtetë,
12 s'është n'jetën time kjo.

13 Py. Në faqen në vijim, SPOE00222261, në fjalinë e fundit
14 thoni:

15 "Mos harroni se në këtë betejë do të dalin me emër dhe
16 mbiemër njerëz".

17 Dhe në faqen në vijim, në fjalinë e parë, thoni:

18 "do t'i gjejmë, do t'i zbulojmë të gjithë ata të cilët
19 ndodhen pas -- do të dalin në shesh të gjithë ata që qëndrojnë
20 pas vrasjeve politike në Kosovë, e fshihen pas këtyre
21 proceseve duke akuzuar UÇK-në".

22 Mos po thoni këtu dëshmitarët kundër anëtarëve të UÇK-së
23 do të identifikohen dhe do të turpërohen?

24 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të ngre
25 një kundërshtim? Sa i takon kësaj, zonja Bolici duhet ta

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 32

1 lexojë citimin, fjalinë, plotësisht. Pra personat që do të
2 dalin me emër, mbiemër, këta persona duhet lexuar pra e plotë
3 postimi për të kuptuar se për kë bëhet fjalë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pajtohem
5 me këtë. Vazhdoni.

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

7 Py. Midis faqes të parafundit, me numër SPOE00222261 dhe në
8 faqen në vijim, lexohet kështu:

9 "Mos harroni se në këtë betejë njerëzve -- do të dalin me
10 emër, do të turpërohen ata që janë kundër progresit, që kanë
11 mohuar lirinë, që kanë dhunuar dhe turpëruar Parlamentin
12 kosovar".

13 Dhe pastaj shtoni:

14 "...Do t'i zbulojmë të gjithë ata të cilët ndodhen pas
15 vrasjeve me motive politike në Kosovë të cikët akuzojnë UÇK-
16 në".

17 A mos po thoni këtu se dëshmitarët të cilët japin dëshmi
18 kundër UÇK-së do të identifikohen dhe identitetet e tyre do
19 t'i zbulohen opinionit publik?

20 Pë. Jo, këtu e kam pas fjalën se ne -- këtu është mundu
21 dikush. Me gjithë ato vrasjet dhe jam ithtar i asajna
22 gjithmonë, që çdo vrasje që ka ndodh, pavarësisht kush, është
23 mirë të zbulohen por jote zbulohen po jo të zbulohen me rrena,
24 me etiketime, apo me shantazh. Kështu që unë s'e kam pas
25 fjalën për askënd këtu, këtu e kam pas fjalën që çdo kohë do

1 të shkruajë historia për çdonjërin dhe është mirë që të gjitha
2 ato vrasjet që kanë ndodhur na kanë vesh neve a pavarësisht
3 kujna që ju kanë vesh, është mirë të zbulohen.

4 Unë këtu s'jam kundër askujt. Këtu s'di ta mbroj
5 kurrkënd, këtu do të jem i singertë: është mirë që të gjitha
6 ato që kanë ndodhur në Kosovë të zbulohen. Pavarësisht nga
7 janë ardh. Këtë e kam pas mendimin dhe qëndrimin dhe prapë sot
8 e kam.

9 Py. Zoti Gucati, dëshiroj t'ju tregoj tani nga e njëjta provë
10 materiale faqet nga 64 deri në 67. Ky është një postim i
11 publikuar në profilin tuaj në Facebook më datë 26 prill të
12 vitit 2020. Është nënshkruar si kryetari i OVL UÇK-së, Hysni
13 Gucati. A është ky postimi i juaji, zoti Gucati?

14 Pë. Shumë është e vërtetë, se është postimi i imi, s'e mohoj.

15 Py. Dhe pa përmendur emrin, a e konfirmoni se në këtë postim
16 ju përmendni një individ i cili publikisht ka deklaruar se
17 anëtarët e UÇK-së kanë kryer krime të luftës?

18 Pë. Këtij individ i kam bërë thirrje publike. Kam qenë në
19 televizionin privat, unë në televizionin tash -- T7, m'u
20 kujtu, T7, dhe i kam bërë thirrje publike -- nëse e din një
21 rast, nuk asht marre me u deklaruar, kështu është e vërtetë dhe
22 jo me fol fjalë në hava. Dhe prapë bëj thirrje këtij individ,
23 nëse ky individ e din që një rast, një person mos të ketë
24 frikë nga askush, të tregon të vërtetën, vetëm të vërtetën.

25 Kjo asht reale, dhe këtë s'kam dasht ta fyj, unë mund ta lexoj

1 këtu ça kam ba, dhe prapë i bëj thirrje përmes kësaj Gjykate
2 këtij individi, në del përballë.

3 Py. Dëshiroj që të mbështetem në këtë që keni shkruar në mes
4 të këtij postimi që lexon si vijon:

5 "Ky person, së bashku me një grup intelektualësh, të
6 cilët kanë mbështetjen e Serbisë dhe të miqve ndërkombëtarë të
7 saj, shpreson që të organizohen me mijëra gjykime kundër UÇK-
8 së duke fabrikuar lloj - lloj historish dhe ka paguar 70 për
9 qind të dëshmitarëve për të dëshmuar në këto procese. Kjo
10 dihet edhe publikisht, ka pasur edhe raste kur disa dëshmitarë
11 janë vrarë duke dashur të identifikojnë vetveten. Me dashje
12 apo jo, si personi që ka punuar për këto struktura dhe kjo
13 është bërë për të shkatërruar strukturën e UÇK-së pa pasur
14 ndonjë provë por me dëshmitarë të rremë, si e vetmja mundësi e
15 tyre për të arritur qëllimin e tyre".

16 Pikë së pari, zoti Gucati, jeni ju në dijeni se
17 dëshmitarët janë vrarë pasi kanë dëshmuar kundër anëtarëve të
18 UÇK-së në çështje për krime të luftës?

19 Pë. Në jetën time dhe nuk -- s'kam thënë këtu "janë vra". Kjo
20 duhet të lexohet te teksti. Kam thënë disa intelektualë, që
21 s'janë intelektualë fare edhe ky personi në fjalë s'është
22 intelektual. Ky punon në një organizatë jo qeveritare, merr
23 pare -- kah ta di unë kah merr pare, po sidokudo, unë i bëj
24 thirrje këtij zotniut në fjalë, në det -- në dëshmon pa
25 kurrfarë frike, nëse ka një argument, nuk është problem. Në

1 del, në dëshmon.

2 Py. Kur shkruani se ka pasur edhe raste kur disa dëshmitarë
3 janë vrarë pasi e kanë identifikuar veten, me dashje ose pa
4 dashje, se punonin për këto struktura dhe kjo është bërë pra
5 për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së pa prova, dëshmi [e
6 pakuptueshme] dëshmitarë të montuar, si mundësi e vetme për të
7 arritur deri te qëllimi, pra a e keni fjalën për dëshmitarët
8 të cilët janë vrarë pasi kanë dëshmuar në gjykimet kundër UÇK-
9 së, zoti Gucati?

10 Pë. Jo, jo, s'e kam fjalën kundër UÇK-së. Edhe s'është
11 shkruajtur kundër UÇK-së, mundet ta lexoj tërë tekstin, më
12 vjen keq. Nëse doni, unë e lexoj pe fillimi tekstin krejt deri
13 në fund. Mos të nxirrni fjalë në kontekst, ato çfarë juve ju
14 vyen. Lexoni komplet, nëse doni atëherë e kisha lut gjyqtarët
15 e nderum të lexohet teksti krejt komplet deri në fund dhe të
16 nxirret në kontekst. Nuk është vërtetë që kam thanë unë
17 dëshmitarët që kanë qenë kundër UÇK-Së janë vra.

18 Unë i bëj thirrje këtij personi në fjalë, nëse e dini
19 rastin, në të jetë burrë, mos të ketë frikë, në dëshmon, disa
20 herë po ta përsëriti. Këto -- këtë shkrim e kam bo unë është
21 shumë e vërtetë.

22 Py. Dhe si autor i këtij postimi, a mund të shpjegoni atëherë
23 se për cilat vrasje e keni fjalën të personave të cilët nuk
24 kishin prova por vetëm dëshmitarë të rremë. Për çfarë e keni
25 fjalën?

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 36

1 Pë. Edhe një herë nëse ka mundësi pyetjen?

2 Py. Kur thoni se janë vrarë njerëz pasi kanë dëshmuar dhe se
3 nuk ka mundësi --

4 Z. REES: [Përkthim] Citimi nuk e thotë këtë, nuk thotë
5 kështu citimi -

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] E kam lexuar dy herë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Drejtohuni
8 Trupit Gjykses, ju lutem, jo njëri-tjetrit.

9 Z. REES: [Përkthim] Tek citimi ka problem.

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] E kam lexuar dy herë citimin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, por
12 një moment ju lutem.

13 Z. REES: [Përkthim] Dhe njerëzit janë vrarë pasi kanë
14 dëshmuar --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
16 lexojeni siç është shkruar.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

18 Py. Citoni:

19 "Ka pasur edhe raste kur disa prej dëshmitarëve janë
20 vrarë pasi kanë identifikuar -- pasi e zbuluan veten me dashje
21 apo pa dashje se punonin për këto struktura dhe kjo është bërë
22 për të shkatërruar strukturën e UÇK-së pa prova e dëshmi, por
23 me dëshmitarë të montuar, si mundësi e vetme për të arritur
24 deri te qëllimi".

25 Kur thoni që "ka pasur edhe raste kur këta dëshmitarë

1 janë vrarë, për çfarë e keni fjalën zoti Gucati?

2 Pë. I nderum Gjyatar, nëse ka mundësi ta lexoj tekstin, jo
3 krejt, vetëm dy rreshta që po i lexon Prokuroria. Mandej,
4 mandej disa prej këtyre dëshmitarëve --

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
6 Gucati, ju lutem përgjigjuni pyetjes tani. Avokati jua mund
7 të bëjë pyetje të tjera pastaj.

8 I AKUZUAR GUCATI: [Përkthim] Mirë, më fal atëherë, kërkoj
9 ndjesë. Kjo që shkruan në këtë tekst, jo që unë e kam thënë, e
10 kanë thënë mediat. Kam lexu përmes mediave, që disa prej tyre
11 që e kanë zbulu vetveten e zbulu -- asnji njeri, dhe që janë
12 pendu për gabimet e veta. Ka raste që kanë ndodh, kjo është
13 qëllimi i fjalës. Unë nuk i njoh ata persona, nuk e di as se
14 kush janë. Kjo është -- ka qenë përmes mediave -- kjo është.
15 Unë as i njoh, as s'e di kush është. E këto shkruhen shumë
16 mirë, pasi ata e zbuluan vetveten. Pasi janë pendu ata për
17 gabimet e veta, jo që dikush i ka bo trysni, apo ju ka kërcnu
18 dikush dikujna. Unë nuk i di asnjë rast, nuk e di asnjë rast.
19 Kjo është.

20 Pë. Për cilat gabime janë penduar, zoti Gucati?

21 Pë. S'i kam pyet unë kurrë n'jetë time se nuk i njoh.

22 Py. Kur thoni se është media disa prej tyre që i diskutuan se
23 kush janë, të cilët janë penduar për gabimet e tyre, ka disa
24 raste. Mund të shpjegoni se për çfarë e keni fjalën? E citova
25 sapo nga transkriptimi tani.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 38

1 Pë. Nuk e di arsyen ato, por kjo ka qenë reale dhe kështu që
2 unë nuk e di as kush janë, as i kam pyet pse, kështu që kjo
3 s'ka qenë diçka në mënyrë të msheftë.

4 Py. Pyetja është për personat që janë vrarë dhe përgjigja
5 jote ishte personat që janë për gabimet e tyre. E kemi fjalën
6 për persona që janë vrarë të cilët anë penduar për gabimet e
7 tyre. Dua të kuptoj përgjigjen në përgjithësi.

8 Pë. Unë përgjigjen ta dhashë, nuk kam tjetër përgjigje. S'po
9 muj modifikoj qysh po ta jap përgjigjen tjetër. Nuk kam,
10 sinqerisht. Nuk kam, se ta kisha jep përgjigjen pa problem.

11 Py. Nuk keni përgjigje tjetër. Dua që t'ju tregoj një provë
12 tjetër materiale, zoti Gucati. Ka të bëjë me intervistën tuaj
13 të cilën ja keni dhënë Imazhit më datë 7 shtator të vitit
14 2020.

15 Prova me numër P09. Dëshiroj që të kalojmë në faqen 9 të
16 kësaj prove materiale, si në versionin në shqip, ashtu edhe në
17 atë në anglisht.

18 Për transkriptimin në anglisht, rreshtat përkatëse janë
19 nga 9 deri në 9 dhe në versionin shqip është 12 deri në 17.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Përsërisni
21 edhe një herë numrin në anglisht.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në anglisht, rreshtat përkatëse
23 nga 5 deri në 9. Në versionin në shqip rreshtat 12 deri në 17.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

2 Py. Zoti Gucati, këtu ju është bërë pyetja:

3 "Çfarë është, nëse mund ta them kështu, e çuditshme në
4 këto dosje nga ajo çfarë keni parë deri tani"?

5 Dhe përgjigja juaj është :

6 "Ajo që unë -- mua më duket e çuditshme është fakti se
7 kam parë aty shumë persona të cilët ne i kemi besuar. I kemi
8 mirëpritur në tubime, në oda, në shtëpitë tona, i kemi
9 respektuar".

10 Dhe këtu po flisni për dokumentet që keni marrë më datë
11 7, që ju erdhën pra, më datë 7 shtator. Mos po thoni këtu,
12 zoti Gucati se keni njohur në dokumentet konfidenciale emrat e
13 personave të cilëve ju i keni besuar dhe që tani nuk e
14 meritonin më t'u besohej?

15 Pë. Jo, jo, s'kam fol për emrat që i kam njoft a që i kam pa
16 deklaratat të ndryshme që më kanë befasu, kjo ka qenë edhe në
17 rreshtin 18 te unë, poshtë kur kam dëgju për biografinë e
18 komandantit legjendar Adem Jasharit në dosjen. Kjo ka qenë,
19 gjithmonë ka qenë fjala te këtu, që është ma poshtë, rreshti
20 18 te unë është, kjo -- kjo ka qenë që kam lexu në deklaratë
21 që jam befasu, po jo me emra jo, nuk kam njoft kurrkënd asnjë.

22 Py. Zoti Gucati, në faqen në vijim, në faqen numër 10 -- një
23 moment.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka ardhur
25 ora për pauzën.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ah, po në rregull, është në
2 rregull.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ndërpresim
4 këtu. Do të rifillojmë në orën 11.30. faleminderit shumë.

5 --- Pauza fillon në orën 11.00

6 --- Seanca rifillon në orën 11.30

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
8 Bolici, mund të vazhdoni.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

10 Dua që zotit Gucati t'i shfaq faqen 12 të transkriptimit
11 të intervistës së shtatorit, rreshtat 2 deri në 17 të
12 transkriptimit në anglisht dhe 12 deri në 27 të transkriptimit
13 në shqip.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faqe?

15 Faqja 12.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

17 Py. Zoti Gucati, gjatë kësaj interviste të njëjtë ju kemi
18 thënë:

19 "Ata po përpiqen që nëpërmjet disa dëshmitarëve apo disa
20 shqipfolësve apo do të them publikisht disa tradhtarëve të
21 vendit",

22 Dhe në rreshtin 12 të përkthimit në anglisht dhe rreshti
23 21 i versionit në shqip:

24 "...kjo është se Gjykatat Speciale dojë të arsyetojë
25 vetveten, punën e vet, paren e vet, që është duke harxhuar, të

1 çojë dikë, të qet në bankën e të akuzuarve dhe të gjen një
2 shqipfolës apo një tradhtar, apo një serb edhe ata të dalin të
3 gënjejnë aty, e të rrejnjë, të thonë që këta e kanë bërë këtë,
4 këtë, pa i bo hiç. Kjo është. Unë mendoj kështu.”

5 Këtu, zoti Gucati, a e keni fjalën për dëshmitarët që i
6 kanë dhënë deklaratë THFS-së dhe ZPS-së domethënë ai quani ata
7 tradhtarë të vendit tuaj?

8 Pë. Më falni -- te fjala "shqipfolës" kjo është fjalë që ne e
9 përdorim për të gjithë, pa dallim a janë serbë, turq apo çka
10 janë. A për këtë tradhtarët është e vërtetë që e kam pas
11 fjalën gjithmonë për personin në fjalë që s'po më lejohet të
12 përmend emrin, i cili ka marrë pjesë në masakrën e Mejës dhe
13 në dhunimin e femrave tona.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

15 Py. Domethënë gjatë gjithë kohës e ke pasur ndërmend këtë
16 person të vetëm kur i bën këto deklaratat në intervistat e
17 shumta që ke dhënë. A është kjo e saktë?

18 Pë. Po e saktë -- unë mbase s'më lejohet të përmend emrin.
19 Është e saktë se ky njeri njihet, e kërkon Interpoli dhe
20 kështu që njifet. Ai mund e din me kë ka bashkëpunu, me kë ka
21 punu, unë nuk e di, kështu që njifet për masakrën që ka
22 ndodhur në qytetin e Gjakovës, Meja, dhe për dhunimin e nënave
23 tona, vajzave tona, motrave tona dhe grave tona. Kështu që kjo
24 dihet publikisht.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dua të kalojmë te faqja 11

1 ju lutem, e të njëjtit transkriptim. Janë rreshtat 7 deri në
2 17 në transkriptimin e versionit në anglisht dhe rreshtat që
3 vijojnë pas rreshtit 16 në versionin në shqip.

4 Py. Dhe ju pyetët:

5 "Po dyshoni që ka fabrikime"?

6 Dhe ju përgjigjeni:

7 "Shumë, të jeni të bindun. Shumë, shumë ka fabrikime të
8 mëdha".

9 Pyetje:

10 "Po si mund të bëhen të tilla fabrikime nga njerëz që ju
11 thoni që keni besuar"?

12 Dhe më pas ju përgjigjeni dhe po lexoj nga rreshti 15 në
13 versionin në anglisht:

14 "Por ishte fjala për bashkëluftëtarë, për civilë, që kanë
15 folur për një komandant apo për një pjesëtar të UÇK-së".

16 A jeni duke thënë këtu, zoti Gucati, që i keni njohur
17 emrat dhe deklaratat e njerëzve që ju u keni besuar dhe që
18 këta njerëz ju kanë dhënë fabrikime hetuesve dhe autoriteteve
19 hetuese, apo jo?

20 Pë. Nëse ka mundësi edhe një herë pyetjen? Më fal që po
21 kërkoj.

22 Py. Në këtë pjesë të intervistës tuaj, a jeni duke iu
23 përgjigjur intervistuesit duke thënë që keni identifikuar në
24 dokumentet që i keni shpërndarë me datë 17 shtator, emrat dhe
25 deklaratat e njerëzve të cilëve ju keni besuar dhe se këta

1 njerëz ju kanë dhënë informacion të rremë, fabrikime,
2 autoriteteve hetuese. A është kjo që jeni duke deklaruar në
3 këtë pjesë të intervistës?

4 Pë. Jo, unë emrat s'kam -- asnjë emër s'e kam përmend ato, se
5 është edhe -- televizioni është publik, televizioni i mas --
6 ky emision, ku kam mbajtur unë këtë intervistë, nuk kam
7 përmendur asnjë emër. Kam thënë "kam lexuar, që më ka ra në sy
8 një deklaratë që më ka befasi". Kështu kam thënë. Kjo është e
9 vërtetë që shkruan këtu, por emra s'kam përmend asnjë, me
10 njoh.

11 As nuk e kam njoft kurrkënd, po as kam përmend emra, jo
12 s'e kam njoft asnjë aty. Në këtë deklaratë që kam thënë ka
13 shumë gënjeshtër dhe fabrikime. Është shumë e vërtetë që kam
14 thënë kështu, por emrat s'i kam njoft asnjë.

15 Py. Dhe këto gënjeshtër sipas jush, i kanë bërë njerëzit të
16 cilëve ju keni besuar, a është kjo e saktë, zoti Gucati?

17 Pë. Këtu gënjeshtër i kanë ba ata të cilët kanë dasht t'i
18 bëjnë. Unë nuk - unë po them prapë, nuk i njoh ata njerëz. Nuk
19 i njoh, se po t'i kisha njoft, kisha kërkuar seancë të
20 mbyllur dhe do ta kisha përmendur një emër këtu. Domethënë, me
21 sinqeritetin më të madh, nuk i njoh. Po në bazë të deklaratës,
22 të fjalëve të tina, që ne kemi supozuar, dhe prapë supozoj që
23 kam të drejtën të mendoj ndryshe nga ata, kanë gënjuar.
24 Përderisa nuk del diçka e vërtetë në shesh.

25 Py. Zoti Gucati, si e keni vlerësuar ju që deklarata që e

1 keni lexuar të këtyre njerëzve kanë përmbajtur gënjeshtër? Si
2 e këtë bërë vlerësim?

3 Pë. Po janë kanë jep këta dëshmi gjatë luftë, në kohën e
4 dhunë -- kur Serbia ka qenë okupuese në Kosovë, që i kanë
5 nxanë rob, ka mundësi, ka mundësi që kanë jep intervistë gjatë
6 atyne viteve, apo ka mundësi që kanë gënjy, kështu. Thjesht
7 kanë gënjy. Kanë dasht të gënjejnë. Nuk e kuptoj arsye pse
8 por nk i njoh. Me ermë e mbiemër, nuk i njoh personat. Të jeni
9 të bindur, nuk i njoh. Po t'i njifsha do të kisha kërku sallë
10 të mbyllur dhe ta kisha përmend një emër pa hezitim.

11 Py. Zoti Gucati, thatë se në materialet që i keni shpërndarë
12 me datën 17 shtator, keni njohur apo ju kanë rënë në sy një
13 numër gënjeshtërash apo fabrikimesh dhe unë ju pyeta ju se si
14 erdhët në përfundimin që informacione në ato deklarata ishin
15 gënjeshtër dhe fabrikime? Domethënë, mbi çfarë baze e nxorët
16 këtë përfundim.

17 Pë. Po këtë përfundim e nxora për arsye se Ushtria Çlirimtare
18 e Kosovës nuk ka pas shans teorik të bëj asnjë masakër, asnjë
19 vrasje ndaj qytetarëve serbë apo ndaj dikuj. Nuk ka pas teori,
20 se këto i dinë mirë edhe forcat e NATO-s, e dinë edhe -- të
21 gjithë e dinë, edhe ndërkombëtarët, që Ushtria Çlirimtare e
22 Kosovës nuk ka pas teori, as praktikë, as forcë që të bëjë një
23 gjë të tillë. Kjo është. Për ashtu, unë kam ardh në mendim im,
24 kjo ka qenë që unë kam ardh në përfundim që kjo është një
25 gënjeshtër. Kjo është.

1 Py. Atëherë është dëshmia juaj, zoti Gucati, se çdokush që
2 jep dëshmi kundër UÇK-së, jep dëshmi jo të vërtetë. A është
3 kjo dëshmia juaj?

4 Pë. Kur në jetë time s'kam thanë kështu, s'është e vërtetë.
5 Nëse ka dikush qysh -- që po na thirri në publike, zotnia në
6 fjalë ma herët, nëse ka dëshmi e argumente, zotnia -- pse nuk
7 [e pakuptueshme] msheftas kush prej askujna. Prapë i bëj
8 thirrje publike zotnisë në fjalë ma herët, kështu që s'kam
9 thanë.

10 Py. Atëherë si keni nxjerrë përfundimin që informacionet që i
11 keni lexuar në deklaratat e dëshmitarëve kanë qenë në fakt
12 gënjeshtër? Si e keni nxjerrë këtë përfundim?

13 Pë. Nëse doni të ma cungoni të drejtën time, unë po them, kam
14 të drejtë të mendoj, kam të drejtë të analizoj, ndoshta muj ta
15 analizoj gabim, keq, po unë e kam menduar ashtu. Nëse ju
16 mendoni tash të ma cungoni të drejtën time pse kam menduar
17 ashtu, është diçka tjetër.

18 Py. Çfarë lloji informacioni keni analizuar, keni lexuar çdo
19 deklaratë dhe t'ju përkujtoj se ishin mbi 1000 faqe që ja keni
20 shpërnda përfaqësuesve të shtypit. Domethënë, si e keni bërë
21 këtë vlerësim? Çfarë lloji informacioni keni analizuar?

22 Pë. Me i lexu 1000 faqe duhet nja një vit. Unë me nejt në
23 ndjeri në Kosovë, me i lexu 1,000 faqe qysh thu ti, unë s'e
24 kam lexu as 7 faqe, se jo 1,000. Kështu që unë vetëm atë
25 dokument që më ka rënë në sy, kur e kam biografinë e

1 komandantit legjendar Adem Jasharit dhe këtu e kam thënë:
2 "këtu ka fabrikime". Kjo është reale, e ki edhe në
3 transkriptim. Munet të lëshoni një faqe ma përpara, këto kam
4 thënë unë. Ky është fabrikim, kur e shef ti biografinë e
5 komandantit legjendar që një njeri s'e ka parë kurrë në jetën
6 e vet Adem Jasharin, s'e ka njof, veç e njeh fshatin nga
7 është, dhe kjo -- unë këtu jam thirr. E nderume, këtu jam
8 thirr unë, në këtë biografi të komandantit legjendar Adem
9 Jasharit. Këto jam thirrë.
10 Py. Dhe kur keni shpërndarë 1000 faqe përfaqësuese të
11 shtypit, ju s'keni pas kurrfarë ideje, domethënë nuk keni bërë
12 kurrfarë vlerësimi në qoftë se deklaratat e dëshmitarëve
13 përmbanin informacion të vërtetë apo gënjeshtër. A është kjo e
14 saktë?
15 Pë. Ma s'pari më vjen keq, kur thu "keni shpërnda". Ne s'kemi
16 shpërnda, ne i kemi lënë në tavolinë, ju kemi thënë
17 "fotografoni, shiqojini". Ne kuj s'i kemi thënë "merri
18 dokumentacionet". Kush ka dasht i ka marrë. Nën një. Nën dy:
19 ne i kemi tërheqë vërejtjen të gjitha mediave. Emrat s'guxohen
20 të publikohen dhe deklaratat s'guxohen të lexohen. Kjo ka qenë
21 dhe kjo është -- edhe qëndroj prapa asajna, tërë jetën time,
22 që të ruhet gjithmonë privatësia e çdo qytetari pavarësisht
23 kush është. A është serb, a është shqiptar, a turk, apo rom,
24 apo shkali. Se ne në Kosovë kemi shumë kombe që jetojnë,
25 kështu që i përmenda të gjithë. Pavarësisht kësajna.

1 Py. Po dhe kur e kenë bërë këtë, dhe kur ua keni vënë në
2 dispozicion shtypit rreth 1000 faqe ju nuk keni pas kurrfarë
3 ideje, kurrfarë informacioni në qoftë se deklaratat e
4 dëshmitarëve që ishin në atë grup dokumentesh përmbanin
5 informacion të vërtetë apo të rremë.

6 Pë. 1000 faqe s'i kam kontrollu, nuk e di a kanë qenë të
7 gjitha tash me deklarata apo me shënime, ato kanë qenë mbi
8 tavolinë. Unë të tregova, kam has në dokumentin e komandantit,
9 që tregova, biografinë e tina, ajo më ka befasu dhe për atë
10 dokument kam thanë është e fabrikume dhe është gënjeshtër.
11 Kështu ka qenë, për këto të tjera dokumente nuk i kam
12 kontrollu, se çka mrena tyne.

13 Py. Domethënë zoti Gucati, gjatë 7 shatorit ju i thatë
14 publikut që dokumentet që i ja dhatë shtypit përmbanin emra
15 dëshmitarësh dhe deklarata dëshmitarësh dhe ju në fakt këto
16 dokumente ua vutë në dispozicion atyre që ishin të pranishëm
17 në pres-konferencën dhe ju i quajtët dëshmitarët tradhtarë,
18 bashkëpunëtorë dhe shqipfolës. Kur e bëtë këtë, a menduat për
19 pasojat që fjalët tuaja dhe veprimet tuaja mund të kishin për
20 dëshmitarët. Pra dëshmitarët apo çdo person që në atë kohë i
21 kishte dhënë TFHS-së ose ZPS-së? A e menduat këtë gjë?

22 Pë. Për të gjithë -- po e përsëriti prapë: ata të cilët
23 kundër vendit tim dhe ata të cilët kanë protestu kundër NATO-s
24 që ka bombardu caqet serbe, për mu nuk mund të jetë tjetër
25 send veç jenë armik të vendit tim, dhe unë këtë e kam mendu

1 shumë mirë dhe shumë mirë po e tregoj. Unë ia kam tërheq
2 vërejtjen të gjitha mediave, emrat, privatësia e çdo njërit
3 duhet të ruhet dhe deklarata. Kjo qenë, kështu kam thanë dhe
4 kështu po them prapë. Edhe ata të cilët janë kundër vendit tim
5 dhe kundër NATO-s që kanë protestu në atë kohë, në vitin 1999,
6 janë armiq të vendit tim. Unë i falënderoj shtetet e NATO-s që
7 na kanë ndihmu për të çliruar vendin tonë, kjo është krejt.
8 Py. Dhe kur këto dokumente që përmbanin deklarata
9 dëshmitarësh ua vutë në dispozicion personave të pranishëm në
10 pres-konferencës së 7 shtatori, a e menduat që çfarë ndikimi
11 mund të kenë fjalët dhe veprimet tuaja mbi dëshmitarët që
12 kishin dhënë deklarata, që kishin dhënë deklarata TFHS-së dhe
13 ZPS-së. Ju lutem t'i përgjigjeni kësaj pyetje.
14 Pë. Jo, s'kam mendu se e kam frikësu asnjë dëshmitar, as i
15 kom kërcnu asnjë dëshmitari. Dhe prapë po them, asnjë
16 dëshmitari në jetën time s'ju kam kërcnu, se nuk e di kush
17 janë. Në del një dëshmitar të më thotë që Hysni Gucati mu ka
18 kërcënu, unë do ta pranoj fajësinë. Por nuk ka dhe nuk mund të
19 gjesh -- kurrë s'ke me gjet që unë ju kam kërcënu dikujna. As
20 përmes shtypi, as përmes intervistave të mia, po as përmes
21 debateve televizive që kam pas. Kjo është përgjigja ime.
22 Py. Në atë rast ju thatë që emrat dhe deklaratat ishin të
23 disponueshme për të gjithë që donin t'i marrin këto
24 dokumente. Dhe ju i quajtit këta persona si tradhtarë. A nuk
25 mendoni që kjo ka mund të shkaktojë stres apo frikë, apo

1 shqetësime rreth sigurisë për ata që deri në atë moment kishin
2 bashkëpunuar me TFHS-në apo ZPS-në?

3 Pë. Më vjen keq, unë -- e ki edhe në media. Unë e kam
4 revistën në paraburgim, aty ku jam, që unë kam ba thirrje
5 atyne dëshmitarëve që të japin dëshmi para juve. Për hir të
6 shtetit, për hir të luftës dhe për hir të dëshmorëve, që çdo
7 send të del në shesh. Kështu që mu më vjen keq, ku e ke gjetur
8 këtë fjalë nuk e di. Unë s'ju kam kërcënu kurrkujna. Ata që
9 janë kundër shtetit tim dhe kundër NATO-s janë armiq të vendit
10 tim. Këtë e përsëris 100 herë. Nuk e di sa herë duhet të them.
11 A unë jam ai që i kam ba thirrje të gjithë atyne, i ke në disa
12 revista dhe portale që kam ba thirrje, atyne dëshmitarit që e
13 din diçka, t'u japin ju informacion.

14 Py. Zoti Gucati, ju nuk ndërmeret kurrfarë hapash për t'i
15 redaktuar emrat e dëshmitarëve nga dokumentet që ua vutë në
16 dispozicion shtypit. A është kjo e saktë që nuk ndërmeret
17 hapa?

18 Pë. -- nuk shumëzohj dokumentacione, as nuk redaktoj
19 dokumentacione, as i kam shkru ato dokumentacione, ato kanë
20 dalë nga zyra juaj, dhe unë i falënderoj edhe atyne mediat pse
21 s'i kanë qit emrat, kanë ba shumë mirë, edhe s'kanë dhënë
22 deklarata. Ato në një farë forma kanë qenë të gjitha të
23 redaktume se s'i kanë qit emrat askush. Kjo është.

24 Py. Po ju keni mundur që të mos i nxirrni emrat e
25 dëshmitarëve dhe deklarata e tyre por prapë se prapë vendosët

1 që mos ta bëni këtë. A është e kjo e saktë?

2 Pë. Ne e kemi bërë këtë që ju kemi thënë mediave "mos
3 publikoni emrat dhe deklaratat". Kjo është shumë e saktë, që e
4 kemi thënë kështu.

5 Py. Dhe e keni kërkuar këtë gjatë kohës që -- domethënë

6 njëkohësisht kur i keni ofruar këto dokumente që kanë

7 përmbajtur emra dëshmitarësh shtypit. A është kjo e saktë?

8 Pë. Në të gjitha debatet, jo vetëm unë por edhe shokët e mi

9 kanë kërkuar që emrat të mos zbulohen, në të gjitha debatet

10 televizive dhe të gjitha intervistat. Ka, mund të jetë ndonjë

11 nervoz, por jo nuk e besoj se ne i kemi thënë dikuj. Fare s'i

12 kemi thënë askujt që merre dhe publiko një emër, apo një

13 person të një komune të një fshati apo një deklaratë të

14 dikujna.

15 Py. Zoti Gucati, ju e dini se dëshmia e dëshmitarit është

16 pjesë thelbësore e procedimit penal të krimeve të luftës

17 kundër pjesëtarëve të UÇK-së, apo jo?

18 Pë. Unë prapë po them nuk e di si një dëshmitar ka dalë deri

19 sot dhe ka deklaruar që m'u ka zbulu identiteti i tina. Nuk e di

20 që ka dalë deri sot, për 15 muaj që jam unë në burg, mbas

21 këtyre rasteve që kanë dikush dhe ka deklaruar që m'u ka përmend

22 emri apo m'u ka lexu deklarata.

23 Py. Pyetja ime ishte ndryshe: a e dini që deklarata e

24 dëshmitarit është pjesë e rëndësishme e procedimit penal duke

25 përfshirë këtu edhe procedimin penal të pjesëtarëve të UÇK-së.

1 A e dini këtë gjë si fakt?

2 Pë. Tuk si ka qenë pjesë e rëndësishme, ne s'i kena publiku
3 as emra, as dëshminë, kjo është reale. Në momentin që ne s'e
4 kemi publiku dokumentacionin, as emrin e tina, është reale që
5 ne e kemi rujt atë njeri dhe e kemi ruajtur atë deklaratë të
6 tina.

7 Py. Faleminderit. Zoti Gucati, gjatë tre konferencave për
8 shtyp të mbajtura me 8, 17 -- më falni -- dhe 22 shtator, a e
9 autorizuat Nasim Haradinajn që ta thoshte gjithë atë që tha
10 gjatë këtyre tre konferencave për shtyp. A është kjo e saktë?

11 Pë. Ne nuk mujt të autorizojmë se s'kemi nevojë, se unë jam
12 kryetari i organizatës, Nasimi është nën kryetar, kështu që ne
13 nuk kemi përgatit një deklaratë të shkruar që të çaj të flas
14 unë para mediave, kam thanë edhe në ditët në vijim. Kam thanë
15 që ne kemi ftuar konferencë për shtyp dhe ne nuk e dimë çaj na
16 pyesin gazetarët. Kështu që ato autorizimi nuk kemi pas nevojë
17 të ketë as Nasimi, e asnjë. Ne -- unë jam kryetar dhe Nasimi
18 është nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës, kështu
19 që nuk kemi pas nevojë të kemi autorizim fare. Po do të thotë
20 që mendimin e tij e kam përkrah se çaj ka fol.

21 Py. Faleminderit. Dhe e keni përkrahur krejt atë që e ka
22 thënë gjatë të tre konferencave për shtyp, a është kjo e
23 saktë?

24 Pë. Duke besu punën dhe veprën e familjes së Nasim
25 Haradinajt, 37 vite në burg, që duke e dit unë që në Nasimi

1 s'gabon, dhe s'ka gabu, është shumë e saktë që Nasimi nuk e lë
2 etika vetë morale dhe e punës në organizatë që ka që të
3 gabojë. Dhe unë e di që Nasim Haradinaj nuk ka përmendur emra,
4 me sa di unë dhe nuk është lëshu ndonjë deklaratë që e dëmton
5 një dëshmitar. Kështu e di unë të paktën. Kështu e di dhe
6 kështu kam dëgju.

7 Py. Në paragrafin 20 të deklaratës që ia keni dhënë avokatit
8 tuaj, ju thoni:

9 "Ja dhashë fjalën pastaj Nasimit. Nuk mendova që Nasimi
10 do të thoshte diçka të paligjshme".

11 A tha diçka të paligjshme Nasim Haradinaj gjatë kësaj
12 pres konference?

13 Pë. Është shumë reale që unë e kam hap takimin e pari, të
14 gjitha takimet edhe pse isha me shëndet, kam qenë shumë i
15 dobët se kam qenë i smut, se jam edhe me diabet dhe është
16 shumë reale, unë kam fol nja tre-katër minuta po mund të jenë
17 edhe pesë, dhe ndërkohë ja kam kalu fjalën Nasim Haradinajt,
18 dhe Nasimi i ka fol ato që ja ka ndi shpirti dhe truni kështu
19 që ato që sa kam ndigju unë, sa kam mujt të kapi fjalët e
20 tina, asnjë fjalë s'besoj se ka qenë e paligjshme apo që ka
21 kundërshtu dikënin, apo që ka fy dikan.

22 Py. Po a ka diçka prej atyre që tha zoti Nasim Haradinaj në
23 pres konferencë apo gjatë paraqitjeve publike që janë nxjerrë
24 në këtë çështje, që ju -- me të cilat ju nuk do të kishit - do
25 të ishit pajtuar?

1 Pë. Nuk e kuptova pyetjen edhe një herë në se ka mundësi? Se
2 m'u duk se pyetja si në gjysët.

3 Py. A ka diçka prej atyre që ka thënë Nasim Haradinaj gjatë
4 tre pres-konferencave dhe të paraqitjeve publike të tjera në
5 lidhje me dokumentet që u vunë në dispozicion, u bënë publike
6 nga OVL UÇK-ja që prej të cilave ju vetë do të tërhiqeshit, të
7 cilat ju nuk i përkrahni?

8 Pë. Nuk e besoj se ka, s'kam ndigju diçka se unë do t'i kisha
9 thënë në prezencë Nasimit: mos, kam vërejt që ke gabu. Po jo
10 nuk kam dëgju, kështu që nuk e besoj se Nasimi në këtë moshë
11 dhe këto vuajtje të veta që gabon diçka rreth këtyne
12 dokumentacioneve që kanë rrjedh nga zyrat e juve. Kështu që
13 unë nuk e besoj që Nasim Haradinaj mund të ketë lëshu ndonjë
14 gabim, nuk e besoj. Kështu që s'më kujtohet sinqerisht te
15 fjalimi i tina. Po unë mendoj që s'ka gabu.

16 Py. Dhe në lidhje me paraqitje të tjera publike të Nasim
17 Haradinajt gjatë periudhës midis pres-konferencave, pra midis
18 datës 7 dhe 22 shtator, a keni dëgjuar apo a keni kuptuar për
19 ndonjë deklaratë me të cilën ju nuk pajtoheni që ju mendoni se
20 nuk duhej të ishte bërë në emër të OVL UÇK-së?

21 Pë. Nuk e di që ka muj të jetë ndonjë deklaratë e Nasimit. Sa
22 kem qenë bashkë e kam fjalën, gjithmonë bashkë që kemi qenë në
23 tre konferencat, që Nasimi të ketë lëshu ndonjë deklaratë që
24 dëmton Organizatës së Veteranëve apo dëmton shokët, kështu që
25 Nasimi nuk është i vogël, fëmijë, dhjetë vjet apo shtatë vjet,

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 54

1 por mbi moshën 50 vjeçare, 55 vjeçare mbi dhe e di këtë po unë
2 që Nasimi nuk do të lëshohet në ato raste që të gabojë apo të
3 t'ja tërheki vërejtjen unë Nasimit.

4 Pë. Domethënë ju asnjëherë nuk keni menduar që gjatë këtyre
5 paraqitjeve publike të zoti Nasim Haradinaj ai të ketë bërë
6 ndonjë deklaratë me të cilën ju nuk pajtoheni?

7 Z. REES: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pyetje. E kam
8 kritikuar edhe pyetjet që janë bërë më herët që për mendimin
9 tim janë sfidë e kujtesës dhe kjo është një shembull i qartë i
10 atyre pyetjeve. Ta pyesësh dëshmitarin që të kujtohet për
11 ngjarjen në të cilën ai vetë nuk ka qenë i pranishëm apo për
12 deklaratë që i ka bërë zoti Haradinaj, për mendimin këto janë
13 padrejtësi e madhe. A ka ndonjë pjesë konkrete të
14 transkriptime nga këto prova materiale që zonja Boilici do të
15 mund të t'ia parashtrojë zotit Gucati dhe ta pyesë konkretisht
16 për atë pjesë të transkriptimit. Kështu duhet të veprojnë zonja
17 Bolici. Unë e kundërshtoj këtë qasje të padrejtë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
19 Kundërshtimi hidhet poshtë se pyetja ishte shumë e drejtë. E
20 pyeti në qoftë se ai ka qenë në dijeni për këtë.

21 Vazhdoni, zonja Bolici.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

23 Py. Zoti Gucati, ju e dini që zoti Haradinaj ka dhënë disa
24 intervista në televizor dhe në shtyp midis datave 7 dhe 25
25 shtator të vitit 2020. A ju kujtohet, a dini për ndonjë rast

1 kur Nasim Haradinaj ka thënë ndonjë gjë që për mendimin tënd
2 nuk duhej ta kishte thënë, që ju vetë e konsideroni të gabuar?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Urdhëroni,
4 zoti Worboys?

5 Z. WORBOYS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj ndjesë
6 që po ndërhyj, ju ndërpres, mirëpo edhe unë paraqes
7 kundërshtimin tim për këtë lloj pyetjesh mbi bazën që përdor
8 zonja Bolici.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Hidhet
10 poshtë kundërshtimi.

11 Vazhdoni Prokurore.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

13 Py. Zoti Gucati, midis datës 7 dhe 25 shtator, a ka thënë
14 Nasim Haradinaj diçka publikisht që ju vetë nuk e pranoni, apo
15 prej të cilët ju vetë hiqni dorë?

16 Pë. E nderume, nëse ka mundësi, se Nasimi ka japë intervista
17 të shumta edhe unë gjithashtu. Është mirë të na tregoni datën,
18 orën në cilin emision, apo në cilin medium, apo në cilin
19 portal ka dhënë intervistë Nasimi. Kështu që unë nuk më

20 kujtohen të gjitha, se ne kemi dhënë shumë intervista të dy.
21 Kështu është mirë ta ma përkujtoni nëse keni ndonjë
22 transkriptim, na e qitni këtu përpara dhe unë do të tregoj.

23 Nuk e di për cilën datë e ke fjalën, për cilin rast. Unë po e
24 kujtoj datat, 7 deri në 22 shtator, por në cilën kohë, unë
25 s'muj të flas vetëm përmendësh, vetëm me hamendje. Se muj të

1 gaboj, po është mirë të na qitni përpara. Unë me sa di, me sa
2 di, nuk kam dëgju. Gjithmonë e them, nuk kam dëgju ato sa i
3 kam mujt me përcjell. Kjo është.

4 Py. Zoti Gucati, ju i keni ndjekur daljet në publik të zotit
5 Haradinaj. A fliste ai në emër të Organizatës së Veteranëve të
6 Luftës të UÇK-së?

7 Pë. Po jo mor se s'kam pas kohë t'i ndjekë të gjitha debatet
8 televizive. Më vjen keq, s'kam pas kohë se s'kam mujt merrem
9 unë vetëm me debatet televizive që të rri para ekranit
10 televiziv me orë të tëra, se m'u ka dash të punoj unë. Unë jam
11 njeri që kam familje, duhet të punoj, unë s'kam nejt para
12 ekranit televiziv që t'i ndjekë të gjitha debatet.

13 Py. Dhe nga ato që ju keni ndjekur, nga ato që ju kujtohen, a
14 vutë re ndonjë gjë që ju mendoni që nuk duhet ta kishte thënë,
15 diçka që ju e konsideroni si të gabuar që e ka thënë.

16 Pë. Unë e thashë edhe ma herët, nuk e di dhe nuk e besoj se
17 Nasim Haradinaj gabon. Thashë edhe më herët. Nuk e di. Ato që
18 kam mujt me dëgju me vesh dhe ça ka mujt me ba -- nuk e di.
19 S'ka dëgju që të ketë thanë ndonjë fjalë. Aq sa kam nigju. E
20 kam fjalën gjithmonë sa kam qenë prezent apo sa kam nigju.

21 Py. Dëshiroj që t'ju tregoj, zoti Gucati, transkriptin e
22 konferencës së parë për shtyp.

23 Në veçanti, është prova me numër P0001. Dëshiroj që të
24 dalë versioni në shqip dhe në anglisht në ekran, krah për
25 krah. Faqja përkatëse është faqja me numër 3.

1 Py. Zoti Gucati, në mes të kësaj faqeje, përpara asaj kutisë
2 së zezë që ju shihni në ekran, është pjesa ku zoti Haradinaj
3 ka deklaruar:

4 "Këto shënime, këto emra, këto mbiemra, tani ata duhet ta
5 dinë sepse janë emra të ditur dhe askush nuk është më i
6 paditur, i panjohur, sepse vendi i saktë, deklarata e saktë --
7 më falni, deklarata tjetër pastaj kur e ka dhënë, të gjitha
8 janë këtu".

9 Ju a i qëndroni fjalëve të zotit Haradinaj këtu ku ai
10 përmend dëshmitarët dhe thotë se ata nuk do të jenë më të
11 paditur, të panjohur, sepse deklaratat që kanë dhënë janë bërë
12 të ditura këtu në këtë konferencë për shtyp?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po zoti
14 Worboys?

15 Z. WORBOYS: [Përkthim] Nuk e di, mbase është në
16 transkriptim, po nga ka -- nga është ky transkriptim?

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është konferenca e parë për
18 shtyp, e datës 7 shtator, 2020. Është prova P1.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

20 Py. Zoti Gucati, ju i keni qëndruar këtij qëndrimi, këtyre
21 fjalëve të zotit Haradinaj, kur ai thotë se këta dëshmitarë
22 nuk do të jenë më të paditur sepse këto deklarata të këtyre po
23 e tregoheshin personave të pranishëm në konferencën për shtyp.
24 Kështu është?

25 Pë. Unë nuk e kam dëgju, nën një. Dhe të tëna -- tash na ka

1 dalë një transkriptim tjetër. Këtu përmenden David Schwendiman
2 dhe keni -- unë s'jam me përmend këtu diçka. Unë s'kam tjetër
3 këtu të shkrome, e nderume, te unë.

4 Py. Zoti Gucati, nëse shihni faqen përpara jush, në mes të
5 faqes, mu përpara kutive të zeza, janë disa kuti të zeza aty,
6 ka një pjesë që thotë -- fillon aty ku thotë në shqip "dhe
7 këto shënime" -- kërkoj ndjesë për shqiptimin jo të mirë.

8 E gjetët pjesën?

9 Pë. Po e gjeta, e nderume.

10 Py. Në rregull. Kur zoti Haradinaj tha se emrat e të gjithë
11 personave që janë thirrur nuk do të ishin më të fshehtë, të
12 paditur, pra, sepse vendi i saktë i intervistës tani dihej,
13 juve nuk ju duk gjë e keqe kjo?

14 Pë. Po, jam duke lexuar dhe edhe ato nuk e besoj se ka qenë
15 diçka e keqe për arsye se Nasimi s'ka përmend një emër të
16 caktum, nuk e përmend asnjë emër, nuk e lexon asnjë emër, nuk
17 e lexon asnjë deklaratë, nuk e tregon asnjë dëshmi të tyre se
18 ku kanë jepe deklarata apo diçka, kështu që unë kam mendu që
19 s'ka shkel kurrgjë procedurat Nasimi. Kështu mendoj edhe
20 kështu shkruan edhe këtu. Po kjo që e ka thënë Nasimi është e
21 saktë, por Nasimi nuk ka përmend asnjë emër të një dëshmitari.

22 Py. Po. Faleminderit.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të kalojmë tani te faqja numër 5
24 e këtij transkriptimi. Po të shihni, zoti Haradinaj, në mes të
25 faqes fjalia që fillon me fjalët: "Edhe tashti shohim" ...

1 Kërkoj ndjesë sërish për shqiptimin tim. E gjetët pjesën
2 përkatëse?

3 Do ta lexoj në anglisht, mbase përkthehet. Kur zoti
4 Haradinaj tha:

5 "I kemi një kopje dhe do ta mbrojmë në emër të Zotit dhe
6 mund t'ju jap sa kopje të doni, mund të lexoni, mund të lexoni
7 sa emra të doni. Nuk do të ketë më të -- nuk ka më nevojë të
8 thoni që ky person tha këtë, ky person tha atë. Ja ta shohim
9 tani. T'ua shikojmë guximin. Guximin tuaj, guximin tonë,
10 guximin e deputetëve të Parlamentit".

11 Kur Nasim Haradinaj tha këtë, zoti Gucati, ju pajtoheshit
12 që personat që merrnin pjesë në konferencë për shtyp duhej t'i
13 lexonin dhe të merrnin kopje të këtyre dokumenteve ku ishin
14 emrat e këtyre?

15 Pë. Jo, Nasimi ka thanë këtu: "Ju nuk guxoni t'i qitni
16 emrat". Nuk mund -- duhet të lexohet e gjithë fjala. Edhe pse
17 një kopje na e kemi, në emër të Zotit, e ruaj dhe ju a japim
18 kopje sa të doni. Se s'guxojmë -- nuk guxoni". Dhe është ai që
19 nuk guxon t'i qet kurrkush emrat e kurrkujna. As deklaratat e
20 kujna të qiten në publik. Ndaj po them, kopja ka qenë në
21 tavolinë, të gjitha kopjet kanë qenë në tavolinë, ku ne kemi
22 mbajt konferencë për shtyp dhe ato kanë -- kush kanë dash prej
23 mediat kanë mujt t'i fotografojnë edhe t'i marrin. Kjo është
24 reale.

25 Py. Ju lutem a mund të tregoni fjalinë përkatëse për të cilën

1 e keni fjalën kur ta thënë Nasim Haradinaj --

2 Pë. "Nuk guxoni me i lexu ju emrat, kuptoni? Nuk guxoni me i
3 lexu". Jo "guxoni me i lexu" por "nuk guxoni me i lexu". Ju
4 kisha lutë.

5 Py. A po nuk tha -- nuk keni thënë ju: "Mund të lexoni emra
6 sa të doni". Unë nuk e shikoj fjalën "nuk" në këtë fjali. A ka
7 fjalë "nuk" në këtë fjali, zoti Gucati?

8 Pë. -- i ka -- janë kopje. Te kopjet është fjala, ja ku e
9 keni përmbi: "Ju jap kopje, sa të doni -- ju të lexoni sa të
10 doni". Të lutem, kopje. "Ju të lexoni sa të doni". Mundet ta
11 shqiptoni mirë dhe përkthyesin e kisha lutë që këtë tekst
12 t'jua përkthejë qysh është, bukfalisht e shkrome shqip, në
13 gjuhën shqipe.

14 Py. Kam edhe këtë:

15 " .. do t'ju japim kopje sa të doni".

16 Pastaj fjalia në vijim thotë:

17 "Mund të lexoni sa emra të doni këtu".

18 A është e saktë kjo?

19 Py. Kjo është e saktë sa guxoj me lexu. Ju lutem, në këtë -
20 "keni të drejtë", a po "mundeni". Unë nuk jam gju... se nuk
21 kam kry letërsinë, s'jam gjuhëtar, por gjuhën shqipe e kuptoj
22 dhe e di. Kjo është.

23 Py. Pra nuk -- pra mendoni që s'ka asgjë të keqe në këtë
24 pjesë të konferencës për shtyp, kështu?

25 Pë. [E padëgjueshme] të keqe në këtë konferencë për arsye se

1 s'ka përmend emra. Nuk dua ta mbroj unë Nasimin. Të jeni të
2 bindur, se secili mban barrën për veti dhe ju [e pakuptueshme]
3 edhe Nasimi se ne s'jemi të vogël, po nuk dua të mbroj Nasim
4 Haradinajn. Po unë besoj se përderisa Nasim Haradinaj nuk ka
5 përmendur emra dhe deklaratë dhe ju tërhiqet vërejtja mediave
6 që "mos bëni publike" ashtu unë e mendoj. Por tek e fundit
7 jemi të dy në një bankë të të akuzuarve kështu që unë e mendoj
8 që Nasimi s'ka bërë vepër. Unë e mendoj ashtu.
9 Py. Faleminderit.

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj të kalojmë tani në
11 konferencën e tretë për shtyp. Është prova me numër P0035. Të
12 nderuar Gjykatës, dëshiroj që të kalojmë shumë pak, nja pesë
13 minuta në seancë private nëse është e mundshme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
15 çaktivizuar].

16 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
17 këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
19 Buckley, ju rikujtojmë se nuk do ta dëgjoni sinjalin audio kur
20 të kalojmë në seancë private, por mund të lexoni transkriptim.

21 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit
22 për informimin.

23 Unë e kam paraqitur kundërshtimin tim për faktin që s'jam
24 në gjendje për çdo pjesë që bëhet në pjesë private, sepse kjo
25 nuk është efikase për procesin apo nuk e ndihmon zotin

1 Haradinaj. Unë jam në dijeni të mendimit të Trupit Gjykses,
2 thjeshtë e rishpreh kundërshtimin tim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju kuptoj,
4 kundërshtimi rrëzohet.

5 Kalojmë në seancë private.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
7 Buckley, ah, po kemi kaluar në seancë private tani.

8 Zoti Buckley, transkriptimin e shihni?

9 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk e
11 keni?

12 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë
13 transkriptimin do ta shikoj pas zhvillimit të seancës po jo në
14 kohë reale dhe kjo është një prej arsyeve që përse kam bërë
15 kundërshtim, kur kemi filluar këtë procedurë dhe ishim në
16 dijeni që zoti Cadman nuk do të ishte në gjendje që të merrte
17 pjesë në proces.

18 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
19 këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Keni qasje
21 në transkriptim në kohë reale.

22 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju
23 falënderoj, do ta kontrolloj.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Unë dua të
25 sigurohem që të jeni mirë në dijeni se çfarë keni në

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 63

1 dispozicion.

2 Z. BUCKLEY: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju dëgjova,
3 dhe e pranoj.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
5 Worboys, jeni i pranishëm. Faleminderit që pritët.

6 Zonja Bolici, mund të vazhdoni mbasi të kalojmë në seancë
7 private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 64

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 65

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 66

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

25 jemi rikthyer në seancë publike.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregojmë dëshmitarit
2 prova dëshmitarit provën me numër P6 si është në versionin
3 shqip ashtu edhe në versionin anglisht. Janë publike. Dhe
4 dëshirojmë të kalojmë ju lutem në faqen 26.

5 Nëse keni kundërshtim, të nderuar Gjykatës preferoj që të
6 bëjmë pushimin e drekës më herët sot nëse është e mundshme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
8 çaktivizuar].

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj që ta bëjmë tani
10 pushimin dhe të rifillojmë pas pushimit të drekës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dëshironi
12 që ta mbyllim më herët këtë seancë e pastaj të -- ka ndonjë
13 arsye?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk është se ka ndonjë arsye të
15 veçantë. Do të doja që të riorganizohesha. Mund të vazhdoj.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Të
17 vazhdojmë atëherë për momentin.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kujtova se bëhej pushimi në orën
19 12.30, po jo qenka në orën 13. Faleminderit, faleminderit.
20 Py. Dëshiroj të kalojmë në një temë disi tjetër, zoti Gucati,
21 dhe dëshiroj t'ju pyes nëse -- ose më saktë dua që t'ju
22 drejtoj te paragrafi 39 i deklaratës suaj, ku thoni që:

23 "Tom Gashi më ka këshilluar që po veproja në mënyrë të
24 ligjshme nëse nuk përmendja emrin e një dëshmitari, prandaj
25 dhe isha shumë i kujdesshëm që ta shmangja këtë gjë".

1 Pra, pretendoni që Tom Gashi ju ka këshilluar që po
2 vepronit në mënyrë të ligjshme nëse nuk përmendi emrin e një
3 dëshmitari. A mund të na thoni ju lutem, se kur e keni bërë
4 këtë bisedë me Tom Gashin?

5 Pë. Unë kam qenë në debate televizive me Tomën dhe ma -- para
6 se të jetë avokati i organizatës, po edhe mbasi ka qenë
7 avokati i organizatës. Unë dua ta falënderoj Tomën shumë nga
8 kjo karrige ku jam ulur unë dhe nga kjo seancë. Toma asnjë
9 herë mua s'më ka thënë që -- Toma mua ma ka tërhequr vërejtjen
10 gjithmonë. Thotë "Hysni, emrat që janë të ndalum dhe
11 deklaratat janë të ndalume rreptësisht të bëhen publike". Dhe
12 kështu që unë e falënderoj shumë që me kohë e ka tregu që edhe
13 pse emra ne s'kemi përmendur kurrë, që tregon që emrat dhe
14 deklaratat nuk guxon të përmenden për arsye e dëmtohet procesi
15 dhe kështu ne nuk kemi përmendun emra. As unë, as Nasimi, as
16 Toma. Dhe Toma vetëm këto ka thënë dhe Toma për të tjerët --
17 dhe Toma nuk është iniciator ndoshta, që ju mendoni, që ka
18 thënë "keni të drejtë të dilni me dokumente ju ti qitni hapur.
19 Jo. Toma s'na ka thënë neve që ju keni të drejtë të publikoni
20 dokumentacione. Asnjëherë s'e ka thënë Toma këtë. As ka thënë
21 Toma që ju keni të drejtë të dilni në konferencë. Ai ka thënë:
22 emra, mbiemra, vende të ngjarjes, deklarata, nuk guxon të
23 përmendni. Po edhe nuk na ka thënë që ne kemi të drejtë të
24 dalim në publik qysh i kemi ftuar mediat në tri konferenca.
25 Py. A tha ai që ju mund t'i shpërndani dokumentet personave

1 të pranishëm në konferencë për shtyp?

2 Pë. S'kam pyetur kurrë në këtë drejtim se jam kryetari i
3 Veteranëve të Luftës dhe s'e kam pyetur kurrë. Tomën nuk e kam
4 këshilltar. Toma ka qenë avokati i organizatës, kurrë s'e kam
5 pyetur.

6 Py. Pra morët vendim që ta shpërndanit këtë dokument pa
7 kërkuar këshillim nga një avokat.

8 Pë. Të lutem ne nuk kemi shpërndarë. Ne jemi -- i kemi lënë
9 në tavolinë -- ne vetëm kemi tregu. Kanë dalë disa dokumente
10 nga Gjykata Speciale që për ne ka qenë një befasi, se të dalin
11 ato dokumente nga zyrat e juve. Më përpara, te ne thotë një
12 fjalë popullore: "Kisha menduar vdekjen se sa të dalin
13 dokumentacionet nga ju". Kjo është fjalë popullore që përdoret
14 te ne. Edhe unë po ju them. Më përpara kisha mendu të vdes
15 pesë herë se sa të dalin këto dokumentacione t'juvet dhe të na
16 vijjnë në zyrat tona. Këtë kush e ka bërë, me qëllimet të
17 caktume apo pa qëllime, për me na qit neve në lajthitje, ju e
18 dini më mirë se na.

19 Py. Zoti Gucati, ju vazhdoni të thoni se nuk i keni
20 shpërndarë dokumentet. Në konferencën e parë për shtyp, për
21 shembull, keni qenë me katër kopje identike të dokumenteve apo
22 jo?

23 Pë. Unë kam qenë aty dhe kam thirrur konferencën, thashë edhe
24 më herët, por ne s'kemi shpërndarë - ne s'jemi mbledhur për me
25 shpërnda. Ju duhet ta zbuloni njeriun që ju ka vjedhur - ju i

- 1 keni shpërndarë, jo unë. Momentin që më kanë ardhur në
2 Prishtinë prej Holande, atëherë shpërndarja vjen nga ju, jo
3 nga unë.
- 4 Py. Zoti Gucati, ju lutem përgjigjuni pyetjes: ju shkuat në
5 konferencën për shtyp me katër kopje të dokumenteve. Është
6 kështu apo jo?
- 7 Pë. Unë kam thirrur konferencën për shtyp, është shumë e
8 vërtetë.
- 9 Py. Dhe kur shkuat në konferencën për shtyp, kur hytë aty,
10 kishit katër kopje të dokumenteve. Është e vërtetë apo jo?
- 11 Pë. Është e vërtetë që i kisha katër kopjet t'juve që i ka
12 sjellë një burrë nga zyrat e juve. Është shumë e vërtetë që
13 këtë s'do ta mohoj kurrë.
- 14 Py. Dhe kur dolët nga konferenca për shtyp, kishit një kopje
15 të dokumenteve me vete. Kështu është?
- 16 Pë. Atë kopje ne e kemi lënë -- që këna bërë ftesë publike
17 Prokurorisë së Kosovës që vjen t'i merr, Gjykata Speciale e
18 Kosovës vjen t'i merr ato kopje dhe nuk është ardh. Këna bo
19 thirrje publike edhe hetueseve tuaj që të vijnë dhe ata kanë
20 ardhur në një ditë, me datën 8 shtator kanë ardhur dhe i kanë
21 marrë. Kjo është e vërtetë.
- 22 Py. Po. Latë tre kopje për ata që ishin të pranishëm në
23 konferencën për shtyp që t'i merrnin me vete. Është kështu?
- 24 Pë. Ne s'ju kemi thënë "merrini", por i kemi thënë "ja ku
25 janë, mbi tavolinë". As kujt s'i kemi thënë "merrini". Asnjë

1 gazetari s'i kam detyru, që të detyrojmë me dhunë "merrini".

2 Py. E qartë. Kur biseduat për herë të parë me zotin Tom

3 Gashi? Kjo ka ndodhur pas konferencës së dytë për shtyp, apo

4 jo?

5 Pë. Nëse s'gabaj, jo, pas konferencës së parë. E kemi marrë

6 Tomën avokat, kështu që ka -- po, mbas konferencës së parë e

7 kemi marrë Tomln, po, dhe kam bisedu te konferenca e dytë.

8 Është e vërtetë.

9 Py. Pra ishte gjatë konferencës së dytë për shtyp që keni

10 biseduar për herë të parë me zotin Tom Gashi. Kështu?

11 Pë. Po. Po, po.

12 Z. REES: [Përkthim] --

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Një moment.

14 Z. REES: [Përkthim] A mund ta sqarojë zonja Bolici se ka

15 pasur një intervistë ku zoti Gashi ka qenë i pranishëm dhe ka

16 biseduar me zotin Gucati gjatë konferencës së dytë për

17 shtyp.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

19 Py. Zoti Gucati, nuk keni biseduar me zotin Tom Gashi përpara

20 konferencës së parë për shtyp. Kështu?

21 Pë. Po shumë e vërtetë. S'kam biseduar me të.

22 Py. Dhe nuk keni biseduar me zotin Gashi përpara konferencës

23 së dytë për shtyp, apo jo?

24 Pë. Nuk ka qenë i pranishëm zoti Tom Gashi në konferencën e

25 dytë. Shumë e vërtetë.

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 72

1 Py. Pra hera e parë që keni biseduar me zotin Tom Gashi ka
2 qenë pas konferencës së dytë për shtyp. Kështu?

3 Pë. Mbase është përfunduar konferenca e dytë, Toma ka ardhur
4 në zyrën time dhe kemi biseduar. Do të thotë mbasi është kryer
5 konferenca që e kemi ftuar ne një konferencë, ai -- Toma ka
6 ardhur mbas konferencës, është reale, që kemi kry ne. Kanë
7 qenë disa dosja kur ka ardhur t'i marrë hetuesi juaj që fliste
8 shqip, ka ardhur t'i merr dokumentet. Atëherë ka qenë Toma.

9 Py. A ndryshoi diçka në mënyrën se si e trajtuat paketën e
10 tretë të dokumenteve pasi biseduat me zotin Tom Gashi?

11 Pë. Po, ka ndryshuar. Toma më ka këshilluar që këto
12 dokumentacione t'ja japim hetuesit tuaj që flet shqip, në
13 prezencën e tina, që për mu ka qenë shumë e qëllume se ne në
14 fillim nuk kemi pranuar t'ja japim dokumentacionin për arsye
15 që dëshironim që të vinte edhe policia e Kosovës, të jenë në
16 cilësinë e dëshmitarëve që t'i marrin ato dokumentacione. Se
17 ne na humbi besimi i dikur edhe nga ju. Se kur kanë rrjedhur
18 ato dokumentacione, aty humbet besimi. Dhe kjo ka qenë arsye
19 pse s'kemi dashur pa prezencën e dikujt t'ju japim
20 dokumentacionet.

21 Py. Zoti Gucati, tashmë i kishit dorëzuar zyrës së Prokurorit
22 të Specializuar dokumente me datën 8 shtator të vitit 2020,
23 apo jo?

24 Pë. Unë isha në pushim, këtë e kam deklaruar edhe para dy
25 dite, më 8 shtator. Po Fatoni i ka dorëzuar dhe është dorëzim-

- 1 pranimi, është i dokumentacionit dhe Fatoni mua më njoftoi në
2 telefon, që më shkruan një mesazh dhe unë e thirra Fatonin.
3 Është reale që me 8 shtator janë dorëzuar nga Faton Klinaku.
4 Py. Domethënë e kishe autorizuar Faton Klinakun që t'ja
5 dorëzonte dokumentet përfaqësueseve të Zyrës së Prokurorit pa
6 kërkuar këshillën juridike të Tom Gashit. A është kjo e saktë?
7 Pë. E saktë është, se Toma s'ka qenë atëherë, e thashë edhe
8 më herët. Fatoni më ka telefonua dhe i kam thënë "jepja
9 komplet dosjen hetueseve, se neve nuk na hyn në punë dhe
10 s'na.." - është reale që ne s'na hyn në punë.
11 Py. Domethënë nuk të është dashur këshilla juridike e Tom
12 Gashit për të marrë vendim në qoftë se këto do t'i jepen apo
13 jo këto dokumente Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Është
14 kjo e saktë?
15 Pë. Shumë e saktë. Unë nuk e kam pyetur Tomën fare se s'ka
16 qenë Toma, thashë. Toma ka - ne e kemi autorizuar Tomën mbas
17 konferencës së parë, e kemi autorizuar avokat të organizatës
18 dhe kjo është shumë e saktë. Tomën s'e kam pyetur.
19 Py. Në lidhje me bisedën që ke pasur me zotin Klinaku, me
20 datën 8 shtator, kur e ke autorizuar atë për të bërë dorëzimin
21 e dokumenteve, ju thatë që në këtë rast nuk ju është thënë që
22 një urdhër i Gjykatës i ishte dorëzuar në emrin tuaj,
23 Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. A është kjo
24 saktë?
25 Pë. Fatoni punon që 20 vite, ato vetëm nëse më jepet mundësia

1 30 sekonda. Punon që 20 vite dhe Fatoni s'ka nevojë të fshehë
2 asnjë dokumentacion ndaj -- kundër meje apo ndaj një shoku.
3 Fatoni mua më tregon një dokumentacion, një vendim që ka
4 ardhur nga ju që thotë "t'i dorëzohen të gjitha
5 dokumentacionet hetueseve të juve" dhe atë dokument e kam parë
6 që t'i dorëzohen një autorizim, në të vërtetë, edhe një
7 dokument dorëzim, pranim të dokumentacionit. Kjo ka qenë e
8 gjitha. Kështu më ka thënë në telefon.

9 Dhe kur kam ardhur prej pushimit unë e kam parë
10 dokumentin dorëzim-pranim që ma ka dorëzuar Fatoni në zyrën
11 time. Besoj atë dokument ma keni marrë atë ditë, kur keni
12 bastisur organizatën, në tavolinën time. Dhe kjo është reale
13 që Fatoni më tregon këtë dokument. Tjetër dokument jo.
14 Py. Domethënë Faton Klinaku të tha që kishte një urdhër që e
15 kishte dorëzuar Zyra e Prokurorisë së Specializuar. Kur u
16 kthyet prej pushimit me datën 15 apo 16 shtator, a ua tregoi
17 Fatoni këtë urdhër të Gjykatës?

18 Pë. Nëse s'jam i qartë, as sapo me ju kuptoj edhe pyetjen,
19 Fatoni ma tregoi dokumentacionin e dorëzim-pranim dhe
20 autorizimin që Gjykata e ka autorizuar hetuesit e juaj të
21 konfiskojë materialin. Kjo ka qenë. Në një anë ka qenë i
22 njëjti dokument siç e ka Toma në dorë. Autorizimi për
23 konfiskimin e dokumentacionit dhe dokumentin për
24 dorëzim/pranim të dokumentacionit. I nënshkruar nga Faton
25 Klinaku dhe hetuesi juaj që fliste shqip. kjo ka qenë e tëra.

1 Këto janë. Tjera nuk ka pasur diçka vendim që të tërhiqet
2 vërejtja për mos me dalë në media apo mos me publiku në media.
3 Këto dy dokumente kanë qenë.

4 Py. Faleminderit. Në paragrafin 14 të deklaratës tuaj zoti
5 Gucati, në lidhje me dorëzimin e parë, ju thoni se i keni parë
6 dokumentet dhe në paragrafin 15 të deklaratës suaj ju thoni se
7 kur e keni hapur kutinë, paketën, ka pasur një farë copë letre
8 dhe me shkrim dore në shqip me laps ka qenë e shkruar që "do
9 t'ju sjellim edhe 7000 dosje të tjera me dokumente".

10 Ju gjatë pyetje që jua bëri avokati juaj thatë që e keni
11 humbur këtë copë letër, këtë dokument. A është kjo e saktë?
12 Pë. Shumë e saktë. Ai nuk ka qenë dokument, ka qenë një letër
13 e thjeshtë si kjo dhe ka qenë mbi të e shkruar dhe unë e kam
14 marrë e ba guzhëm dhe e kam çuar në shportë. Shumë e saktë
15 është. Ta kisha ditë që hyn në punë, për juve apo për
16 hetuesit, kurrë në jetë s'e kisha hudh. Ajo ka qenë e shkruar
17 me dorë të thjeshtë. Kështu ka qenë, dhe unë kam menduar që
18 s'hyn në punë ai dokument. Se s'kisha pasur arsye ta humb unë
19 atë. Kjo ka qenë arsyeja.

20 Py. Kush tjetër i pa këto dokumente kur e hapët kutinë, zoti
21 Gucati? Kush tjetër e pa këtë dokument?

22 Pë. Me sa di unë, besoj se tre-katër vetë po. Dhe unë e kam
23 hedhur me dorën time, e kam ngju në shportë, se ne kemi
24 shportën në korridor dhe e kam ngju në shportën në korridor e
25 kam ngju. Dhe pastruesja kur e ka pastruar zyrat tona edhe e

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 76

1 ka humbur atë.

2 Py. Po zoti Haradinaj a e pa atë dokument?

3 Pë. Besoj se e ka parë edhe Nasimi. Kështu që është këtu

4 Nasimi, kur ta pyesni, do t'ju tregojë. Dhe unë e kam ngju.

5 Unë veç kam fol me gojë bile. Se unë e kam marrë në dorë dhe e

6 kam lexuar. Thashë "në këtë letër thjeshtë po shkruan", kështu

7 kam thënë, s'e di, se "do t'jua sjellim edhe 7000 kopje". Dhe

8 unë e kam çu në shportë, kur e kap parë të shkruar me laps. Ka

9 qenë laps i thjeshtë, letër e thjeshtë dhe unë e kam çu në

10 shportë tuj mendu se nuk hyn në punë ajo. Kjo ka qenë arsyeja

11 pse.

12 Py. Po Faton Klinaku a ishte i pranishëm dhe a e pa këtë

13 dokument me shkrim dore?

14 Pë. Fatoni nuk e besoj se e ka parë, thashë, se unë e kisha

15 dokumentin në dorë. Unë kështu e kam lexu, unë e kam pasur në

16 dorë. Tash sa e kam pasur dokumentin në dorë, asnjë. Unë e pas

17 në dorë dokumentin. Unë e kam lexu. Këta ka mujt me pa veçëm

18 faqen mbrapa të bardhë, kështu, se këta s'kanë mujt me e pa

19 shkrimin.

20 Py. Domethënë të tjerët nuk kanë qenë në -- nuk kanë pasur

21 mundësi të shihnin se për çfarë bëhet fjalë në atë faqe? Këtë

22 po e thoni?

23 Pë. Këtë po them, ata kanë shkruar "do t'i sjellim 7000 faqe

24 të tjera" e kam thënë para shokëve të vjetër, kështu kam çu

25 letrën përpjetë, nuk e di a ka mujt ta lexojnë këta edhe

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici (Vazhdon)

Faqe 77

1 bashkë me shokët tash po e çoj në shportë se nuk është diçka e
2 rëndësishme që shkruan në të. Se të kishte rëndësi unë e kisha
3 lënë me të gjitha ato dokumentet e tjera, e kisha lënë aty. Po
4 unë e kam vu në shportë. Kjo ka qenë reale që po them.

5 Py. Faleminderit, domethënë e keni pasur atë copë letre në
6 duar dhe ju i keni të tjerëve që aty shkruan se "do t'jua
7 sjell edhe 7000 dokumente të tjera. A është kjo e saktë?

8 Pë. Qysh kam shkru këtu në paragrafin 15 çdo send është e
9 saktë dhe e kam ngju në koshin e plehrave. Shumë e saktë
10 është. Në dorën time ka qenë, unë e kam bo guzhëm dhe e kam
11 ngju në shportë të plehrave. Shumë e saktë është.

12 Py. Dhe kjo copë letër ishte vendosur mbi dokumentet në atë
13 kuti. A është kjo e saktë?

14 Pë. E saktë është. Ka qenë shkrimi ka qenë kështu përfundi.
15 Këtu ka qëndru, që kështu ka qenë, përmbi -- e saktë është dhe
16 unë e kam marrë.

17 Py. Po Çel Gashi a ka qenë i pranishëm kur ju, zoti Gucati, e
18 patë këtë copë letër?

19 Pë. Real mua s'më kujtohet tash a ka qenë Çela në atë moment.
20 Nuk më kujtohet. Kanë qenë punëtorët që punojmë ne në
21 organizatë, kanë qenë, por Çela, ashtu, nuk më kujtohet që të
22 jetë. Nuk më kujtohet. Muj të gaboj në këtë drejtim. S'jam i
23 sigurt. Po unë i kam tregu të gjithë shokëve, i kam tregu që
24 kishte qenë një letër dhe e kam ngju në shportë. Në kosh -- në
25 kosh të bërðhokut, të plehrave.

1 Py. Në rregull. Kur e hapët kutinë me datën 7 shtator, a ju
2 kujtohet se kush ishte afër jush, pranë jush, kur e hapët
3 kutinë që menduat se kishte bombë brenda?

4 Pë. Ne fillimisht, kam treguar edhe në ditët në vijim që kemi
5 pasur frikë të gjithë. Po, aty kemi qenë të gjithë. Unë,
6 Nasimi dhe të gjithë kemi qenë kur e kemi hapur kutinë dhe
7 prej asaj zyre e kemi prurë në zyrën time. Kjo është e
8 vërtetë.

9 Py. Po, a të kujtohet se kush tjetër ishte aty afër. Kush,
10 cili person tjetër ishte afër?

11 Pë. E di që unë e Nasimi kemi qenë. Ka qenë edhe Fatoni, nëse
12 s'gabo, se ne kemi qenë në zyrën time duke pirë kafe kur na
13 ka lajmëruar vajza që punon aty, sekretarësja dhe e këta kanë
14 vepru pak më shpejt se unë se unë nuk muj të vrapoj për shkak
15 të këmbës, po kam shku ndërkohë bashkë me ta dhe... Po kemi
16 qenë bashkërisht kur e kemi hapur paketën.

17 Py. Faleminderit. Në faqen 13 të deklaratës tënde, thuhet:

18 "Nuk ishte në interes tonin që të kuptojmë, të marrim
19 vesh se si dokumentet erdhën në zyrën e DHSK-së/ZPS-së".

20 Tani, këtë dokument që ju vendosët ta hidhni në koshin e
21 plehrave, do t'ju kishte ndihmuar që të kuptoni se si këto
22 dokumente kishin arritur te zyra juaj, apo jo?

23 Pë. Nuk e di për atë unë. Mbase se s'jam ekspert i kësaj
24 lëmie e nuk e di a më kish ndihmuar apo do më kishte dëmtuar.
25 Kështu që nuk e di.

1 Py. Dhe ju e gjykuat që nuk ishte me rëndësi që ta mbanit atë
2 dokument, ta ruani atë dokument. Ju kishit 4000 faqe dokumente
3 para jush dhe kjo copë letër nuk ishte pak -- një më shumë?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Është një
5 pyetje retorike. A mund ta parafrazoni, ju lutem?

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

7 Pë. Pyetja ime është kjo: Pse vendose që ta hidhni këtë copë
8 letër. Pse e konsideruat atë copë letër të pa rëndësishme?

9 Pë. Tash si mendoni të zotë, gjykimi do të zgjatet sa të
10 doni. Unë e tregova. Atë letër e konsiderova të pavlerë fare.
11 Një shkrim, një 7-she, tre 0, tetëmijë dhe asgjë tjetër më
12 shumë. Kjo është krejt ça ka shkru në atë shkrim. Nuk kam
13 nevojë të gënjej. E kam ngju në koshin e plehrave. Dhe nëse
14 doni të zgjateni në këtë pyetje, sa të doni rrimë këtu para
15 Trupit Gjykues, do të rri.

16 Py. Domethënë, ishit me të vërtetë i interesuar që të
17 zbulonit se si këto dokumente kishin përfunduar në zyrën tuaj,
18 dhe prapë se prapë vendosët që ta hidhni këtë copë letër. A
19 është kjo e saktë?

20 Pë. Te ne e thonë një fjalë popullore "nëse do të kapesh prej
21 një fije kashte, mundesh të kapesh". Kjo është fjalë popullore
22 në -- te shqiptarët që përdoret. Unë po të them edhe një herë:
23 do të vdes me zheg me e zbulu kush e ka pru ato
24 dokumentacione. Do të vdes me atë që nuk mund të zbulohet kush
25 i ka pru ato dokumente. Letra, ta kisha ditë që letra çon

1 peshë -- qysh mendoni. Një numër 7, tre 0. Nuk e kisha
2 përjetë. Do ta kisha prurë këtu. Kjo është e gjitha që po ju
3 them.

4 Py. Faleminderit. Zoti Gucati, po ta shikoin paragrafin 42 të
5 deklaratës tuaj, do të shini që aty përmendni një farë bisede
6 që keni pasur me hetuesin e Prokurorisë me datën 17 shtator.
7 Dhe na keni thënë që ky hetues i Prokurorisë ju ka thënë që
8 "edhe një muaj nëse pritni, nuk do të ndodhë që policia e
9 Kosovës të vijë dhe të mbledhë këto dosje". A është kjo e
10 saktë?

11 Pë. Faleminderit që kjo pyetje që tri-katër herë. Po. Po. Ka
12 ardhur hetuesi juaj që flet gjuhën shqipe bukur mirë. Nuk e
13 thekson krejt mirë por e flet mirë dhe e kupton shumë ky
14 zotëria në fjalë. Dhe thotë "kemi ardhur të marrim dosjet,
15 nëse ka mundësi". Po në fillim, para se të thoshte "të marrim
16 dosjet" e kemi obligim të ngjitemi në katin lart, t'i
17 fotografojmë dhe ti shikojmë a janë tonat. Dhe unë e kam
18 pranuar me shumë mirësi. Ka shkuar i ka fotografuar dhe ka
19 ardhur në zyrën time dhe thotë: "Këto dokumentacione janë
20 tonat" dhe thotë "Duhet me i marr". Unë i kam thënë "Jo,
21 bashkë me shokët e mi, se duhet të jetë policia e Kosovës në
22 prezencë kur të bëjmë dorëzimin-pranimin. Dhe ai më thotë, në
23 gjuhën shqipe më thotë, jo në gjuhën angleze, të jeni të
24 bindur. Kam dëshirë ta kem përpara atë njeri. E më thotë:
25 "Zoti kryetar, ne edhe një muaj mujna me nejt këtu dhe

1 dokumentacionet të nal, policia e Kosovës nuk vjen me qenë
2 dëshmitarë". Dhe ne jemi këshilluar me zotin Tom Gashi dhe
3 kemi pranuar se në prezencën e Tom Gashit, të avokatit,
4 atëherë dorëzojmë dokumentacionin. Kjo është e gjitha që po
5 jua them realitetin. Kështu që mundet ta pyesni hetuesin tuaj
6 i cili ka folur në gjuhën shqipe në zyrën time.

7 Py. Domethënë ai asnjëherë nuk ju ka thënë se mund t'i mbani
8 dokumentet një muaj. Në fakt, ai ka dashur që menjëherë t'i
9 dorëzohen dokumentet. A është kjo e saktë?

10 Pë. Nëse ka mundësi edhe një herë se më ka tingëlluar keq mua
11 -- pyetjen tënde, nëse ka mundësi edhe një herë?

12 Py. Ai në atë rast nuk ju tha që mund t'i mbani dokumentet
13 për një muaj. Por në fakt ai ju kërkoi që t'ia dorëzoni
14 dokumentin mu atëherë në atë moment.

15 Pë. Nëse ke qenë ti aty, ashtu është qysh thua ti. Po unë po
16 them që ti s'ke qenë aty fare, çfarë kemi biseduar ne. Zotëria
17 me ka thënë "edhe një muaj ditë mund t'i mbani dokumentacione,
18 policia e Kosovës nuk vjen" dhe ne kemi rënë dakord bashkë me
19 Tom Gashin dhe me inspektorin që fliste shqip dhe ja kam dhënë
20 shumë me mirësi. Ka pirë edhe kafe në zyrën time. Nëse do ta
21 tregoj edhe një sekret për atë: ka pirë edhe raki, njëri prej
22 tyre. Në vendin e punës ka pirë edhe raki, në zyrën time. Një
23 punëtor i juve. Kjo është reale që po them. nuk gënjej asnjë
24 fjalë. Nuk kam arsye të gënjej, se s'kam ni me gënjeshtër,
25 s'jetoj me gënjeshtër, s'kam ardh në burg me gënjeshtër. Ta

1 them realitetin, ta them. Kjo është e vërteta.

2 Py. Zoti Gucati, sa na thatë se ai ka thënë që dosjet nuk do
3 të merren nga policia e Kosovës edhe sikur të prisni një muaj.

4 Z. REES: [Përkthim] Më falni që po ju ndërpres por
5 transkriptimi real, në kohë reale nuk -- si duket është
6 ndërprerë. Nuk bën regjistrim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në vend që
8 të presim deri sa të rregullohet ky problem, atëherë po e
9 marrim pushimin e drekës tani dhe vazhdojmë në orën 14.30.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Vetëm t'ju informoj se nuk më
12 kanë mbetur edhe shumë pyetje pas pak pushimit të drekës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më falni,
14 nuk i kam dëgjueset.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua ta informoj Prokurorin për
16 hir të planifikimit se pas pauzës së drekës nuk do të kem edhe
17 shumë pyetje.

18 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.49

19 --- Seanca rifillon në orën 14.30

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të
21 vazhdojmë me kundërpvetjet që Prokuroria do t'ia bëjë zotit
22 Gucati.

23 Zonja Bolici, keni fjalën.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 Py. Zoti Gucati, a keni ndonjë pendesë për veprimet për të

1 cilat jeni përpara gjyqit?

2 Pë. S'po muj e kuptoj këtë pyetje për çfarë e keni fjalën.

3 Më fal, s'po muj po ju kuptoj pyetje për çka e keni fjalën.

4 Esenca ku është?

5 Py. A jeni penduar, keni pendesë për veprimet për të cilat

6 jeni nxjerrë përpara gjyqit?

7 Pë. Deri më ditën e sotit, për 54 vite të miat që jam dhe mbi

8 30 që punoj, nuk e di që jam i penduar në ndonjë punë.

9 Pendohna aty ku gaboj me qëllim. Kërkoj falje. Aty ku unë e di

10 që s'kam bë gabimin, nuk kam nevojë të kërkoj falje se këto

11 dokumentacione unë nuk i kam vjedhë dhe nuk i kam pru në

12 Organizatën e Veteranëve të Luftës. Po t'i kisha vjedhur unë

13 këto dokumentacione, publikisht do të kërkoja falje për

14 hajninë që e kam bë. Unë hajni s'kam bërë dhe unë s'kam fyer

15 asnjë njeri, asnjë dëshmitar, asnjë deklaratë s'e kam lexuar.

16 Dhe kështu, nuk kam arsye që të kërkojë falje përderisa unë

17 s'kam vjedhë dhe se s'kam thy kërrkënd shpirtnisht.

18 Py. A do ta bënit po të njëjtën?

19 Pë. Unë jam deklaru edhe ma herët dhe ditën e djeshme dhe të

20 pardjeshme jam deklaru, e nderuara. Unë s'jam gardian i

21 askujt, asnjë institucioni në vendin tim ma së pari, po as në

22 Hagë, këtu në Holandë. Unë ruaj zyrat e mia ku unë punoj unë.

23 Jam gardian i asaj pune ku jam i thirrur. Kështu që unë ju

24 kisha bë lutje mos na provokoni me dokumentacione.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Prokuroria

Dëshmitari: Hysni Gucati (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 84

1 nuk ka më pyetje të tjera. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Mbrojtja e Haradinajt ka pyetje?

5 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees,
7 keni pyetje shtesë?

8 Z. REES: [Përkthim] Jo.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
10 Gucati, mund të ktheheni në vendin tuaj. Nëse ndiheni më
11 rehat, mund të qëndroni dhe aty, po të dëshironi mund të uleni
12 edhe në vendin e mëparshëm

13 DËSHMITARI: Faleminderit, i nderum.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Një
15 moment, një moment, zoti Gucati. Mos lëvizni sepse disa prej
16 anëtarëve të Trupit Gjykses kanë disa pyetje. Do të fillojmë
17 me gjykatësin Barthe.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
19 Smith.

20 Pyetje nga Trupi Gjykses:

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zoti Gucati, mirëdita. Më
22 dëgjoni? Dëgjoni mirë?

23 Pë. Po, po. Përshëndetje. Përshëndetje.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

25 Zoti Gucati, kam disa pyetje në lidhje me atë ju keni

1 thënë në deklaratën tuaj me shkrim të cilën avokati juaj e ka
2 dorëzuar. Është me numër DHG0472 deri në DHG0491. Kam pyetje
3 edhe për atë që na keni thënë këto dy ditë e gjysëm.

4 Dëshiroj që të filloj te paragrafi 13 i deklaratës suaj,
5 aty ku thoni:

6 "Dosjet i lanë në -- dosjet që janë lënë në tavolinë, në
7 recepsion, burri që i kishte sjellë ato i kishte thënë
8 Taibes..."

9 Besoj është zonja Miftari, apo jo, kur thoni Taibe?
10 Pë. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

12 "Burri që i solli ato i kishte thënë Taibes që t'ia vë në
13 dispozicion dokumentet personit që fletë me mediat".

14 Këtë keni shkruar këtu.

15 Por ditën e hënë, këtë të hënë, e kam fjalën për
16 transkriptin e ditës së hënë faqe 2165, faqja 10 deri në 11,
17 keni thënë që personi që i solli dokumentet në OVL UÇK në 7
18 shtator 2020 tha dhe këtu po ju citoj juve:

19 "Kjo është për ata që flasin në televizor", po e mbyll
20 citimin tuaj.

21 Dua t'ju pyes me saktësi, a mund të na thoni se çfarë ju
22 ka thënë -- çfarë i ka thënë personi që i dorëzoi këto
23 dokumente zonjës Miftari? Çfarë ju tha ajo juve lidhur me
24 këtë?

25 Pë. Vajza lidhur me këtë ka thënë "Ai e ka lënë paketën në

1 tavolinë" siç kam thënë dhe thotë "këtë paketë ja u jepni
2 atyne apo atij që flet në televizor". Kështu ka qenë. Tash unë
3 ka mundësi që kam thënë në shumës edhe nuk e mohoj që s'kam
4 thënë në shumës, po ka thënë "këtë paketë atyre që flasin në
5 televizion" kështu. Ka mundësi që fjala në shumës, është
6 vërtetë që e kam thënë unë në shumës, po ka thënë që flasin në
7 televizion. Kështu ka qenë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si e kuptuat ju, për të
9 cilin person apo persona e kishte fjalën ky njeriu i panjohur?
10 Pë. Po këtë është shumë lehtë me e kuptuar te ne në Organizatë,
11 se për arsye unë dhe Nasim Haradinaj dalim në media se jena
12 shumë shpesh, do të thotë, që dalim rregullisht në media.
13 Është Nasimi edhe unë që dalim dhe ndodh shumë rrallë del edhe
14 Fatoni, po shumë rrallë Fatoni ka dalë. Po kryesisht unë dhe
15 Nasimi dalim në media.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

17 Pyetja tjetër, zoti Gucati, ka të bëjë me paragrafin
18 numër 17 të deklaratës suaj dhe po citoj:

19 "Anëtarët e ngushtë të kryesisë, si më lartë përkatësisht
20 Fatoni, Çela, Nasimi dhe unë dhe ndoshta dy të tjerë, kemi
21 mbajtur një mbledhje urgjente. Duke pasur parasysh qëndrimin
22 tonë sa i takon DHSK/ZPS-së vendosëm se duhet ta bëjmë publik
23 dorëzimin e dokumenteve. Ishte kjo për shkak se ne dyshuam se
24 këto dokumente ishin nga DHSK/ZPS-ja, prandaj vendosëm të
25 thërrasim një konferencë për shtyp". Dhe këtu mbaron citimi

1 nga deklarata.

2 Zoti Gucati, pse dyshonit ju se dokumentet ishin nga
3 DHSK-ja apo nga ZPS-ja?

4 Pë. Këtë e kam deklaruar dhe para dy-tre ditësh, që ne
5 gjithmonë kemi dyshuar me arsyetim sepse aty ka qenë stema e
6 Gjykatës Speciale dhe stema e flamurit qysh është, që është
7 aty. Këtë arsyeer kemi dyshuara. Kjo ka qenë dyshimi im kur e
8 kemi pa dhe vulën edhe emrat e ndërkombëtarëve që kanë punur
9 këtu në Gjykatë. Kjo ka qenë arsyeja që kemi besuar dhe kemi
10 dyshuar që këto dokumentacione janë të Gjykatës.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe atëherë vendosët që të
12 thërrisni një konferencë për shtyp. Pyetja tjetër e imja është
13 pse nuk e informuat ZPS-në apo Policinë e Kosovës apo edhe
14 Prokurorinë apo edhe ndonjë autoritet tjetër kosovar lidhur me
15 ardhjen e këtyre dokumenteve? Pse ishte e nevojshme zhvillimi
16 i një konference për shtyp?

17 Pë. Nevoja ka qenë pse ishte nevojshme kjo, që një konferencë
18 për shtyp, të kam tregu edhe ma herët, ne duke menduar që këto
19 dokumente mund të jenë në dorë të ndonjë matrapazi, që mund
20 t'i shpërndajë nëpër vende publike dhe të na fajësojë neve që
21 ato dokumente kanë hy në Organizatë të Veteranëve dhe mos i
22 kemi shpërndarë ne. Dhe ne kemi dashtë të tregojmë një të
23 vërtetë që e kemi kundërshtuar Gjykatën me kohë, se ja Gjykata
24 Speciale me kë në bashkëpunon. Edhe kjo arsyeja ka qenë. Të
25 dyjat.

1 Po ne i kemi bë ftesë Policisë dhe ndërkombëtarëve në
2 ditët në vijim. Edhe ditën më shtatë edhe me ditët në vijim të
3 tjera që ta ruajnë objektin përreth dhe të kontrollojnë se
4 kush po hynë mbrenda si po na i bien këto dosje.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin numër 19 të
6 deklaratës suaj, zoti Gucati, thoni dhe po citoj:

7 "Në konferencën për shtyp ishin katër kopje identike të
8 dokumenteve dhe ato ishin shtrirë dhe ishin vënë në
9 dispozicion shtypit, medias".

10 Zoti Gucati, mund të na thoni pse ishte e nevojshme që të
11 vendoseshin dokumentet aty dhe të viheshin në dispozicion të
12 shtypit apo të medias kur mund të informoheshin thjesht
13 gazetarët lidhur me ardhjen e dokumenteve pa i bërë ato
14 publike?

15 Pë. Ne kemi mëndu për ta bindë edhe shtypin, po edhe
16 opinionin kosovar. T'ju tregojmë se këto janë fakte. Se jo
17 dolëm ne pa argument dhe të thojmë, kanë ardhë disa dokumente,
18 kur ne s'kishim ç'ka tu qitshim atyre përpara. Dhe kjo ka qenë
19 arsyeja pse ne i kemi lënë ato dokumente në tavolinë. Që të
20 bindet shtypi kosovar, po e dhe i huaj që ka qenë aty, po edhe
21 qytetarët tonë, që të binden që ka hi dokumentacioni në
22 organizatën tonë. Kjo ka qenë vetëm të bëjmë si argument.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nga këndvështrimi juaj,
24 ishte e nevojshme që të paraqiteshin, të viheshin në
25 dispozicion dokumentet aty dhe të bëheshin publike dhe jo

1 thjesht të informohej shtypi për ardhjen e dokumenteve, pra,
2 që e kishte pasur ardhje dokumentesh; është kështu?
3 Pë. Ne edhe t'u tregojmë që na kanë dokumentet. Kush i ka
4 sjellë nuk e dimë. Ka kanë rrjedhë nuk e dimë. T'u tregojmë që
5 kanë hi dokumentet në organizatën tonë. Po kush i ka pru dhe
6 ka kanë dalë nuk dimë. Dhe e informojmë shtypin që këto
7 dokumente janë të Gjykatës Speciale dhe Gjykata Speciale
8 bashkëpunon me kriminelët serbë. Kjo ka qenë arsyeja më shumë.
9 Jo që ne t'i lëmë ato dokumente. Ne i kemi bë thirrje që të
10 vijjnë t'i marrim. Unë thashë edhe ma herët, një kopje ka qenë
11 që t'i merr policia e Kosovës apo hetuesia. Dhe
12 fatbardhësisht, kanë ardhur më 8 shtator edhe i ka marrë
13 hetuesi, i cili flite në gjuhën shqipe, komplet një pjesë
14 tyne.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja tjetër ka të bëjë me
16 paragrafin 20 të deklaratës suaj, ku thoni dhe po citoj:

17 "Kur ne u pajtuam ta thërrasim konferencën për shtyp,
18 Nasimi kërkoi të marrë fjalën kryesore dhe unë u pajtova".

19 Po e përsëris:

20 "Kur ramë dakord të thërrisnim konferencën për shtyp,
21 Nasimi kërkoi të marrë fjalën kryesore dhe unë u pajtova. Unë
22 pastaj ja dhashë fjalën Nasimit, unë nuk e kam menduar që
23 Nasimi do të thotë diçka të paligjshme". Kaq lexova nga kjo.

24 Zoti Gucati, çfarë menduat se do t'u thoshte zoti
25 Haradinaj gazetarëve gjatë konferencën e parë për shtyp?

1 Mendonit që ai do të fliste për përmbajtjen e dokumenteve?

2 Pë. Jo, unë kam qenë shumë i vetëdijshëm që nuk besoj që

3 Nasimi, kam thënë dhe kam mendu, që Nasim Haradinaj do të

4 flasë jashtë rregullores apo edhe jashtë ligjit që ça nuk e

5 lejon ligji. Kështu që, unë atë ditë është e vërtetë që kam

6 jep fjalën Nasimit dhe Nasimi e ka fol, po unë gjithë mendoj

7 që nuk ka folur diçka jashtë rregullore të organizatës po edhe

8 jashtë ligji.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, mund të thoshin se ai

10 qëndroi brenda parametrave të ligjit, pra, jo vetëm të ligjit

11 por edhe brenda parametrave të marrëveshjes juaj, parametrave

12 të asaj që ju për të cilën ishit pajtuar m'u përpara

13 konferencës për shtyp?

14 Pë. Po, unë e mendoj që Nasimi ka vajtë gjithmonë parametrave

15 sa e lejon ligji dhe gjithmonë ato çka e lejon Organizata e

16 Veteranëve të Luftës. Se organizata është e thirrur për të

17 mbrojt interesat e veteranëve të luftës dhe interesat e

18 shokëve. Dhe kështu unë e mendoj që Nasimi ka folur gjithmonë

19 mbrenda parametrave të ligjit. Kështu e mendoj unë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zoti Gucati, ju e cekët se u

21 pajtuat, pra, vendosët që të thërrisnit një konferencë për

22 shtyp dhe ta bënit publike ardhjen e dokumenteve. Është në

23 paragrafin 17 të deklaratës suaj. Pyetja ime është kjo: A mund

24 të thoshim se zoti Haradinaj, Nasimi, pra, gjithashtu ka

25 qëndruar brenda parametrave të vendimit por dhe asaj që kishit

1 vendosur përpara konferencës për shtyp?

2 Pë. Ne real s'kemi pasur gjë të shkruar në letër se çka do të
3 flasim para mediave. Dhe unë mendoj që Nasimi gjithmonë ka
4 folur parametra sa e lejon rregullorja e organizatës dhe sa e
5 lejon ligji. Ashtu unë e mendoj dhe jam i bindur prapë që ashtu
6 mendoj.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk u befasuat nga ato
8 që zoti Haradinaj i tha shtypit apo nga ato për të cilët po
9 fliste ai gjatë konferencës për shtyp?

10 Pë. Unë nuk e di dhe s'ëm kujtohet. Jo që do ta mbroj unë
11 Nasimin këtë rast, që e ka thënë diçka Nasimi jashtë ligji apo
12 jashtë rregullores të organizatës. Se edhe Organizata e
13 Veteranëve ka një rregullore dhe ka një etikë punë që nuk
14 lejon, ndaj asajna, nuk lejon procesi që del jashtë saj,
15 jashtë rregullores.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zoti Gucati, sipas
17 paragrafit 30 të deklaratës suaj, keni thënë se më datë 15
18 shtator 2020 jam kthyer nga pushimet. Kur u kthyet nga
19 pushimet në datë 15 shtator 2020, a bëtë ju një takim apo bëtë
20 ndonjë telefonatë me anëtarë të tjerë të kryesisë së OVL UÇK-
21 së ku të keni diskutuar problemin e dorëzimeve të tjera,
22 ardhjeve të tjera të dokumenteve? Ju kujtohet kjo?

23 Pë. I nderum, unë jam kthyer në mbrëmje prej pushimit dikun
24 rreth orës 22.00. Që është fatbardhësisht është edhe vula në
25 pasosh kur jam kthyer dhe ora që kur kam hy në kufi. Unë jam

1 kthyer dikund në mbrëmje në shtëpinë time. Kështu që nuk kam
2 folur në telefon atë natë me asnjë njeri nga Organizata e
3 Veteranëve, me sa jam në dijeni unë edhe me sa s'besoj se kam
4 harru, në atë mbrëmje nuk kam folur në telefon se jam kthyer
5 shumë vonë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zoti Gucati, një takim të
7 tillë apo telefonatë, me sa ju kujtohet apo ndonjë komunikim
8 tjetër e keni pasur me anëtarë të tjerë të kryesisë përpara
9 apo pas datës 15 shtator 2020?

10 Pë. Një telefonatë e kam pasë me Fatonin që e kam pyetur si
11 ka kapërceu me hetuesit e Gjykatës Speciale. Dhe ai më tregon
12 "Kam kapërcy shumë mirë. Kemi pi ka dy kafe dhe ja kam jep
13 dokumentacionin". Kështu ka qenë. Kjo ka qenë telefonata ime e
14 fundit, nëse s'gaboj, me datën 9 shtator me Fatonin, që e kam
15 pyetur rreth ecurisë së punës që si ka kaluar me hetuesit e
16 Gjykatës Speciale.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk ka nuk keni pasur
18 asnjë komunikim tjetër, asnjë telefonatë apo takim me anëtarët
19 e tjerë të kryesisë më datë 15 shtator 2020 apo përpara apo
20 pas kësaj date? Për shembull 14 apo 16 shtator të themi?

21 Pë. Më 16 shtator jam kthyer në punë. Më 16 shtator, unë kam
22 ardhur në punë si zakonisht. Jo, nuk më kujtohet. Po e them
23 sinqerisht, s'ëm kujtohet që kam pas takim apo -- jo takim
24 fare s'kam pasë se isha në pushim, po telefonatë me dikënd
25 prej anëtarëve të kryesisë, nuk më kujtohet. Të jeni të bindur

1 s'ëm kujtohet.

2 Z. REES: [Përkthim] Deklarata e dëshmitarit është në
3 dispozicion dhe ai mund ta rifreskojë kujtesën, më duket, nga
4 kjo deklaratë dëshmitari.

5 Në paragrafin 30 dhe 31 të zotit Gucati.

6 Paragrafin 31 nuk e ka në shqip. Është në ekran.

7 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
8 këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Thoni që
10 nuk e ka paragrafin 31?

11 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofon avokati.

12 Z. REES: [Përkthim] Versioni që dukej në ekran kishte
13 paragrafin 30 dhe 31. Po versioni në shqip që ishte në ekran
14 nuk e kishte paragrafin 31 për shkak të faqosjes.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, tani
16 mund ta shikoj.

17 I AKUZUARI GUCATI: Po e shoh. E shoh, i nderum. Më 15
18 shtator që e kam dhënë deklaratën time, mund të kem unë, jo
19 Mbrojtësi im, po unë mund të kem dhënë datën gabim. Po është e
20 vërtetë që automjeti im që është fotografuar, që më kanë
21 tregu, është e saktë. Kjo çka kam dëshmu, vetëm data mund të
22 jetë gabimi mund të jetë i imi, është e saktë që këto çka kam
23 thënë në deklaratë. Shumë e saktë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, zoti Gucati,
25 për sqarimin.

1 Pyetja ime tjetër ka të bëjë me paragrafin 35 të
2 deklaratës suaj. Mbase mund ta shihni. Thuhet aty dhe po citoj
3 prapë:

4 "Të pranishmit nga kryesia vendosën të thërrasin
5 konferencën për shtyp dhe proceduara ishte e njëjtë si më
6 parë". Mbyllja e citimit këtu.

7 Pyetja ime është kjo, zoti Gucati: Me saktësi kush ishin
8 të pranishëm kur u vendos thirrja e konferencës për shtyp më
9 datë 16 shtator 2020? Me fjalë të tjera kush e mori këtë
10 vendim përveçse jush?

11 Pë. Këtë vendim jam unë ai pari, Hysni Gucati, ka qenë
12 Nasimi, Fatoni, Çela, Metushi, kështu që kemi qenë kryesi e
13 ngushtë mbrena atë ditë që kemi marrë vendim të njëjtën
14 procedurë si në konferencën e parë. Është e njëjta procedurë,
15 që ka marrë të njëjtin mendim dhe e kam autorizuar Fatonin që
16 t'i thërret mediat, sekretarin.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas paragrafit 47 të
18 deklaratës suaj, zoti Gucati dhe po citoj, këtu thoni:

19 "Ne vendosëm të mbajmë konferencë për shtyp, siç bëmë
20 edhe më parë...". Po mbaroj citimin këtu.

21 Mund të na thoni edhe në këtë rast, kush me saktësi
22 vendosën së bashku që të mbahej kjo konferencë për shtyp më
23 datë 22 shtator 2020 pas ardhjes së dokumenteve në OVL UÇK atë
24 ditë?

25 Pë. Të njëjtit, të tregova të njëjtët ata të cilët kanë qenë

1 aty prezent dhe në punë. Të njëjtit jemi.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur thoni të njëjtët e keni
3 fjalën edhe njëherë Nasimi, Fatoni, Çela, Metushi?

4 Pë. Po. Metushi po. Po edhe ka qenë edhe nënkryetari i dytë.
5 Po ai nënkryetari nuk flet, kam tregu që është i sëmurë dhe
6 nuk mund të lëvizë mirë. Ka qenë ai prezent, po ai nuk flet
7 dhe nuk dëgjon mirë. Për këtë arsye Migjen Shalën s'e kam
8 përmend se është njeri që është me aftësi të kufizime, që ka
9 pasë një sulm në tru dhe ka qenë dhe Migjeni prezent, po ai
10 nuk flet edhe nuk dëgjon mirë. Kjo ka qenë arsyeja pse Migjen
11 Shalën s'e kam përmend. Vetëm për këtë arsye. Kështu që mundni
12 me u bind te Migjeni që është njeri i sëmurë, fatkeqësisht. Më
13 vjen keq, kërkoj shërimin e shpejtë të tina. Kjo është e
14 vërtetë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja tjetër që kam, ka të
16 bëjë me paragrafi 50 të deklaratës suaj ku thoni dhe po citoj:

17 "Pas konferencës për shtyp gazetarët filluan të largohen
18 nga zyrat dhe erdhi një oficer i ZPS-së. Dokumentet i janë
19 dorëzuar oficerëve të ZPS-së". Po mbaroj citimin e asaj që
20 keni thënë.

21 Ditën e hënë, zoti Gucati, ju përmendët dhe e kam fjalën
22 për transkriptin e të hënës, faqe 2202, rreshtat 13 deri në
23 15, që u bë një debat përpara se t'i dorëzoheshin dokumentet
24 ZPS-së. A mund të na thoni -- mund të më thoni përse u bë
25 debat? Për çfarë u bë debat?

1 Pë. Po edhe sot tregova debatin e hetuesit që fliste gjuhën
2 shqipe na tha "Kam ardhur t'i shikoj ma së pari dhe t'i
3 fotografoj dhe të bind që a janë dokumente të ZPS-së". Dhe unë
4 i kam thënë "Po". Ka shkuar në katin lart dhe i ka shfletuar
5 ato dokumente, i ka fotografuar dhe ka ardhur në zyrën time
6 dhe jemi ul dhe kemi debatuar. Ai thotë se "Unë dokumentet
7 duhet me i marrë". Dhe unë i them bashkë me shokë që "Nëse ti
8 do me i marrë dokumentet, duhet të jenë në vëzhgim Policia e
9 Kosovës". Ky ka qenë debati që e kemi bë ne me ta. Po ka qenë
10 debat, jo debat kështu që të them diçka agresiv, po debat
11 shumë i qetë, shumë i nivelit të ulët. Kemi biseduar dhe të
12 thashë edhe ma herët që kemi pi edhe kafe. Dhe në ato momente
13 ka ardhur Toma, që e kemi thirrë ne Tomën dhe Toma na ka
14 këshilluar se në prezencën e Tomës mund të dorëzohen
15 dokumentacionet. Ky ka qenë debati krejt rreth këtyre
16 dokumentacioneve. Dhe ne ia kemi jep dokumentacionet hetuesit
17 juaj.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, në thelb debati kishte
19 të bënte me praninë e policisë kosovare atë ditë; apo jo?

20 Pë. Po, shumë e vërtetë. Se ne, qysh ishim të informum çdo
21 aksion që morën hetuesit duhet të jenë prezent Policia e
22 Kosovës. Kështu ne e dimë në Kosovë dhe ne kemi mendu që çdo
23 aksion që e marrin hetuesit të paktën duhet të jenë në vëzhgim
24 me Policinë e Kosovës. Dhe kjo ka qenë arsyeja pse ne s'kemi
25 dashtë të pranojmë t'ia jepnim dokumentacionin. Jo që s'kemi

1 dashtë t'ia dhamë, por neve vetëm kemi kërkuar që të jetë në
2 vëzhgim edhe policia jonë. Kjo ka qenë arsyeja.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kuptoj. Pyetja e fundit
4 që kam sot ka të bëjë me paragrafët 57 dhe 58 të deklaratës
5 suaj. Ditën e hënë, na keni thënë dhe do përmend transkriptin
6 e ditës së hënë, në faqen 2210, rreshtat 2 deri 4. Citoj:

7 "Nëse këta njerëz, pra, viktimat, viktimat e supozuara,
8 apo siç e quani ju populli, njerëzit tanë do të
9 intervistoheshin në vendin tim" dhe besoj se e keni fjalën për
10 Kosovën, "atëherë unë do të kisha besim tek kjo Gjykatë", dhe
11 po e mbyll citim e asaj që keni thënë.

12 Gjithashtu, keni thënë që dëshmitarët mund të jenë
13 dërguar në Serbi, mund të jenë marrë në Serbi dhe që të
14 intervistohen aty. Është e saktë, zoti Gucati? Këtë keni
15 dashur të thoni ditën e hënë?

16 Pë. Shumë e saktë, i nderum. Unë kam thënë jam kundër kësaj
17 Gjykate dhe prapë them jam kundër kësaj Gjykatës përderisa kjo
18 Gjykatë s'më bind mu edhe qytetarët e Kosovës për t'i zbuluar
19 krimet në Kosovë që kanë ndodhur dhe për ta zbuluar edhe
20 krimin ndaj serbëve çka ka ndodhur. Që policia, ushtria dhe
21 paramilitarët çetnikë serb, të cilët i kanë vra gjashtë
22 qytetarë të rinj serbë, mosha e tyre shumë e re 16 vjeçare
23 kanë qenë, atëherë ku ti besoj unë kësaj Gjykate. Kështu kam
24 thënë dhe kështu që qëndroj prapa fjalëve të mia. Kur kjo
25 Gjykatë të na bindë neve që i zbulon të gjitha krimet në

1 Kosovë pa dallim kush ka bë krime, gjithmonë flas pa dallim,
2 atëherë unë do ta përkrahi këtë Gjykatë me tërë qenien time
3 njerëzore.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Zoti Gucati, pa përmendur
5 emra, a jeni në dijeni të dikujt që është marrë nga Kosova
6 është çuar në Serbi nga ZPS-ja apo TFHS-ja apo nga Gjykata e
7 Specializuar e Kosovës që të merret në pyetje atje?

8 Pë. Tash duhet të jem i sinqertë pa përmendur emra fare. Unë
9 e kam deklaruar edhe ma herët edhe në mediat e Kosovës para
10 një viti e gjysëm, kam deklaruar edhe këtu para dy-tre ditësh,
11 nëse s'gabo. Është shumë reale që unë e kam pa një
12 dokumentacion aty ku shkruan dhe kam thënë, "kjo Gjykatë është
13 vendosur dhe është votuar nga delegatët apo deputetët të
14 kuvendit tim. Pse kjo Gjykatë si ka marrë personat në pyetje
15 në Kosovë po i ka çu në Nish, Vranjë dhe Beograd". Kjo më
16 shtim prapë të dyshoj në këtë Gjykatë. Kjo është e vërtetë që
17 kam thënë dhe prapë them. Nuk do dalim më para juve gënjeshtar
18 që të rrej që të them s'kam thënë, kur ato ekzistojnë. Kam
19 thënë para mediave, pse kjo Gjykatë, mbasi është e Kosovës dhe
20 e ka votuar Parlamenti im, deputetët e mi, atëherë kjo gjykatë
21 është dashtë të veprojë, të punojë në Kosovë. Dhe unë e kam
22 kërkuar gjithmonë që të ketë një Gjykatë kosovare me
23 mbikëqyrje ndërkombëtareve. Dhe këtë kam thënë të ketë një
24 Gjykatë vendore, po gjithmonë të jetë në mbikëqyrje nga
25 ndërkombëtarët. Kështu është e vërteta.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë zoti

2 Gucati. Nuk kam pyetje më të tjera.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
4 Mettraux.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

6 Mirëdita zoti Gucati. Edhe unë kam disa pyetje. Do të
7 doja që të filloja me ardhjen e parë të materiale, në
8 konferencën e parë për shtyp që ndodhi më 7 shtator 2020.

9 I lutem Sekretarisë që të nxjerrin provën materiale me
10 numër P1, ju lutem,

11 Gjëja e parë, zoti Gucati, ndërkohë që na e nxjerrin
12 materialin është të konfirmoni nëse, me aq sa ju kujtohet,
13 materiali ka ardhur në OVL UÇK rreth orës 9.15, mëngjesin e
14 asaj dite. E konfirmoni?

15 Pë. Përshëndetje i nderum. Faleminderit. E kam cekë edhe këtu
16 kam thënë mund të jetë 9.15 mund të jetë 9.30. Kështu saktë
17 orën s'e kam këqyr, por është e vërtetë se dikund rreth asaj
18 ore kanë ardhur dokumentacionet. Është e vërtetë, dikun rreth
19 asaj ore kanë ardhur. Mund të jetë 10-15 minuta apo 20 një
20 diferencë, që saktë s'e kam këqyr, por është e vërtetë se mbas
21 orës 9 kanë ardhur dokumentacionet.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Sigurisht që
23 domethënë nuk po të kërkuj që të na e thuash një kohë ekzakte,
24 po a mund të konfirmoni ju lutem që konferenca për shtyp që u
25 zhvillua më vonë atë ditë me 7 shtator 2020 ka ndodhur rreth

1 orës 13.00. A është në të njëjtën linjë me atë çfarë mbani
2 mend juve? A është pak a shumë kjo koha?
3 Pë. Besoj se po. Kjo kohë duhet të jetë, pak a shumë sa mbaj
4 mend që një vit e gjysmë. Po, duhet të jetë kjo kohë që ne
5 kemi thirrur shumë shpejt e di që e kemi organizuar shumë
6 shpejt konferencën për shtyp se ka qenë konferencë e
7 jashtëzakonshme. Dhe e di se shumë shpejt e kemi thirrur.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes pak më tepër
9 lidhur me atë se çfarë keni kuptuar në atë kohë. Domethënë me
10 çfarë lloj materiali menduat ju se kishit të bënit. I kuptoj
11 se i thatë diçka Gjykatësit Barthe, kolegut tim, diçka lidhur
12 me këtë. Por ju e kuptuat dhe besonit që këto dokumente i
13 përkisnin Dhomave të Specializuara. A nuk është kështu zoti
14 Gucati?

15 Pë. Po për momentin që e kemi pasur temën e Gjykatës
16 Speciale, siç thashë edhe më herët që të jem shumë i singërtë
17 - dhe vulën - atëherë gjithmonë me hamendje dhe kemi besuar
18 këto dokumenta janë të Gjykatës Speciale. Që këtë nuk mund ta
19 mohoj, të gënjej të them që s'ka qenë kështu. Po arsyeja pse e
20 kemi bërë publike e tregova edhe më herët. Nëse është nevoja
21 prapë e shpjegoj s'e kam problem.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem kësaj për
23 një sekondë. Megjithatë për momentin zoti Gucati a mund të
24 konfirmoni, sigurisht në qoftë se mundeni që besonit dhe
25 prezumonit në atë kohë dhe e kam fjalën specifikisht me 7

1 shtator 2020 që ju besonit që këto dokumente ishin të vërteta,
2 origjinale, është kështu?

3 Pë. I nderum Gjyqtar, unë e kam thënë edhe në një televizion,
4 nëse s'gabo, po atë ditë. Unë s'jam ekspert i kësaj lëmie që
5 të zbuloj dokumentacionin a është i saktë a jo. Kam kërkuar
6 edhe ekspertizë për do dokumentacione që të zbulohet. Këtë e
7 din edhe hetuesi i cili fliste shqip. Edhe atij i kam thënë
8 "është mirë që ju t'i zbuloni këto dokumentacione, a janë të
9 juvet apo mund të jetë një gënjeshtër që neve na ka qit dikush
10 në lajthitje". Kjo ka qenë shumë e vërtetë. Qe këto kam thënë
11 në një televizion publik edhe në një televizion privat, po të
12 njëjtën ditë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta nuk e bëra shumë
14 të qartë pyetjen. Unë po të pyes se si e kuptove ti në atë
15 kohë, domethënë në kohën kur u bë kjo konferenca për shtyp.
16 Dhe në qoftë se doni mund t'ju lexoj edhe paragrafin përkatës.
17 Por a do të ishte e saktë, a do të ishte korrekte që unë të
18 prezumoja që në kohën kur u organizua konferenca për shtyp, ju
19 besonit se këto dokumente të vërteta. A ishte kështu?

20 Pë. Po kështu. Unë thashë gjithmonë tu u bazu në bazë të
21 stemës të Gjykatës dhe mbas emrave që i kemi parë ato, të ish-
22 prokurorëve, ne kemi besuar se këto dokumentacione mund të
23 jenë edhe të Gjykatës Speciale.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke kaluar në diçka paksa
25 të ndryshme nga ajo çfarë thatë. Pra flasim për paragrafin 24.

1 Do t'i kërkoja sekretarëve që të tregojnë dokumentin DHG0472
2 dhe flas posaçërisht për paragrafin 20 të deklaratës tuaj.

3 Ju lutem zoti Gucati, lexoni pak fjalinë e fundit të
4 këtij paragrafi. Do t'jua lexoj unë zoti Gucati. Ndërkohë
5 besoj e keni edhe në ekran. Është dokument mbi dy faqe. Pra,
6 ju keni thënë në paragrafin 20 që:

7 "Çdo gjë që kemi vendosur ishte në interes të mbrojtjes
8 së të drejtave të veteranëve dhe të UÇK-së"?

9 A e lexoni dot këtë rresh zoti Gucati?

10 Pë. Po e lexoj. Po. Po e shoh.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni se
12 çfarë donit të thonit me këtë? Çfarë donit të komunikoni kur
13 bëtë këtë formulimin që "çdo gjë që kemi vendosur ishte në
14 interes të mbrojtjes së të drejtave të veteranëve dhe të UÇK-
15 së.

16 Pë. Me këtë desha të thosha se unë si kryetar i veteranëve të
17 luftës dhe i kryesia, këshilli drejtues, ne e kemi për obligim
18 që t'i mbrojmë interesat e veteranëve të UÇK-së. Na obligon
19 rregullorja, statusi që edhe programi i organizatës dhe me
20 këtë kam thënë që ne që kemi folur që disa vite që kjo Gjykatë
21 është duke bashkëpunuar me kriminelët serbë, kjo është që ne
22 mbrojmë interesin e veteranëve të luftës. T'ju tregojmë
23 veteranëve që kjo Gjykatë është duke bashkëpunuar me
24 kriminelë. Kjo është arsyeja pse kam thënë. Se unë thirra në
25 emër të saj se jam edhe kryetar i veteranëve të UÇK-së dhe kam

1 obligim moral dhe etik që të dal para veteranëve t'ju tregoj
2 realitetin.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në të njëjtën kohë dhe në
4 qoftë se nuk jeni dakord me këtë propozim, ju lutem na e thoni
5 këtë gjë, por në të njëjtën kohë më 7 shtator ju e dinit apo
6 jo që materiali që i ishte dhënë medias përmbante emrat e
7 dëshmitarëve. Domethënë ju e dinit këtë gjë me datë 7 shtator,
8 apo jo zoti Gucati?

9 Pë. I nderum, pikërisht se e dishim ne që ka emra aty, ne nuk
10 kemi publikuar emra dhe dëshmi. Kjo është shumë e vërtetë. Kjo
11 ka qenë arsyeja pse ne s'kemi dërguar asnjë emër dhe asnjë
12 dëshmi. Vetëm e vetëm që të ruhet identiteti i tyre dhe
13 pavarësia e tyre. Kjo ka qenë shumë e saktë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe e dinit dhe mendoj që
15 e thatë edhe dje në përgjigje të zonjës Bolici që e kuptuar që
16 informacioni ishte informacion sensitiv, a është e saktë kjo
17 zoti Gucati?

18 Pë. Edhe dje e kam thënë, nuk i kam këqyr dokumentat apo kanë
19 qenë dokumenta apo material konfidencial. Kam thënë edhe dje,
20 them edhe sot, mbasi në media e kam kuptuar që e kam parë se
21 në ato momente unë kam thënë që i kisha për këtë arsye ja kam
22 jep fjalën Nasimit se unë isha pak i sëmure dhe masanej e kam
23 pa. Por nuk do të thotë që unë nuk e kam bërë shpërndarjen e
24 tyre, nuk e kam bërë publikimin e këtyre dokumentave ato.
25 Dokumentat kanë qenë në tavolinë dhe gjithmonë tu jua tërheq

1 vërejtjen mediave që nuk duhet të bëhet publik një emër apo
2 ndonjë dëshmi. Kjo ka qenë e saktë dhe e vërtetë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë. Ajo
4 çfarë dua t'ju pyes është në qoftë se e keni kuptuar që këto
5 dokumente ishin sensitiv posaçërisht për faktin që këto
6 dokumente përmbanin emrat e dëshmitarëve. A është i drejtë ky
7 formulim i imi, ky propozim?

8 Pë. I nderum, një pjesë e dokumenteve ça kam pa unë, pjesa
9 dërmuese mund të them, nuk kanë qenë konfidenciale. Kjo është
10 shumë reale, pjesa dërmuese e paketës së parë nuk kanë qenë.
11 Dhe kjo ka qenë arsyeja pse unë nuk e kam vërejt që shkruan
12 "Konfidenciale". Kjo është shumë reale që po të them. Paketa e
13 parë nuk ka pasur. Mbi shumica mund të them që ka qenë jo
14 konfidenciale, se në atë paketën e parë kanë qenë materiale të
15 gjykime të së kalumes.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë edhe një herë, ju
17 kërktoj ndjesë në qoftë se pyetja ime nuk është
18 majftueshmërisht e qartë. Po ju pyes për faktin që emrat e
19 dëshmitarëve ishin të përfshirë në materiale. A ishte ky fakt
20 një prej faktorëve që ju morët parasysh dhe që njohët dhe
21 pranuat që materialet ishin sensitiv? A ishte një prej gjërave
22 që kishit në mendje ju në momentin kur thatë që ky informacion
23 ishte sensitiv, se ju e kuptuat që ky informacion ishte
24 sensitiv?

25 Pë. Jo real po të them, në paketën na e kanë prurë se s'e kemi

1 marrë, i nderum. Por ne momentin që e kemi kuptuar, thashë, ne
2 nuk kemi bërë publike asnjë emër. Ne vetëm kemi tregu që kanë
3 ardhur disa materiale dhe këto materiale mund të jenë edhe të
4 ndjeshme. Kjo është e vërtetë se është edhe transkripti ku nuk
5 kemi lejuar që asnjë emër dhe asnjë deklaratë të dalin nga po
6 edhe as nga media. Kjo është shumë e saktë që po them. Për
7 këtë arsye dhe kemi bërë edhe insistimin që mos dalin emrat në
8 media.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sekretaria, ju lutem a
10 mund të shfaqni provën materiale me numër P59.

11 Zoti Gucati, ju lutem shikojeni në ekran, besoj se do të
12 shfaqet brenda një sekondi. Është një postim në Facebook që
13 jua tregoj zonja Bolici ose dje ose pardje. Ju e pranuat që
14 ishte një postim i juaji në Facebook dhe thatë që atë e
15 konsideronit si shprehje të lirisë së opinionit dhe të fjalës.

16 Gjëja e parë që do të doja që të shihnit, për shembull
17 shikojmë pak datën. Data këtu është data e shtatorit. Është
18 data 21 shtator. E shikon këtë?

19 Pë. Po e shikoj datën.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se mund të
21 kalojmë tek faqja 3. Faqja 3 mban numrin 081985. Ka një
22 paragraf që fillon me fjalët: "Përveç rrjedhjes së
23 informacionit...". Nuk e di në qoftë se mund ta gjeni dot këtë
24 citim në postimin tuaj zoti Gucati? Do jua tregoj në anglisht.
25 Ju thoni:

1 "Përveç rrjedhjes së këtyre dokumenteve dhe
2 korrespondencës ndërmjet Serbisë dhe Dhomave të Specializuara
3 kundër UÇK-së çdo pyetje që ka të bëjë me ata të cilët mund të
4 rrjedhin dokumente shumë sensitive dhe dokumente
5 konfidenciale..."

6 Nuk e di në qoftë se mund ta gjeni këtë në postimin tuaj.

7 Pë. Është një shkrim bukur i gjatë, kështu që s'po muj e
8 gjej krejt.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do ta lexoj për
10 transkriptin dhe pastaj në qoftë se keni ndonjë vështirësi do
11 të mundohemi që të gjejmë vendin tamam se ku e keni shkruar
12 këtë. Pra nga rreshti 10-12 në anglisht ka një fjali ku thuhet
13 që "ky është një veprim i cili ka shumë aspekte..."

14 A mund ta shohësh këtë të lutem?

15 ZONJA. BOLICI: [Përkthim] Të lutem, në qoftë se mund t'ju
16 ndihmoj është fjalia përkatëse.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Gucati e gjetët këtu?

18 Pë. Jo, jo s'e gjeta. Jam duke e lexuar prej fillimit.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mundohuni që të
20 përqendrohni këtu. Atëherë është kjo fjalia që thotë:

21 "Edhe për rrjedhjen e këtyre dokumenteve, të
22 korrespondencave midis Serbisë dhe Gjykatës Speciale".

23 Z. REES: [Përkthim] Besoj që zoti Gucati mund të ketë
24 mundësi që ta shikojë tani.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë në qoftë se doni,

1 mund ta lexoj për transkriptit dhe të jepet përkthim. Në qoftë
2 se ka ndonjë vështirësi, mund ta sqarojmë më pas.

3 Zoti Gucati a e gjetët këtë pjesën. Është kjo fjalia që
4 fillon:

5 "Edhe për rrjedhjen e këtyre dokumenteve..." dhe vijon më
6 tej "që ky është një veprim i cili ka disa aspekte, disa
7 dimensione...".

8 Pë. Po, po është e saktë. Kështu kam thënë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet që:

10 "...së pari, botimi i dosjeve është një çështje e
11 ndjeshme, dosjet përfshijnë deklarata të bëra nga dëshmitarët
12 kundër strukturave të UÇK-së dhe personat që vendosën që të
13 dorëzonin dosjet në OVL e UÇK-së, synonin që të ngarkonin me
14 një përgjegjësi shumë të madhe OVL e UÇK-së".

15 A mund ta gjeni, ta lexoni këtu?

16 Z. REES: [Përkthim] [Nuk ka përkthim].

17 Pë. Po është e vërtetë e kam thënë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë duke iu kthyer
19 edhe një herë pyetjes sime të mëparshme, pyetja që kam për ju
20 është kjo: a e kuptuat ju se këto dosje ishin të ndjeshme ose
21 shumë të ndjeshme, për të qenë më tepër specifikë, më tepër
22 konkret, sepse ato kishin emrat e dëshmitarëve. Kjo ishte
23 pyetja ime.

24 Pë. Po, i nderum në momentin që e kemi kuptuar që janë të
25 ndjeshme, ne kemi e kemi ndaluar publikimin e emrave dhe të

1 deklaratave të tyre. Kjo ka qenë shumë e vërtetë. Momentin që
2 kemi parë emra, ato ne përherë e kemi ndaluar dhe ju kemi
3 tërhequr vërejtjen të gjitha mediave se janë të ndalume të
4 publikohen emrat, për arsye privatësia e çdo personi ruhet.
5 Dhe ne asnjë emër s'e kemi përmend. Kjo është shumë e vërtetë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për t'ju kthyer edhe një
7 herë pyetjes time, domethënë përgjigja që dhatë është "po" e
8 kuptuat që dokumentet ishin të ndjeshme sepse këto dokumente
9 përmbanin emrat e dëshmitarëve. Është kështu?

10 Pë. Momentin që unë e kam parë emrin, thashë, momentin që e
11 kam emrin në atë dokument, unë e di që ai emër nuk duhet
12 publikuar dhe duhet të ruhet. Po, prej momentit që e kam pa,
13 po. Por nuk do të them "jo" se kjo është e vërtetë. Momentin
14 që e kam pa emrin, e kam ditur që duhet të ruhet emri i
15 personit në fjalë, kushdo që të është, X apo Y.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke iu kthyer edhe një
17 herë datës, zoti Gucati, data është 21 shtator, e kam fjalën
18 për datën kur është postuar ky postimi i Facebook-ut prej
19 jush. Kjo është data, është vetëm një ditë përpara konferencës
20 tjetër, konferencës së tretë për shtyp dhe marrjes së
21 dokumenteve të tjera, a është kështu?

22 Pë. Mund të jetë, data e Facebook-ut është shumë -- me 21
23 është real që e kam qitur këtu në Facebook dhe kam bërë një
24 përshkrim goxha të gjerë këtu, ku po shifen edhe emrat pse kam
25 shkruar dhe çka kam thënë. Po, është e vërtetë që me 21

1 shtator ky shkrim është.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me datë 22, ju
3 organizuar konferencën e tretë për shtyp. E saktë është kjo.
4 Pë. Me sa më kujtohet, po. Mesa më kujtohet, po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe përsëri këtë ditë ju
6 bëtë të disponueshme për median dokumente që ju e dinit që
7 përfshinin apo përmbanin emra të dëshmitarëve, e saktë?

8 Pë. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes diçka
10 lidhur me dëshmitarët. Në fakt kjo është një çështje për të
11 cilën juve u pyetët nga zonja Bolici, por dua t'ju jap
12 mundësinë që të sqaroni pak më tepër gjërat për ne. Dhe këtu e
13 kam fjalën për përmendjen e folësve shqiptarë kur i je
14 drejtuar dëshmitarëve të caktuar. A të kujtohet që t'u bë kjo
15 pyetje?

16 Pë. Po, kjo pyetje më është bërë edhe në disa emisione të
17 tjera. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohim provën
19 materiale P9. Kjo është një prej daljeve tuaja në televizion
20 që do të duam t'i referohemi. Është një dalje e dalës 7
21 shtator 2020. Dhe kam përshtypjen që ju thatë që është një
22 dalje në televizionin që ka ndodhur në fund të ditës, vonë atë
23 ditë. Ju lutem a mund të shohim bashkërisht faqen 6 të këtij
24 dokumenti.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Gucati në versionin

1 në gjuhën anglisht, pra është një paragraf që thuhet që "Siç
2 keni thënë gjithmonë Dhomat e Specializuara bashkëpunojnë me
3 prokurorët serbë". Nuk e di nëse mund ta gjeni këtë në
4 versionin në shqip.

5 Pë. Po e vërtetë është.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do ta them për
7 procesverbal:

8 "Siç e themi gjithmonë Dhomat Speciale janë duke
9 bashkëpunuar me prokurori të Serbisë dhe është duke u marrë
10 dëshmi në Serbi dhe po bashkëpunon me dëshmitarë të
11 ashtuquajtur shqipfolës, të cilët kanë qenë gjatë asaj kohe
12 dhe aktualisht me serbin. Pra, Gjykata po punon me shqipfolës,
13 me ata të cilët nuk ja dojnë të mirën këtij vendi dhe as UÇK-
14 së".

15 A të kujtohet se e ke thënë këtë gjë Zoti Gucati?

16 Pë. Po i nderum e kam thënë dhe e dëshmoj prapë. Kam argument
17 të cilin edhe e dëshmoj me Dëshmitarin X, i cili ka marrë
18 pjesë në masakrën e Mejës, që s'lejohet emri i tij të
19 përmendet e me ata që cilët kanë protestuar në vitin 1999
20 kundër UÇK-së dhe kundër NATO-s. Ata gjithmonë do të jenë
21 armiq të vendit tim dhe armiq të kombit tim. Duke falënderuar
22 Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n dhe shtetet e
23 Evropës që na kanë ndihmuar të çlirohemi, unë jam kundër atyre
24 personave që kanë protestuar kundër këtyre që na kanë ndihmuar
25 neve. Kjo është shumë e vërtetë. Kur e kam pa biografinë e

1 Adem Jasharit në këto dosje që janë nxjerrë nga Serbia,
2 atëherë kam qenë shumë i mllëfosur dhe kam deklaruar kështu.
3 Është shumë e vërtetë. Një njeri që ka vdekur me 56 anëtarë të
4 familjes për vendin e vet dhe për kombin dhe sot merren dëshmi
5 edhe të kërkohet biografia e tij në Beograd, atëherë qysh mund
6 ta quani ju këtë? Faleminderit shumë për pyetjen.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju kërkoja që të
8 shkonim faqen 11 të të njëjtit dokument. Dhe paragrafi fillon
9 me një pyetje nga newscaster që thotë që: "Ju dyshoni që ka
10 prova, apo jo?". Domethënë a mund ta shikoni?

11 Pë. Në cilin rresht i nderum dhe faqe, se këtu nuk -- s'jam
12 [e padëgjueshme] këtu.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në faqen në anglisht është
14 faqja 11. Është prezantuesi i lajmeve që...

15 Pë. Se nuk e nuk kuptoj gjuhën angleze.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk do të flas dot shqip.
17 Megjithatë në qoftë se e dëgjoni përkthimin ju lutem dëgjojeni
18 dhe mundohuni që ta gjeni fjalinë. Pra është prezantuesi i
19 lajmeve dhe ju thoni:

20 "Që sipas jush Gjykata e Specializuar bën fabrikime nga
21 Serbia dhe mund të provohet fajësia". Mendoj që mund të jetë
22 ndoshta në faqen 12 në versionin në gjuhën shqipe.

23 Atëherë, ti je regjistruar duke thënë këtë gjë:

24 "Këtë kemi thënë neve që prej 5 vjetësh tani. Siç e kam
25 thënë edhe më parë është një bashkëpunim, fabrikim i

1 shqipfolësve, njerëzve, personave shqipfolës dhe Serbisë.
2 Gjykata Speciale pretendon dhe dyshon por ajo dyshon se do të
3 dështojë ashtu siç ka dështuar. Dhe kjo Gjykatë Speciale e ka
4 marrë rrugën për të dështuar”.

5 Ndërkohë që në faqen tjetër që ju vazhdoni më tej. Thoni:

6 “Ato po mundon përmes disa dëshmitarëve, që do të thoja
7 që janë disa shqipfolës, të cilët publikisht njihen si
8 tradhtarë të vendit tonë”.

9 Dhe ti pastaj ndërpritesh nga prezantuesi i lajmeve cili
10 i thotë:

11 “Kualifikim i rëndë ky zoti Gucati”.

12 Pë. Po, po, po e gjeta.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Gucati kush janë këta
14 “shqipfolës” pa përmendur emra të përvetshëm. Cilët janë këta
15 dëshmitarë që kishit në mendje kur dhatë një deklaratë të
16 tillë? Edhe një herë do të doja t’ju kujtoja të mos përmendnit
17 emra.

18 Pë. Nuk do të përmend emra. Fjala “shqipfolës” tek ne nuk do
19 të thotë vetëm për shqiptarë, por të gjithë ata që flasin dhe
20 mendojnë kundër vendit tim. Gjithmonë e kam pasur fjalën për
21 ata njerëz të cilët kanë marrë pjesë nëpër ofensiva, që kanë
22 vra që kanë masakra, kanë përdhunuar kanë djegë, kanë
23 protestuar. Gjithmonë kam thënë: nëse Gjykata Speciale merret
24 - edhe sot po them - nëse merret Gjykata Speciale me këta
25 njerëz që janë duke u përmendur, unë besoj që do të jetë

1 dështim. Kjo arsyeja ka qenë, që unë s'muj të bindem kur i
2 shoh 17-18 kriminelë që i kërkon Interpoli. Kriminelë të
3 luftës të cilët kanë bërë krime në Kosovë. Kjo ka qenë
4 gjithmonë dhe kjo është bindja ime. Prapë po them, njeriu
5 duhet të lindi i vërtet, duhet të jetojë, por në është i
6 vërtetë, duhet të vdesë i vërtetë. Dhe këto -- në etikën time
7 dhe gjenezën time. Dhe prej këtij parimi jam thirr unë, -
8 gjithmonë jam thirrur prej këtij parimi. Se këtu me
9 dëshmitarin të cilin e kam përmend disa herë, i cili ka bo
10 krime, ka pas shokët e tina që kanë bo krime, këta janë armiq
11 të vendit tim dhe ata të cilët protestuan për lirinë e vendit
12 tim, janë armiqtë e vendit tim. Atë shtet e kemi krijuar me
13 gjak dhe me ndihmën e miqve ndërkombëtar. Kjo është përgjigja
14 ime i nderuar.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo që dua të kuptoj unë
16 është në qoftë se ke parë ti deklaratat e ndonjë prej këtyre
17 personave në materialin që keni parë apo ishte ndonjë
18 deklaratë më e përgjithshme që dhatë ju. Sepse unë e kuptova
19 se ti na the se nuk është se e ke parë në shumë detaje
20 dokumentacionin që ju erdhi, që nuk flisni anglisht dhe flisni
21 pak serbisht. Kështu që ajo çfarë dua të kuptoj unë është në
22 qoftë se ju i keni parë deklaratat e ndonjë prej ndonjëri prej
23 këtyre personave që i drejtoheni si "shqipfolës" dhe në qoftë
24 se i kemi parë këta persona në dokumentacionin që ia bëtë të
25 disponueshëm medias?

1 Pë. Jo, unë e kam thënë edhe ma herët se kanë qenë shumë. Po
2 unë në gjithë punën time në ato çfarë kam pa në fillim dhe me
3 sipërfaqe. Gjithmonë me analizën e disa dokumenteve, 7-8
4 copave që kam lexuar dhe gjithmonë jam thirru në baza të
5 atyre. Kjo është. Se jo që kam një emër specifik që mund ta
6 them tash në seancë të mbyllur. Jo. Të jem i sinqertë unë
7 gjithmonë jam thirrur në atë pjesën që e kam analizuar prej
8 atyre 6-7 copave të dokumentacioneve. Kështu ka qenë. Dhe në
9 to jam thirrur gjithmonë duke parë ato dhe duke parë
10 biografinë e Adem Jasharit. Gjithmonë jam thirrur këto
11 dokumente, ça kam parë 6-7 copë apo 10.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në paragrafin 25 të
13 deklaratës tuaj është dokumenti me numër identifikimi DHG0472
14 dhe siç na e thatë edhe ne këtu në këtë Gjykatë, ju na thatë
15 që arsyeja për thërritjen e konferencës për shtyp ishte një
16 shqetësim që ca kriminelë ose persona të caktuar që nuk ishin
17 dashamirës mund t'ia vinin ose hidhnin fajin OVL së UÇK-së. A
18 është një përshkrim i drejtë ky sa i takon arsye se pse e
19 thërritët konferencën?

20 Pë. Po e kam deklaruar edhe më herët që prej frikës që këto
21 dokumentacione të mos bien në dorën e ndonjë matrapazi apo
22 ndonjë dashakeq, që ja don të kegen vendit tim, Kosovës. De ne
23 kemi bo krejt publikimin e këtyre dokumentacioneve. Se këto
24 dokumentacione ka mujt të bien një, qysh kanë ardhur tek ne në
25 Organizatë ka mund të shkojnë edhe dikun dhe të shpërndahen

1 dhe nëpër vende publike. Kjo ka qenë arsyeja pse ne jemi ngutë
2 që të bëjmë një deklaratë të tillë dhe të deklarojmë që këto
3 dokumente kanë ardhur këtu. Dhe këto dokumente mund të vjen
4 t'i merr kur të dojnë hetuesit e Gjykatës Speciale. Unë ju kam
5 bërë ftesë, që kam bërë ftesë - e keni edhe në paragrafin këtu
6 që mund ta gjeni që "eja që të bashkëpunojmë, të ruajmë
7 organizatën, ndërtesën përreth". Unë e di që herën e parë nuk
8 ka mundur Gjykata Speciale dhe hetuesit ta zënë personin, por
9 herën e dytë dhe herën e tretë, kanë pasur mundësi që
10 vëzhgojnë terrenin dhe ta zënë personin. Kjo ka qenë gjithmonë
11 thirrja ime. Kjo është shumë e vërtetë. Unë po të kish pasur
12 dëshirë që të shpërndaj dokumentacione s'kisha bërë thirrje
13 vetëm sa për sy e faqe. Po kam bërë thirrje me shpirt, me
14 dinjitet "ejani dhe vëzhgoni Organizatën e Veteranëve që të
15 zihet personi", herën e dytë dhe herën e tretë. Se herën e
16 parë besoj që na ka ra në befasi të gjithëve. Po herën e dytë
17 dhe të tretën -- edhe policia e Kosovës ka mund ta bëj këtë
18 gjest, po edhe policia e EULEX-it edhe hetuesit të cilët janë
19 atje poshtë në Kosovë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju thoni që të njëjtat
21 arsye ju çuan juve dhe kolegët tuaj që të thërrisnit
22 konferencën e dytë për shtyp dhe konferencën e tretë për
23 shtyp. Domethënë në të dyja rastet, arsyet që ju bënë të
24 thërrisnit konferencat për shtyp, ishin këto arsye që sapo na
25 thatë, na përshkuat apo jo?

1 Pë. Po, i nderum. Se ne kemi menduar gjithmonë, po them, se
2 ne nuk i kemi besuar më atij personi. Ai ka mund të
3 fotografojë, ka mund të shkruajë në një Facebook të rrejshëm
4 dhe të thotë se "unë kam dërguar dokumentacionin në
5 Organizatë" dhe neve të na e lejë fajin. Kjo ka qenë arsyeja
6 gjithmonë pse ne e kemi bërë atë informimin përmes medias. Kjo
7 ka qenë arsyeja jonë. Unë besoj se ka qenë një arsye shumë e
8 fortë. Për arsye se tek ne është luajtur një pabesi, siç themi
9 ne shqiptarët dhe ne kemi menduar që është t'u na qit dikush
10 në lajthitje që mund të na merr edhe në qafë. Kjo ka qenë
11 arsyeja gjithmonë pse i kemi bërë këto. Duke menduar se zotniu
12 do të fotografojë vendin dhe do të thotë se unë kam çuar
13 dokumenta këtu. Dhe kjo ka qenë arsyeja gjithmonë pse jemi
14 ngut të bëjmë të bëjmë këto shumë shpejt. Që të jetë i
15 informuar opinioni që dikush po na bjen dokumentacionin.
16 Gjithmonë ka qenë kjo arsyeja. S'kemi pasur ndonjë arsye
17 tjetër ne.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbase me fjalinë e fundit
19 iu përgjigjët edhe pyetjes tjetër që kam. Po a kishte ndonjë
20 arsye që luajti rol në vendimin tuaj, dua të them të juajin
21 vetë dhe të kolegëve për ta marrë këtë vendim. Domethënë, çka
22 e motivoi vendimin tuaj për t'i vendosur në dispozicion të
23 medias këto dokumente. Kishte ndonjë faktor tjetër që luante
24 rol?

25 Pë. Po i nderuar. Këto ishin dy faktorë. Faktori i parë që ju

1 thashë më herët, frika që mos dalin këto dokumentacione nëpër
2 duar të matrapazëve dhe të shpërndahen nëpër vende publike.
3 Dhe faktori i dytë ishte. atë që e kishim thënë ne me vite, 4-
4 5 vite apo 6 vite dhe atë që dojshim t'ia rikujtojnë
5 deputetëve të nderuar që i kanë marrë ka 10,000 vota dhe janë
6 sot në Parlamentin e Kosovës, se ç'ka keni votuar dhe çfarë
7 s'keni lexuar ju, fare hiç. Dhe kjo ka qenë arsyeja që ne e
8 kemi tregu që kjo Gjykatë Speciale është e formuar vetëm për
9 kombin shqiptar. Nuk është Gjykatë që i ndjek të gjitha krimet
10 në Kosovë. Kjo i nderuar është vërtetë, nuk dua të fsheh asgjë
11 këtu.

12 Unë hala në jetën time s'kam mujt të lexoj, se lexoj ka
13 pak që të gjej një gjykatë të një etnie dikund në univers, ku
14 jetojnë të gjitha kombet dhe shtetet, në këtë universet. S'kam
15 mund të gjej një gjykatë të një kombi, që i përndjek vetëm
16 shqiptarët apo vetëm amerikantë, apo vetëm anglezët apo vetëm
17 gjermanët. Unë e di se gjykatat e shteteve kur formohen ato
18 formohen për qytetarët e Kosovës aoo për qytetarët e shtetit
19 që jetojnë. E këtu kjo Gjykatë është tu bë përndjekjen vetëm
20 tonën. Përderisa kjo Gjykatë nuk zbulon krimet që ka kryer
21 Serbia, që po e përsëris që njëqind herë, atëherë mu s'më
22 mbushet mendja që kjo Gjykatë është e drejtë. Kështu që i
23 kërkoj falje edhe prokurorëve se unë personale me ta nuk kam
24 kurrëgjë, asgjë. Unë e di që këta e kanë punë, do të punojnë në
25 këtë punë. Punojnë në këtë punë, po duhet të punojnë realitet,

1 Se duhet besuar se të gjithë kemi tek e fundit një Zot. Dhe
2 këtu unë e besoj këtu ajo që ne kemi dasht t'i tregojmë
3 opinionit.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohim provën
5 materiale me numër P2.

6 Zoti Gucati do t'ju kërkoj që të komentoni shumë shkurt
7 lidhur me diçka që zoti Nasim Haradinaj i ka thënë një
8 gazetari.

9 Të kalojmë ju lutem në faqen 4 në versionin në anglisht.
10 Besoj se është e njëjta faqe dhe në shqip ka një fjali zoti
11 Gucati që fillon me fjalën "Na takon ne me e demolu. E jona
12 është me e demolu". Është diku nga mesi i faqes në anglisht,
13 por në shqip është paragrafi 5.

14 Në anglisht thuhet këtu "Pra na takon ne që ta -- me e
15 demolu në kuptimin jo "demolim" por me e diskretitu arsyen e
16 vërtetë të kësaj Gjykatë , që Gjykata po thotë "jam e fortë
17 dhe po i mbaj këto dhe i kam provat të sakta".

18 A është kjo arsye që zoti Haradinaj jep këtu kur i është
19 bërë pyetje për të shpjeguar veprimet e tij? A është kjo arsye
20 që edhe ju e keni vetë personalisht?

21 Pë. Fjalën "demolim" nuk e di tash si ta zbërthej krejt,
22 sinqerisht. Ne gjithmonë kemi thënë që kjo Gjykatë, gjithmonë
23 kemi thënë që kjo Gjykatë, e përsëriti tash disa herë, nuk
24 kemi besim se, siç tregova edhe ma herët është duke
25 bashkëpunuar - ne kemi thënë që kjo Gjykatë ne duhet...

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një moment, t'ju ndaloj,
2 t'ju ndaloj këtu.

3 Z. WORBOYS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që ju ndërpres. Zoti
4 Haradinaj ka problem me dëgjimin.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dëgjoni zoti Haradinaj,
6 e dëgjoni. Zoti Haradinaj, e dëgjoni?

7 Tani zoti Gucati, ajo që dua të kuptoj nga ju është kjo:
8 A e mbështesni edhe ju, a e ndani edhe ju këtë fjali, këtë
9 arsye që ka dhënë zoti Haradinaj, që një prej arsyeve që është
10 bërë ky hap që të diskretitohet kjo Gjykatë. Pra, është një
11 mendim që edhe ju e keni të përbashkët me zotin Haradinaj, apo
12 është një mendim që ju vetë nuk e keni.

13 Pë. Unë këtu nuk po muj e gjej se çfarë ka thënë zoti
14 Haradinaj. Po unë po i besoj fjalës tënde dhe shrkimit
15 anglisht. Me sigurt që këtu s'jam tu mujt me e gjete. Po edhe
16 nëse e ka thënë zoti Haradinaj, ky nuk ka thënë që ta
17 "demoloj", ta shkatërroj këtë ndërtesë. Ky ka thonë, me fakte
18 dhe argumente ne do ta tregojmë tonën, të vërtetën. Kjo është
19 konteksti i fjalët me fakte dhe argumente që do t'i
20 kundërvihemi ne akësaj Gjykate, ne do ta demolojmë punën, që
21 ka prunu me kriminelë dhe me dëshmitarë të cilët kanë rrejt.
22 Kjo është e vërteta. Kështu është konteksti i fjalës, i
23 nderuar Gjyqtar. Unë këtu e kuptoj.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më datë 18 shtator 2020,
25 mund të kalojmë te prova materiale P7 në faqen 6, zoti

1 Haradinaj shkon një hap më tej. Ai thotë:

2 "Arsyeja përse po i nxjerrim këto e ka falën për
3 materialin, është duam t'i nxjerrim këto në mënyrë që t'i
4 tregojmë gjyqtarëve se puna që ju keni bërë është zero".

5 Edhe një herë ju pyes, është një këndvështrim që ju e
6 ndani me zotin Haradinaj, pra e keni të përbashkët, mendoni
7 njësoj si ai apo nuk e mendoni si ai?

8 Pë. Po çfarë ke thonë zoti Haradinaj nuk e di. Ka mundësi që
9 s'kam qenë në atë moment me atë dhe në atë takim. Tash nuk e
10 di për cilën televizion apo cilën revistë ka dhënë intervistë
11 zoti Haradinaj. Nuk e di. Ai është mendim i Organizatës së
12 Veteranëve të Luftës. Zoti Haradinaj nuk mund të flet në emër
13 të vet se është nënkryetar dhe zoti Haradinaj, gjithmonë, nëse
14 ka folur, ka folur në emër të Organizatës së Veteranëve të
15 luftës. Se ne jemi thirrëm [e pakuptueshme], i nderuar
16 gjyqtar.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me ndihmën e
18 Sekretarisë, nëse mundet provën P28 ta shfaqim. Zoti Gucati
19 kjo është -- do t'ju tregoj këtu procesverbalin e diçkaje që
20 keni thënë më 22 shtator 2020, është dita e konferencës së
21 tretë për shtyp. I lutem Sekretares që të na nxjerrë në faqen
22 9, në versionin në anglisht.

23 Ka një paragraf zoti Gucati ku ju filloni të flisni ku
24 thoni: "I kemi dëgjuar zërat të tillë". A e shihni këtë
25 paragraf?

1 Pë. Paragrafin e shoh, po ka shumë rreshta, afër 30 rreshta
2 janë, por nuk mund -- nëse s'është problem mund ta lexoni në
3 gjuhën angleze ju. S'është problem, i nderuar Gjyqtar,
4 lexojeni.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju -- në versionin
6 anglisht në fakt është fjalia e tretë ose e katërt, fillon me
7 fjalët:

8 "Nuk më intereson aspak ajo që ka bërë dikush apo kush i
9 ka nxjerrë këto". E keni fjalën për dokumentet. Ju thoni:

10 "Ajo që po më intereson është fakti që mi kanë sjellë në
11 zyrë dhe përgjegjësia ime është që me e cenu Gjykatën Speciale
12 dhe me i tregu publikut dhe kujtdo tjetër që Gjykata Speciale
13 po punon me prokurorin serb dhe...".

14 A mund të na thoni cila është kjo përgjegjësi?

15 "Përgjegjësi për me e cenu Gjykatën Speciale"?

16 Pë. Po i nderum. Këtë e kam thënë që Prokuroia Speciale punon
17 me Vukçeviçin dhe kam thënë Prokuroria Speciale, kërkon nga
18 MUP-i serb i asaj kohe edhe kësaj kohe që thashë, biografinë e
19 komandantit legjendar Adem Jashari. Ku e keni ma poshtë, mund
20 ta lexoni, prej rreshtit 21 teposhtë ku shkruan:

21 "Bashkëpunon me prokurorinë serbe për Adem Jasharin dhe
22 grupin e Adem Jasharit".

23 Po Adem Jashari është i vdekur dhe grupi i Adem Jasharit
24 ka qenë i dënuar me nga 20 vite dhe 10 vite. Kjo është e
25 vërtetë çka kam thënë. E ke në rreshtin më poshtë që thashë në

1 gjuhën shqipe. Kjo është ajo euforia që thashë kam thënë kur
2 kam dëgju dhe kam pa me sytë e mi, një deklaratë të tillë, kur
3 një njeri që vdes me 56 anëtarë dhe me fëmijën 11 vjeçar dhe 9
4 vjeçar tjetri vdesin pranë babait të vet, kjo është një
5 trishtim i madh për të gjithë qytetarët e Kosovë dhe kombin
6 tim. Kjo është reale që kam thënë që Prokuroria bashkëpunon me
7 VUKÇEVIÇIN dhe kërkon dosje për Adem Jahsar. E ke në fund te
8 rreshtit 22 dhe rreshti 21 e teposhtë ku janë të gjithë.

9 Edhe e kam përmendim emrin, një djalë tonin, një
10 bashkëqytetar, një Besim Rama, i cili ka qenë i dënuar dhe ka
11 qenë në burg me vite të tëra, që e kam përmendur, që është
12 edhe dosja e këtij djali të ri që është prish në burgjet serbe
13 apo mund të them është kalbur trupi i tijna. Kjo është shumë
14 reale, Besim Rama. Që këtë njeri, sot me pa për tmerr edhe
15 gjynah. Ju them me sinjeritetin më të madh dhe Prokuroria
16 kërkon dosje për Besim Ramën. Këto kam thanë. Kjo është shumë
17 reale çka shkruan këtu.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju shpresoni, siç e
19 keni thënë në këtë dokument që duke e vënë këtë dokument në
20 dispozicion të publikut do ta minoni Gjykatën Speciale.
21 Pë. Jo nuk është e vërtetë që unë, i nderuam Gjyqtar që unë
22 dua ta minoj këtë Gjykatë Speciale, po unë dua ti them kësaj
23 Gjykate, që është mirë të punojnë me njerëz të cilët e
24 meritojnë dhe tregojnë të vërtetën. Jo me kriminelë lufte të
25 cilët na kanë vrarë neve, na kanë përdhunuar, na kanë djegur

1 dhe na kanë përzënë nga Kosova. Mbi 1 milion qytetarë kanë
2 dalë në Shqipëri , Maqedoni dhe vendet e perëndimit prej
3 Serbie. Kjo ka qenë e imja dhe prapë do të është e imja
4 gjithmonë që unë do ta mbroj ato çfarë mendoj që është e
5 drejtë për vendin tim. Dhe do ta kundërshtoj Gjykatën
6 Speciale. Vetëm e vetëm këto janë arsyt pse jam kundër kësaj
7 Gjykatë.

8 Unë thashë edhe më herët, absolutisht s'jam kundër këtyre
9 prokurorëve. Se asnjërin nuk e njoh. Për mu ndoshta janë shumë
10 të mirë, por ndoshta s'ia vlen pse flas se këta e kanë obligim
11 të punojnë për këtë Gjykatë, por të punojnë me njerëz të cilët
12 e meritojnë dhe të cilët tregojnë ua tregojnë të vërtetën. E
13 jo me një armik që na ka sunduar 120 vjet. Shtatë mijë vjet
14 burg shqiptarët kanë vuajtur nga Serbia, i nderuar gjyqtarë.
15 Shtatë shekuj. Të jeni të bindur, prej vitit 1912 deri në
16 vitin 1997, 7 shekuj shqiptarët kanë vuajtur nëpër burgje. Kjo
17 është real kjo që po ju them. Keni dokumentacion nëpër arkiva
18 dhe fakte.

19 Kështu që më vjen keq që po shprehem kështu nuk mund t'i
20 besoj kësaj Gjykate, përderisa nuk e zbulon - që po e nxe
21 rastin "Panda" të cilin qytetarët serbë, nuk po flas për
22 qytetarët e mi shqiptarë tash, por në të zbulon rastin
23 "Panda", 6 fëmijë, 6 nëna serbe kanë mbetur pa ata fëmijë. Nuk
24 dua të jem fanatik [e padëgjueshme].

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Gucati, një moment,

1 për ta shkurtuar këtë. Kur thatë në televizion publik "që
2 donit ta minonit Gjykatën Speciale, besoj e kishit fjalën që
3 donit ta këshillonit, ta informonit? Kjo është ajo që po
4 thoni?

5 Pë. Është shumë e vërtetë i nderuar. Pikërisht ta
6 këshillojmë, pikërisht këto. Jo ta minojmë, ta shkatërrojmë ne
7 Gjykatën Speciale. Po ta këshillojmë që të mos punojë me
8 kriminelë lufte, po të punojë me njerëz që de fakto e dinë
9 ngjarjen dhe kanë qenë në ngjarje. Nuk jam kundër asnjë rasti
10 të mos zbulohet në Kosovë. Të gjitha rastet, jam ithtar i
11 asajna që kam vuajt për padrejtësi, jam ithtar i asaj, sepse
12 [e pakuptueshme].

13 Kështu, që me keqardhje them, jam kundër kësaj Gjykate
14 Speciale.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit zoti Gucati.
16 Zoti Gucati keni konfirmuar në dëshminë tuaj që autori i disa
17 prej postimeve në Facebook që është në emrin tuaj si llogari,
18 pra juve jeni autori i këtyre shkrimeve ju kujtohet që e keni
19 thënë këtë?

20 Pë. Unë e thashë edhe sot, se Facebook një kohë mu ka pas
21 thy, e kam lajmëru edhe në polici, e kam lajmëru edhe të
22 nderuarin avokat. Por disa janë të miat, të cilat mujna me i
23 verifiku, janë të mijat. Ato [e pakuptueshme] i njoh shkrimet
24 unë e pranoj qysh e pranova për ato dy postime, po është e
25 vërtetë që kam shkruar në Facebook, disa shkrime të miat po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni ju i vetmi person i
2 cili hedh postime në llogarinë e Facebook-ut tënd, domethënë
3 njerëzit - apo ka pas ndonjë person tjetër që ka vendosur
4 postime në llogarinë tënde në Facebook me lejen tënde?

5 Pë. Shumicën jam unë i vetmi po ka që edhe sekretari teknik
6 që është i afërm i imi, i familjes, është djali i kushëririt,
7 që edhe atë ngandonjëherë e autorizoj që t'i hedhë shkrimet në
8 Facebook. Por gjithmonë me lejen time, jo pa lejen time.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse do të kishit parë një
10 postim në llogarinë në Facebook që nuk ishte vendosur aty me
11 autorizimin tuaj, çfarë do të ndodhte, do ta hiqnit menjëherë
12 këtë?

13 Pë. Po, po. Jam i bindur që nuk do të kisha lënë që në
14 Facebook-un të tim shkruhet gjithçkah, ta fyej dikë.
15 Megjithëse në jetën time s'kam fyer kurrkënd. Nuk toleroj që
16 ta fyej dikën apo që ta lëndoj dikën në Facebook.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Keni thënë në paragrafin 8
18 të deklaratës tuaj që jeni Kryetar i OVK së UÇK-së nga data 15
19 tetor 2015 deri në arrestimin tuaj. Si kryetar i OVL së UÇK-
20 së, a ndjenit një lloj detyre, ndershmërie ndaj të gjithë
21 veteranëve të cilët kanë qenë pjesë e luftës, pjesë e UÇK-së
22 gjatë luftës?

23 Pë. Vetëm se më fal, një përmirësim, i nderuar Gjyqtar. Unë
24 jam Kryetar i veteranëve me 15 tetor 2017 jo 2015. Ashtu e
25 kaptova unë.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Unë kam shënuar datën 15
2 tetor këtu. Këtu thuhet, kështu thuhet në deklaratën tuaj. Në
3 qoftë se doni mund ta korrigjojmë.

4 Pë. 2017 jo 2015. Këtu unë kështu unë e kuptova, ndoshta e
5 kam marrë vesh gabim. Kështu e kam kuptuar.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Jemi dakord për këtë, në
7 rregull. A ndienit, kishit ndjesinë e ndershmërisë ndaj të
8 gjithë veteranëve që kanë shërbyer në xx UÇK-së në këtë
9 detyrë?

10 Pë. Aty është edhe një betim kur njeri merr detyrën si
11 Kryetar i Veteranëve të luftës. Dhe mua më së pari nuk më len
12 ndërgjegjja ime që i kam plagë në trupin tim, në këmbën e
13 majtë dhe nuk më len ndërgjegjja e punës time që kam bërë për
14 vendim tim dhe ajo është e vërtetë që unë mundohena me tërë
15 qenien time njerëzore se mos të jem i gabum, por nuk ka njeri
16 në botë që s'mund të jetë pa gabime. Unë mundohem që të mos
17 jem i gabuar dhe të jem i barabartë për gjithë shokët e mi dhe
18 gjithë veteranët e UÇK-së, të cilët janë anëtarë të
19 organizatës tonë. Për të gjithë mundohem që të jem i
20 barabartë. Të paktën mundohena shumë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në kohën e konferencave për
22 shtyp dhe të shfaqjeve të tjera në media gjatë shtatorit të
23 2020 si është shfaqur detyra për ndershmëri ndaj të gjithë
24 veteranëve të UÇK-së apo si kjo detyrë ka pasur ndikim mbi
25 pikëpamjet ose opinion tuaj, lidhur me hetimet e ZPS por

1 lidhur gjithashtu dhe me dëshmitarët që janë të gatshëm për të
2 bashkëpunuar me ZPS-në, lidhur me hetimet e kësaj të fundit?
3 Pë. Unë asnjë dëshmitari s'i kam thënë "mos bashkëpunoj me
4 Gjykatën Speciale". Unë thashë kam edhe deklaratat, kam edhe
5 revista apo gazeta që kam folur, kam thënë "për hir të vendit
6 dhe shtetit tonë duhet të bashkëpohet". Gjithmonë me
7 realitetin duke e treguar. Këtë e ke në Epokën e re, Express
8 dhe në shumë media të Kosovës. Edhe në konferenca për median
9 që kam dhënë kam thënë kështu "Dhe unë do të mundohena shumë
10 të jem transparent me shokët e mi, sidomos me veteranët e
11 luftë".

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E keni bërë shumë të qartë
13 në dëshminë tuaj, sa i takon ndjesisë apo ndjeshmërinë për
14 bashkëpunimin ndërmjet ZPS dhe autoriteteve të republikës
15 Serbe. Sot në faqen 26 të transportit në përgjigje të një
16 pyetjeje që t'u bë nga zonja Bolici e ZPS, ti the:

17 "Ne të gjithë e dimë që Serbia është armiku ynë dhe që ju
18 keni bashkëpunuar me kriminelët serbë dhe disa persona të
19 tjerë të lidhur me ta."

20 Ndërkohë që sot pasdite ti iu referove ose përmende ata
21 njerëz të cilët sipas pikëpamjes tuaj janë "armiq të vendit
22 tim së bashku me ata që kanë protestuar kundër lirisë së
23 vendit tim". Pyetja ime është kjo:

24 "A del si rezultat që ZPS-ja në thelb ka bashkëpunuar me
25 armikun?"

1 Pë. [REDAKTUAR] ka qenë kundërshtar i yni dhe ka qenë kreu
2 i armikut tim, unë s'mund të them ndryshe, i nderuar Gjyqtar.
3 Momentin që një njeri ka bërë masakër në Mejë të Gjakovës, unë
4 s'mund të them ndryshe për atë njeri. Edhe nuk e di që mundet
5 dikush edhe prej juve të thoni nëse një qytetar i juaji po
6 bashkëpunon me një armik të juajin, të shtetit tuaj. Kjo është
7 e vërtetë dhe ata të cilët protestojnë kundër lirisë, të një
8 vendi pavarësisht, po e lejmë Kosovën, po të një vendi tjetër,
9 si do të quhen ata njerëz, nuk e përkrahin shtetin e vet,
10 kombin e vet dhe lirinë e vet. Kjo është reale, kështu e kam
11 thënë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra a kam të drejtë unë kur
13 e kuptoj që gjatë ngjarjeve të shtatorit të 2020, juve i
14 mendonit të gjithë dëshmitarët që bashkëpunonin me ZPS-në, të
15 cilët në thelb po bashkëpunonin me armikun, sepse ZPS-ja po
16 bashkëpunonte me Serbinë. Domethënë a është i saktë ky kuptim
17 i imi.

18 Pë. Unë të gjithë dëshmitarët s'i kam lexuar dhe nuk i di
19 kush është dëshmitar. Po nëse bashkëpunon me Serbinë, për mua
20 është armik. Se Serbia ka qenë armik i vendit tim edhe sot
21 është armik i vendit tim Serbia, e cila ka pretendime ta marrë
22 Kosovën edhe sot. Kështu që, de fakto del, nëse bashkëpunon me
23 Serbinë, për mu do të jetë e njëjtë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, a del si konkluzion nga
25 ajo çfarë thatë ju, që dëshmitar që bashkëpunojnë me ZPS-në

1 dhe ZPS-ja bashkëpunon me Serbinë, a është një dëshmitar ky që
2 po bashkëpunon, a është armik i juaj ky, domethënë i shihni
3 kështu dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e ZPS-së apo jo?
4 Pë. Jo. Unë jam tuj thonë gjithmonë, i nderuar Gjyqtar, për
5 ata të cilët kanë qenë kundërshtarë tonë, që njihen. Që e
6 përmenda edhe emrin pak më herët. Gjithmonë e kam fjalën për
7 këta, jo për të tjerë. Unë s'kam thënë për tjetër, unë kam
8 thënë, e kam pas fjalën gjithmonë për këta dëshmitarë të
9 cilët, e përmenda emrin e këtijna dhe atyre të tjerëve që i
10 lyp Interpoli. Gjithmonë e kam pasur fjalën për këta
11 dëshmitarë dhe gjithmonë prapë e kam dyshimin për këta
12 dëshmitarë.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Zoti Gucati, në dëshminë
14 tuaj juve u pyetët për dallimin ndërmjet dëshmitarëve që
15 tregojnë të vërtetën dhe dëshmitarë të cilët janë gënjeshtarë.
16 Ju lutem a e sqaroni dot për Gjykatën se çfarë mendoni ju për
17 dëshmitarët të cilët i tregojnë gënjeshtria ZPS, lidhur
18 aktivitetet e veteranëve të UÇK-së?

19 Pë. Ata të cilët tregojnë gënjeshtria, ndryshe nuk mund të
20 quhen vetëm, gënjeshtarë. Vetë, gënjeshtarë mund të quhen.
21 Nëse tregojnë gënjeshtria dhe vijnë këtu e gënjejnë, ata mund të
22 jenë gënjeshtarë. Tjetër s'mund t'ju thuash atyre.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe çfarë pasojash do të
24 kishin veprimet e tyre?

25 Pë. Deri më sot s'kanë pas asnjë pasojë dhe nuk besoj që do

1 të kenë pasoja kurrë. Ajo do të jetë në ndërgjegjen e tyre
2 njerëzore, Ajo do të jetë në ndërgjegjen e tyre njerëzore. Ajo
3 gjithmonë do të jetë në ndërgjegjen e tyre njerëzore. Deri sot
4 unë nuk di një rast a dikush që do të ketë apo ka pasur
5 pasojë. Kjo nuk ekziston në opinion tonë. Unë kështu të paktën
6 mendoj dhe kështu besoj fuqishëm.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja ime e fundit është
8 kjo:

9 Çfarë hapash të tjerë konkretë keni marrë ju për të bërë
10 dallimin ndërmjet dëshmitarëve të cilët i tregojnë të vërtetën
11 ZPS dhe dëshmitarëve që i tregojnë gënjeshtër ZPS? Ti
12 personalisht, çfarë hapash konkret ke marrë për të bërë
13 dallimin ndërmjet këtyre dy grupeve të dëshmitarëve.
14 Pë. Deri më sot s'kam marrë asnjë hap dhe as nuk e kam ndër
15 mend të marr asnjë hap. Gjithmonë do t'ia le ndërgjegjes dhe
16 respektit, gjithmonë do t'ia le ndërgjegjes së tyre dhe
17 respektit të tyre. Aq sa ka respekt njeriu edhe të respekton,
18 aq sa ka ndërgjegjen njeriu, tregon edhe ndërgjegjen e vet.
19 Kështu që gjithmonë do të jetë në ndërgjegjen e tyre.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit zoti Gucati,
21 faleminderit Gjykatësi Smith.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
23 Faleminderit Gjykatësi Gaynor. A kemi mbaruar me këtë
24 dëshmitar? Zonja Prokurore a keni ndonjë gjë?

25 ZNJ. BOLICI: Jo.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees?

2 Z. REES: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti

4 Worboys?

5 Z. WORBOYS: [Përkthim] Mesa kam dijeni, jo. Nëse do të

6 dalë ndonjë gjë tjetër, do t'ju informojmë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Në rregull. Zoti Gucati, me kaq është mbyllur edhe dhënia
10 e dëshmisë tuaj, mund të vazhdoni të qëndroni ulur aty, nëse
11 dëshironi sepse nuk do të vazhdojmë shumë gjatë, ose nëse
12 preferoni mund të ktheheni në ndenjësen e mëparshme.

13 Z. REES: [Përkthim] Thjesht për t'i kujtuar Trupit
14 Gjykuesi që kërkojmë pranim të deklaratës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po. Do të
16 vija edhe tek kjo pikë. Dëshiron që të pranohet.

17 Z. REES: [Përkthim] Do të bëjmë një përjashtim të mos
18 kërkojmë përmbledhjen e deklaratës së dëshmitarit, pra, duke
19 qenë se zoti Gucati ka dëshmuar gjerësisht, gjatë marrjes së
20 pyetjeve kryesore. Nuk e di nëse ka kundërshtim ZPS-ja për
21 pranimin e deklaratës së zotit Gucati.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në këtë rast konkret nuk kemi
23 kundërshtim për pranimin në prova materiale të deklaratës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Trupi Gjykses e pranon deklaratën me shkrim në prova të
2 zotit Gucatit në dhënin e dëshmisë sipas rregullës 154 të
3 Rregullores. Mbroja e zotit Gucatit urdhërohet që të nxjerrë
4 brenda datës 17 dhjetor 2021 një version publik të redaktuar
5 të deklaratës duke hequr emrat e paragrafit 36. Njësia e
6 Menaxhimit Gjyqësor gjithashtu udhëzohet që të shoje në *Legal*
7 *Workflow*, versionin publik të kësaj prove materiale, në
8 momentin që do të nxirret dhe ta shënojë si të "Redaktuar".

9 Zonja Sekretare caktojini një numër prove këtij
10 materiali.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata do të marrë
12 numrin 1D3.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 E kuptoj që kemi ardhur në fund të orarit për sot, por
16 dëshirojmë që të trajtojmë edhe çështjen e kalendarit deri më
17 datë 17 dhjetor.

18 Zonja Bolici ju keni çmuar se për 6 dëshmitarët e
19 ardhshëm të Mbrojtjes, mendoni se do të bëni kundërpyetje 2
20 orë secilit. Shpresoj që -- pra i qëndroni kësaj? Apo Trupi
21 Gjykses mund të shpresojmë që të bëni kundërpyetje mesatarisht
22 një orë nga nesër dhe të premtën

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Si mesatare është një vlerësim i
24 saktë, i nderuar Gjykatës, por varet se cilët do të jenë
25 dëshmitarët.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në vartësi
2 të dëshmitarëve që kemi.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për të parin sigurisht që po, për
4 të dytin mund të na duhen dy orët e plota.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees, a
6 doni të shtoni ndonjë gjë lidhur me vlerësimin për dy
7 dëshmitarët që do të kemi nesër dhe të premten?

8 Z. REES: [Përkthim] Jo, mendoj që për sa i takon
9 planifikimit nga ana e Mbrojtjes, do të kërkojmë që të kemi në
10 dispozicion për secilën seancë të ditës, 1 dëshmitar me
11 shpresën se ZPS-ja do të jetë më e shpejtë, më shkurt pra, nga
12 sa e vlerësojmë. Nëse jo, në rregull, por ne këtë do të
13 synojmë që të kemi.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
15 rregull.

16 Trupi Gjykses dëshiron që ta mbyllë paraqitjen e provave
17 nga Mbrojta e Gucatit në mërkurën e ardhshme nëse është e
18 mundshme. Ne kemi kohë në dispozicion paraditen e datës 15
19 dhjetor dy seanca, dy sesione pra dhe me shpresë ta mbyllim
20 pra me ekipin e parë të Mbrojtjes.

21 Zonja Bolici ju thatë që do të pyesnit nëse dy
22 dëshmitarët e ZPS që ka përmendur zoti Rees, do të jenë në
23 dispozicion të enjten apo të premten javën e ardhshme. Sa i
24 takon paradites së të mërkurë, gjithashtu është një opsion.
25 Mabajni parasysh këtë dy ditë.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I kemi mbajtur.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
3 Worboys, zoti Buckly, i ka ardhur radha Mbrojtjes së zotit
4 Haradinaj. Kam disa pyetje të cilave ju mund të mos i
5 përgjigjeni sot, por presim përgjigje nesër.

6 Kemi parashikuar dy ditë për të mbajtur seancë javën e
7 ardhshme. Të enjten dhe të premtën. Mendojmë që deklarata
8 hyrëse e Mbrojtjes së Haradinaj të fillojë të enjten dhe
9 pastaj të filloni dhënien e dëshmive të anës tuaj menjëherë
10 pas kësaj. Trupi Gjykses është në dijeni që dëshmia e zotit
11 Haradinaj nuk mund të përfundojë brenda këtyre dy ditëve dhe
12 ne mendojmë se nuk do të ishte mirë që të fusnim një pauzë të
13 gjatë ndërmjet.

14 Prandaj Trupi Gjykses do të dëshironte që ju të
15 thërrisnit dy dëshmitarë të tjerë, 1254, 1246 ose 1252, cilët
16 do dy persona nga këta të jenë në dispozicion. Sepse mendojmë
17 që dëshmia e tyre mund të dëgjohet gjatë këtyre dy ditëve.
18 Kemi parasysh edhe dy dëshmitarët e Prokurorisë që ka kërkuar
19 zoti Rees, megjithëse mendojnë që nuk do të jetë një dëshmi e
20 gjatë e tyre këtu.

21 Nëse nuk fillojmë me provat, pra me paraqitjen e provave
22 të Mbrojtjes së Haradinajt, nuk mund ta përfundojmë brenda
23 datës 17 janar, siç e kemi parashikuar dhe kjo pa marrë dhe
24 parasysh rezultatin e apelimit të apelimit.

25 Pra sa i takon -- pas datës 7 janar opsionet që kemi për

1 të përdorur sallën e gjyqit janë të kufizuara dhe ne nuk duam
2 që ta zvarrisim këtë paraqitje të provave nga ana juaj për
3 javë e javë të tëra. Nuk duam të ushtrojmë presojmë mbi ju,
4 por sigurish duhet të diskutoni me zotin Cadaman, por besoj e
5 keni parasysh pse kërkojmë që të kemi një herë dy dëshmitarë
6 dhe pastaj pas pushimit të Gjykatës mundet që zoti Haradinaj
7 të japë dëshminë e tij në mënyrë që të mos ndërpritet. E
8 kuptoni këtë?

9 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po ju falënderojmë shumë i nderuar
10 Gjykatës. Do të marrim udhëzime sonte do të flasim me ekipin.
11 Deklarata hyrëse nuk do të jetë problem, por do t'ju japim
12 përgjigje edhe për propozimin për dëshmitarë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Keni
14 ndonjë gjë për të shtuar zoti Buckley?

15 Z. BUCKLY: [Përkthim] Jo, thjesht për të mbështetur atë
16 që tha zoti Worboys, deklarata hyrëse nuk është ndonjë
17 problem. Mund ta konfirmojmë tani. Sa i takon pjesës tjetër do
18 ta diskutojmë sonte, do të marrim udhëzimet edhe nesër do të
19 jemi në gjendje të t'ju informojmë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
21 Buckley, zoti Worboys, gjatë 3 ditëve, Trupi Gjykes ka marrë
22 ankesa nga Mbrojtja e zotit Haradinaj sa i takon mundësisë për
23 të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe për çështjet përkatëse
24 të drejtësisë.

25 Së pari, ne të gjithë e dimë që situata aktuale nuk është

1 e lehtë. Urojmë që zoti Cadman të shërohet sa më shpejt, por
2 Trupi Gjykses nuk është i bindur se janë të vlefshme ankesat e
3 bëra nga Mbrojtja e zotit Haradinaj. Këto janë arsyt.

4 Bashkëmbrojtësi ka të njëjtën detyrë dhe detyrim për të
5 marrë përsipër dhe për të marrë udhëzime për të përfaqësuar
6 klientin. Në fakt një prej arsyeve kryer pse ekziston
7 bashkëmbrojtësi është pikërisht për të mbuluar situata të
8 tilla kur kryembrojtësi nuk është në dispozicion, qoftë për
9 arsye shëndeti apo për arsye të tjera. Bashkëpërfaqësimi
10 përmes bashkëmbrojtësit, ekziston për të siguruar përfaqësim
11 efekti dhe që ky përfaqësim efektiv të mos cenohet nga mungesa
12 e kryembrojtësit.

13 Gjithashtu kemi vënë re se disa anëtarë të ekipit
14 Mbrojtës të zotit Haradinaj, përfshirë këtu dhe mbrojtësin,
15 kanë mundur që t'i ndjekin këto seanca. Nuk kemi pasur seanca
16 private të hënë dhe të martën, -- edhe sot ishte shumë e
17 shkurtër.

18 Anëtarët e ekipit të Haradinajt, kanë mundësi që nga larg
19 të hynë në sistemet e Dhomat e Specializuara të Kosovës-së,
20 përfshirë këtu edhe transkriptin e plotë të të gjithë
21 procedurës të ndjekur në sallë edhe pse ju mbase nuk e kishit
22 në dijeni përpara. Shpresoj që tani zoti Buckley ta ketë
23 gjetur.

24 Anëtarët e ekipit të Mbrojtës së zotit Haradinaj që kanë
25 ndjekur procedurën kanë pasur mundësi që të shohin edhe

1 shfaqjen e provave të cilat janë gjithashtu në Legal Workflow
2 si dhe në listën e paraqitjes së provave.

3 Mbrojtja e zotit Haradinaj ka pasur në dispozicion mënyra
4 të ndryshme të komunikimit në kohë reale me anëtarë të tjerë
5 të ekipit brenda dhe jashtë sallës, përfshirë këtu postën
6 elektronike dhe funksionet chat. Unë e di që kemi pasur disa
7 vështirësi dje, por kjo del jashtë kontrollit të kësaj
8 organizata.

9 Zyra Administrative e ka informuar Panelin se Zyra
10 Administrative ka ndihmuar kontaktimet midis zotit Haradinaj
11 dhe avokatit të tij. Jemi në dijeni që zoti Haradinaj ka marrë
12 në telefon dy numra telefoni të avokatit mbrojtjes por nuk ka
13 marrë përgjigje. Nuk i është përgjigjur kush, nuk është
14 lajmëruar kush.

15 Jemi pra -- nuk mund të ketë një sugjerim padrejtësie,
16 pra, parregullsie, më falni ta them ndryshe. Pra nuk mund të
17 themi që ka pasur padrejtësi. Trupi Gjykues dhe Zyra
18 Administrative po bën çmos që të çojë përpara këtë procedurë
19 në të mirë të klientit tuaj. Jeni të painformuar për disa prej
20 disa instrumenteve që keni në dispozicion.

21 Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë edhe disa afate të
22 cilat nuk janë përmbushur nga ekipi juaj që nuk janë
23 përmbushur nga ekipi juaj në disa raste. Ju lutem të tregohemi
24 të arsyeshëm që ta çojmë përpara këtë gjykim në mënyrë të
25 arsyeshme dhe efikase.

1 Zoti Rees nesër do të fillojmë me dëshmitarin 1241. Ju
2 mund të lexoni deklaratën siç sugjeroni, me përjashtim të
3 tekstit në paragrafin 40.

4 Sa i takon 2 dëshmitarëve - sa i takon dëshmitarëve të
5 tjerë do të japim udhëzimeve në ecuri e sipër. Zoti Rees, keni
6 ndonjë gjë tjetër?

7 Z. REES: [Përkthim] Jo faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
9 Prokuroria?

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
12 nga Mbrojtja e zotit Haradinaj?

13 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do e
15 ndërpresim këtu seancën. Do të rishihemi nesër në orën 09.30
16 minuta. Faleminderit për durimin. Falënderoj shumë përkthyesit
17 dhe personelin tjetër të sallë si dhe stenografin të cilët
18 kanë punuar shumë sot.

19 --- Seanca mbyllet në orën 16.08

20

21

22

23

24

25